



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Plani i Reagimit Kombëtar

Prishtinë, Dhjetor 2010

PËRMBAJTJA

Udhëzimet për implementim	4
I. Hyrje	7
Plani i Reagimit Kombëtar	11
Aktivitetet e Menaxhimit të Incidentit	14
Autorizimet	14
Konceptet Kryesore	14
II. Parashikimet dhe Konsideratat për Planifikim	16
III. Rolet dhe Përgjegjësitë	18
Pushteti Qendror, Lokal dhe Degët Regjionale	18
Qeveria	19
Organizatat Jo Qeveritare dhe Vullnetare	21
Sektori Privat	23
Përfshirja e Qytetarëve	24
IV. Koncepti i Veprimit	25
I përgjithshëm	25
Koordinimi i Përgjithshëm i Aktiviteteve Qendrore të menaxhimit të Incidentit	25
Struktura Organizative	26
Elementet Kryesore Organizative të PRK-së	29
IV. Veprimet e Menaxhimit të Incidentit	45
Veprimet	45
Njoftimi dhe Vlerësimi	45
Obligimet për Raportim	45
Shpërndarja e Paralajmërimeve dhe Buletineve	47
Kërcënimet në Rritje të Identifikuara në Nivelin Qendror	48
Aktivizimi	48
Elementet organizative të Zyrave Qendrore	48
Elementet Regjionale	49
Elementet Fushore	50
Kërkesat për Asistencë të MPB-së	50
Veprimet Para-Incidentit	51
Veprimet Reaguese	52
Veprimet Rimëkëmbëse	53
Demobilizimi	54
V. Meneaxhimi dhe Mirëmbajtja e Vazhdueshme e Planit	55
Mirëmbajtja e planit	55
Instituti i Menaxhimit Emergjent i SIME-së	55
PRK dhe Gatishmëria Kombëtare	56
Standardet dhe Dokumentet Mbështetëse të PRK-së për Planet tjera Qendrore	56
Shtojcat	59
1. Fjalori i Termeve Kryesore	59
2. Lista e Shkurtesave	67
3. Autorizimet dhe Referencat	69
4. Përshkrimi i Përfshirjes Fillestare Qendrore	70
5. Përshkrimi i Mbështetjes Brendaqeveritare	73
Anekset e Funksioneve Mbështetëse Emergjente	76
Funksioni Mbështetës Emergjent 3 – Punët Publike dhe Inxhinieria	81
Funksioni Mbështetës Emergjent 5 – Menaxhimit Emergjent	89

Funksioni Mbështetës Emergjent 6 – Kujdesit Masiv, Strehimit dhe Shërbimeve Humane	95
Anekset për Incidente	103
Aneksi për Incidentin Katastrofik	107
Aneksi për Incidentet me Materie të Rrezikshme	115

UDHËZIMET PËR IMPLEMENTIM

Të përgjithshme

Plani i Reagimit Kombëtar (PRK), është efektiv me rastin e publikimit me proces fazor të implementimit gjatë vitit të parë. Gjatë 120 ditëve të para të këtij procesi implementues, të gjitha planet tjera të mundshme të nivelit kombëtarë mbesin në fuqi. Fazat e implementimit janë si në vijim:

- **Faza I – Periudha Tranzitore (01 Janar deri më 31 mars 2011):** Ky afat kohor 90 ditor është i dedikuar për të siguruar periudhën tranzitore të nevojshme për ministrinë, agjencitë dhe organizatat tjera për t'i përshtatur trajnimet e tyre, për t'i përcaktuar nevojat për plotësimin e elementeve organizative të PRK-së, dhe për t'u njohur me strukturat, proceset dhe protokollet e tij.
- **Faza II – Modifikimi i Planit (01 Prill deri më 30 qershor 2011):** Ky afat kohor prej 90 ditëve, është i dedikuar për t'ju siguruar ministrive dhe agjencive mundësitë për t'i modifikuar planet ekzistuese me PRK-në dhe për t'i zhvilluar trajnimet e nevojshme.
- **Faza III – Implementimi Fillestar dhe Testimi (01 Korrik deri më 30 shtator 2011):** Implementimi i plotë i PRK-së duhet të bëhet katër muaj pas datës së publikimit të tij. Planet tjera mbesin në fuqi, natyrisht të përshtatur me PRK-në. Gjatë kësaj periudhe Ministria e Punëve të Brendshme (MPB), do të bëjë vlerësime sistematike të strukturave, proceseve dhe protokolleve koordinuese të PRK-së të zbatuara për incidentet e rëndësishme kombëtare, për ushtrimet në fushën e sigurisë kombëtare dhe për rastet specifike të sigurisë kombëtare. Në fund të kësaj periudhe MPB-ja do të bëjë rishikimin një vjeçar për ta vlerësuar procesin e implementimit dhe për të bërë rekomandime tek ministri, për përmirësimet e domosdoshme të PRK-së. Në vijim të këtij rishikimi ky dokument do të rishikohet dhe publikohet çdo katër vjet.

Kryeministri i Republikës së Kosovës mund ta përshpejtoj implementimin e PRK-së, nëse e kërkojnë rrethanat e caktuara.

Obligimet

Ky seksion ofron obligimet e veçanta apo rekomandimet për ministrin e MPB-së; ministrinë dhe agjencitë qendrore; pushtetin lokal; organizatat jo qeveritare (OJQ) dhe të sektorit privat, për të mundësuar implementimin e plotë të këtij plani.

Ministri i Punëve të Brendshme

Brenda 60 ditëve të publikimit të këtij plani, në koordinim dhe konsultim me ministrinë dhe agjencitë tjera ministri do të:

- Hartoj dhe publikoj procedurat e hollësishme operative për Qendrën Operative të Ministrisë së Punëve të Brendshme (QOMP), Grupin Ndërinstitucional për Menaxhimin e Incidenteve (GNMI), dhe Qendrën e Bashkuar Fushore (QBF);
- Identifikoj asetet e nevojshme dhe të vendos marrëveshjet dhe procedurat për dislokimin dhe angazhimin e tyre të shpejtë në përputhshmëri me incidentet katastrofike të PRK-së.
- Caktoj përfaqësuesit për plotësimin e QOMP-së, GNMI-së me personel, dhe

- Zhvilloj programet adekuate për trajnimin e kuadrove të QOMPB-së, GNMI-së, i deleguari i ministrit dhe Zyrtarin Koordinues Qeveritar (ZKQ).

Brenda një viti nga data e hyrjes së tij në fuqi, ministri i MPB-së do të bëjë një rishikim ndër-institucional të efektshmërisë së PRK-së dhe të ofroj rekomandimet e nevojshme në raport me gjetjet.

Ministritë dhe agjencitë qendrore

Sipas asaj që kërkohet në Vendimin e Kryeministrit të Republikës së Kosovës, ministritë dhe agjencitë qendrore do të:

- Ofrojnë bashkëpunim, resurse dhe mbështetje sipas nevojës për Ministrinë e MPB-së në implementimin e PRK-së, në pajtim me autorizimet dhe përgjegjësitë e tyre përkatëse;
- Caktojnë përfaqësuesit e tyre për plotësimin e QOMPB-së dhe GNMI-së me personel;
- Bartin përgjegjësitë e caktuara për to në Anekset e Funksioneve të Mbështetjes Emergjente (FME) të PRK-së dhe do të hartojnë plane dhe procedura shtesë sipas nevojës;
- Vendosin lidhje dhe t'i raportojnë incidentet tek QOMPB-së ashtu siç është paraqitur në seksionin V (faqe 49) të këtij plani;
- Përshtasin planet dhe protokollet ekzistuese të menaxhimit dhe reagimin ndër-institucional emergjent me PRK-në brenda X ditëve nga publikimi i tij, duke inkorporuar:
 - Lidhjen me proceset dhe strukturat koordinuese kryesore të PRK-së (QSZKM, QOMPB, GNMI, QOER, QBF, etj.);
 - Parimet dhe terminologjinë e përdorur në Sistemin e Integruar të Menaxhimit Emergjent(SIME) dhe PRK;
 - Kërkesat e PRK-së për raportimin e incidenteve;
 - Procedurat për kalim nga incidentet e lokalizuara tek ato me karakter kombëtar dhe
 - Kërkesat për aktivizimin, mobilizimin dhe dislokimin intensiv të resurseve të përvijuara në Aneksin: Incidenti Katastrofik, të këtij plani.

Modifikimi i planeve ekzistuese ndër-institucionale qendrore duhet të përfundoj dhe dorëzohet tek MPB-ja brenda 90 ditëve të publikimit të PRK-së, ministritë dhe agjencitë duhet t'i fillojnë modifikimet brenda këtij afati kohor dhe ta ofrojnë orarin për përfundimin e tyre tek ministri i MPB-së.

Qeveria, Pushteti Lokal dhe Organizatat Jo Qeveritare

Qeveria, degët regjionale, pushteti lokale dhe OJQ-të janë të obliguara të:

- Fusin në përdorim protokollet për raportimin e incidenteve në QOMPB-së sipas procedurave të përvijuara në seksionin V të këtij plani.
- Koordinojnë me QOMPB lidhur me procedurat për vendosjen e lidhjeve për qëllime të menaxhimit të incidenteve vendore. Procedurat e pushteti lokal duhet të koordinohen me regjionin përkatës dhe/ose me agjencinë përkatëse për menaxhim emergjent.
- Modifikojnë planet ekzistuese të menaxhimit dhe reagimit emergjent brenda 90 ditëve, për të siguruar rreshtim adekuat në strukturat, proceset dhe protokollet koordinuese të PRK-së.
- Njoftojnë ministrin e MPB-së për çdo konflikt substancial midis këtij plani dhe ligjeve dhe rregulloreve të rrafshit qendror dhe lokal.

Strukturat e degëve regjionale

Do të:

- Caktojnë përfaqësuesit e tyre për Qendrat Operative Emergjente Regjionale (QOER) me kërkesë të ministrit të MPB-së;
- Hartojnë plane plotësuese regjionale në përkrahje të PRK-së sipas nevojës dhe
- Plotësojnë procedurat ekzistuese standarde operative të QOER –ve për t'i përshtatur me obligimet e përvijuara në PRK.

Sektori privat

Pronarët dhe operuesit e sektori privat, e sidomos ata që përfaqësojnë elementet kritike të infrastrukturës apo të resurseve kyçe, çrregullimi i të cilëve mund të ketë ndikim kombëtar janë të inkurajuar (në disa raste edhe të obliguar sipas ligjit) të hartojnë plane përkatëse të reagimit emergjent dhe të vijueshmërisë së biznesit të tyre, protokollet për shkëmbimin e informacioneve dhe raportimin e incidenteve të mishëruara me kërkesat unike të sektorëve të tyre përkatës dhe të puqura qartë me skemën e planeve të reagimit emergjent lokal dhe rrjetit shtetëror, rajonal dhe lokal për shkëmbimin e informacioneve.

Këto plane dhe protokolle për shkëmbimin e informacioneve dhe raportimin e incidenteve duhet të jenë në përputhje me planin bazik dhe anekset mbështetëse të PRK-së.

HYRJE

Organizimi i Planit të Reagimit Kombëtar

Plani i Reagimit Kombëtar përbëhet prej elementeve të paraqitura në figurën 1 të faqes në vijim. Paragrafët më poshtë shpjegojnë secilin element veç e veç.

- **Plani Themelor** përshkruan strukturën dhe proceset që e përbëjnë qasjen kombëtare ndaj menaxhimit emergjent, qasje kjo e destinuar për t'i integruar angazhimet dhe resurset e sektorit qendror, regjional, lokal, privat dhe të organizatave jo qeveritare. Plani Themelor përfshinë parashikimet e planifikuara, rolet dhe përgjegjësitë, konceptin e zhvillimit të operacioneve, veprimet specifike për menaxhimin e emergjencave dhe udhëzimet për mirëmbajtjen e planit.
- **Shtojcat** ofrojnë informacione plotësuese të hollësishme për termet, definicionet, shkurtesat, autoritetet dhe përmbledhjen e planeve kombëtare ndër-institucionale.

Anekset mbështetëse

- **Menaxhimi financiar** ofron udhëzime për implementimin e PRK-së për tu siguruar që fondet lidhur me emergjencat të sigurohen shpejt dhe në harmoni me ligjet, politikat, rregulloret dhe standardet e caktuara.
- **Koordinimi ndërkombëtar** ofron udhëzime për përmbushjen e përgjegjësive që lidhen me koordinimin ndërkombëtar në mbështetje të reagimit qeveritar ndaj incidenteve vendore me karakter kombëtar.
- **Menaxhimi logjistik** përshkruan kornizën brenda së cilës vepron funksioni i menaxhimit të përgjithshëm logjistik i PRK-së.
- **Koordinimi i sektorit privat** përvijon proceset për sigurimin e integritetit dhe koordinimit efektiv të menaxhimit të emergjencave me sektorin privat, duke përfshirë edhe përfaqësuesit e sektorit të Infrastrukturës dhe Resurseve Kryesore Kombëtare.
- **Marrëdhëniet publike** përshkruan procedurat e komunikimit ndër-institucional të emergjencave për të mundësuar koordinim dhe shpërndarje kohore të informacioneve për publikun gjatë incidenteve me karakter kombëtar.
- **Shkenca dhe teknologjia** siguron udhëzime rreth mekanizmave, për tu siguruar që të gjitha nivelet e qeverisjes mund t'i lëvrojnë resurset kombëtare të shkencës dhe teknologjisë në mënyrë efektive dhe efikase në menaxhimin e incidenteve me karakter kombëtar.
- **Marrëdhëniet regjionale** përshkruan politikat, përgjegjësitë dhe konceptin e operacioneve për koordinimin dhe bashkëveprimin efektiv me strukturat e degëve regjionale gjatë incidenteve me karakter kombëtar.

- **Menaxhimi i vullnetarëve dhe donacioneve** siguron udhëzime për funksionet e menaxhimit të vullnetarëve dhe donacioneve që kanë të bëjnë me incidentet me karakter kombëtar.
- **Siguria dhe shëndeti ipjesëmarrësve në reagim** detajizon proceset për të siguruar angazhim të koordinuar dhe gjithëpërfshirës për identifikimin e rreziqeve për sigurinë dhe shëndetin e reaguesve dhe implementimin e procedurave për zvogëlimin apo eliminimin e sëmundjeve ose lëndimeve gjatë aktiviteteve të menaxhimit të incidenteve dhe të reagimit emergjent.

Plani Themelor	
Shtojcat	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Fjalori i termeve kryesore ▪ Lista e shkurtesave ▪ Autorizimet dhe referencat ▪ Përmbledhja e planeve qendrore ndërinstitucionale
Aneksat e funksioneve të mbështetjes emergjente	<ul style="list-style-type: none"> ▪ FME 1 – Transporti ▪ FME 2 – Komunikimi ▪ FME 3 – Punët publike dhe inxhinierike ▪ FME 4 – Zjarrfikja ▪ FME 5 – Menaxhimi emergjent ▪ FME 6 – Shërbimet e kujdesit masiv dhe strehimit ▪ FME 7 – Mbështetja e resurseve ▪ FME 8 – Shërbimet mjekësore emergjente dhe shëndeti publik ▪ FME 9 – Kërkimi dhe shpëtimi ▪ FME 10 – Reagimi ndaj materieve të rrezikshme ▪ FME 11 – Resurset natyrore dhe bujqësore ▪ FME 12 – Energjia ▪ FME 13 – Siguria publike ▪ FME 14 – Rimëkëmbja afatgjate e komunitetit ▪ FME 15 – Marrëdhëniet me jashtë
Aneksat mbështetëse	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Menaxhimi financiar (të punohet) ▪ Koordinimi ndërkombëtar (për tu punuar) ▪ Menaxhimi logjistik (për tu punuar) ▪ Koordinimi i sektorit privat (për tu punuar) ▪ Marrëdhëniet publike (për tu punuar) ▪ Shkenca dhe teknologjia (për tu punuar) ▪ Marrëdhëniet regjionale (për tu punuar) ▪ Menaxhimi i vullnetarëve dhe donacioneve (për tu punuar) ▪ Siguria dhe shëndeti i punëtorëve (për tu punuar)
Aneksat për incidente	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Incident katastrofikë ▪ Incident i materieve të rrezikshme

Fig.1: Organizimi i Planit të Reagimit Kombëtar

Anekset për incidente

Adresojnë situatat e papritura apo të rrezikshme të cilat kërkojnë aplikim të specializuar të PRK-së. Anekset për incidente përshkruajnë misionet, politikat, përgjegjësitë dhe proceset e koordinimit që drejtojnë, ndërveprimin e entiteteve publike dhe private të angazhuara në menaxhimin e incidenteve dhe operacionet e reagimit emergjent përgjatë tërë spektrit të rreziqeve të mundshme. Anekset për incidente janë të përshkruara në vijim.

- **Aneksi për Incidente Biologjike** i përshkruan aktivitetet e menaxhimit të incidenteve që kanë të bëjnë me ngjarjet e terrorizmit biologjik (mikroorganizma), si dhe shpërthimin e sëmundjeve ngjitëse (epidemi) me rrezik të lartë.
- **Aneksi për Incidente Katastrofike** vendos strategjinë për implementimin dhe koordinimin e reagimit intensiv kombëtar ndaj incidenteve katastrofike.
- **Aneksi për Incidentet Bujqësore dhe të Ushqimit** përshkruan aktivitetet e menaxhimit të incidenteve që kanë të bëjnë me fatkeqësitë e mëdha, sulmet terroriste ose emergjencat tjera që përfshijnë sistemin kombëtar të bujqësisë dhe ushqimit.
- **Aneksi për Incidentet Nukleare/Radiologjike** përshkruan aktivitetet e menaxhimit të incidenteve që kanë të bëjnë me incidentet nukleare/radiologjike.
- **Aneksi për Incidente me Materie të Rrezikshme dhe Karburante** përshkruan aktivitetet e menaxhimit të incidenteve që kanë të bëjnë me incidentet e ndotjeve nga materiet e rrezikshme dhe karburanteve, e që kanë karakter kombëtar.
- **Aneksi për Zbatimin e Ligjit dhe Hetimin e Incidenteve Terroriste** përshkruan strukturat dhe proceset e koordinimit të zbatimit të ligjit dhe hetimeve kriminale në reagim ndaj ngjarjeve terroriste.

PLANI I REAGIMIT KOMBËTAR

I. HYRJE

Pasqyra kombëtare e menaxhimit të emergjencave/incidenteve në vend ka ndryshuar rrënjësisht si rrjedhojë e zhvillimeve të fundit në këtë drejtim. Mjedisi kërcënues i tanishëm përfshinë jo vetëm spektrin tradicional të rreziqeve natyrore, teknologjike dhe atij të shkaktuar nga faktori njeri (siç janë: zjarret fushore dhe urbane, vërshimet, rrjedhjet e vajrave, rrjedhja e materieve të rrezikshme, aksidentet e trafikut, tërmetet, stuhitë, epidemitë dhe çrregullimet në infrastrukturën energjetike dhe të industrisë) por edhe arsenalin vdekjeprurës terrorist të armëve të ndryshme kimike, biologjike, rrezatuese dhe nukleare.

Këto rreziqe dhe kërcënimet komplekse në rritje të shekullit XXI kërkojnë qasje të unifikuar dhe të koordinuar kombëtare për menaxhimin e emergjencave/incidenteve. Strategjia Kombëtare për Siguri për menaxhimin e incidenteve vendore, vendos objektiva të qarta për angazhim të përbashkët kombëtar për t'i parandaluar rreziqet brenda vendit; zvogëlimin e dobësive të vendit ndaj fatkeqësive të mëdha, emergjencave tjera dhe akteve të terrorizmit; si dhe zvogëlimin e dëmeve dhe rimëkëmbjen nga fatkeqësitë e mëdha, emergjencat tjera dhe aktet e terrorizmit që mund të ndodhin në vendin tonë.

Hartimi dhe Implementimi i Plani i Reagimit Kombëtar

Arritja e këtyre objektivave të sigurisë kombëtare është sfida e cila kërkon hapa të guximshëm dhe përmirësime në strukturat, proceset dhe protokollet ekzistuese. Kjo iniciativë e rëndësishme e thirrur për dokumentet e sipër përmendura është hartimi dhe implementimi i Planit të Reagimit Kombëtar (PRK), atribut i Sistemit të Integruar të Menaxhimit Emergjent (SIME), i cili radhit mozaikun e planeve të veçanta qeveritare për menaxhim dhe reagim ndaj incidenteve, në një strukturë unike efektive dhe efikase. Së bashku, PRK dhe SIME integrojnë kapacitetet dhe resurset e juridiksioneve të ndryshme qeveritare, disiplinat e menaxhimit dhe reagimit emergjent, organizatat jo qeveritare dhe sektorin privat në një kornizë kombëtare koherente, të koordinuar dhe të përbashkët për menaxhimin e incidenteve vendore.

PRK duke e shfrytëzuar SIME-në, është një plan për të gjitha llojet e rreziqeve, i cili siguron strukturë dhe mekanizma për politikën e nivelit kombëtar dhe për koordinim operacional të menaxhimit të incidenteve. Në përputhje me modelin e siguruar në SIME, PRK mund të implementohet pjesërisht ose plotësisht në kontekst të rrezikut, parashikimit të një ngjarjeje, ose reagimi ndaj një ngjarje domethënëse. Implementimi selektiv përmes aktivizimit të një apo më shumë komponentëve të sistemit lejon fleksibilitet maksimal në arritjen e kërkesave unike të shkëmbimit të informacioneve dhe operacioneve të gjendjes aktuale dhe mundësimin e bashkëveprimit efektiv midis entiteteve qeveritare dhe jo qeveritare.

PRK është plani themelor operacional për menaxhimin kombëtar të incidenteve. Ai vendos strukturat, proceset dhe protokollat koordinuese të nivelit kombëtar të cilat do të inkorporohen në planet e caktuara gjithëpërfshirëse e specifike për incidente të të gjitha llojeve, të cilët janë të destinuar për implementimin e autorizimeve dhe përgjegjësi specifike statusore të ministrive dhe agjencive të ndryshme në skenarët e veçantë kontingjent. Këto plane janë të lidhur me PRK-në në kontekst të Incidenteve me Karakter Kombëtar, por mbesin si dokumente të pavarura në faktin se ofrojnë protokolle të hollësishme për reagim ndaj incidenteve rutine të cilët normalisht menaxhohen nga agjencitë qeveritare, pa nevojën koordinuese të Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Autoritetet Ekzekutive

Asgjë në këtë plan nuk e ndryshon apo pengon autoritetin e ministrive apo agjencive, strukturave regjionale apo lokale për zbatimin e autorizimeve të tyre të veçanta apo për zbatimin e përgjegjësi të tyre sipas të gjitha ligjeve dhe rregulloreve në fuqi.

Qëllimi

Qëllimi i planit është vendosja e qasjes gjithëpërfshirëse kombëtare për menaxhmentin e incidenteve ndaj të gjitha rreziqeve në spektrin e plot të aktiviteteve të parandalimit, gatishmërisë, reagimit dhe rimëkëmbjes.

Inkorporon përvojat dhe procedurat më të mira nga disiplinat e ndryshme të menaxhimit të incidenteve (siguria kombëtare, menaxhimi emergjent, zbatimi i ligjit, zjarrfikja, reagimi ndaj materieve të rrezikshme, punët publike, shëndeti publik, shërbimi emergjent mjekësor dhe punëtorët e reagimit dhe rimëkëmbjes në fushën e shëndetit dhe sigurisë) dhe i integron ato në strukturën e unifikuar bashkërenduese.

PRK ofron kornizë për ndërveprimin qendror me pushtetin lokal dhe strukturat e degëve regjionale; sektorin privat dhe OJQ-të në kontekst të aktiviteteve të parandalimit, gatishmërisë, reagimit dhe rimëkëmbjes nga incidentet/emergjencat/fatkeqësitë. Plani përcakton kapacitetet dhe resurset dhe cakton përgjegjësitë, proceset operative dhe protokollat për të ndihmuar mbrojtjen e vendit nga rreziqet natyrore, teknologjike dhe të shkaktuara nga faktori njeri; shpëtimin e jetëve; mbrojtjen e shëndetit publik, sigurinë, të mirat materiale dhe mjedisin. Përfundimisht, PRK shërben si bazament për hartimin e planeve procedurave plotësuese të hollësishme për t'i zbatuar në mënyrë më efektive dhe më efikase aktivitetet e menaxhimit të incidenteve, në kontekst të llojeve të veçanta të incidenteve.

PRK duke e shfrytëzuar SIME-në, vendos mekanizmat për:

- Integrimin e aktiviteteve të lidhura me parandalimin, gatishmërinë, reagimin dhe rimëkëmbjen nga incidentet;
- Përmirësimin e koordinimit dhe integritit të partnerëve të strukturave qendrore, regjionale, lokale, të sektorit privat dhe atyre jo qeveritare;
- Rritjen në maksimum të shfrytëzimit efikas të resurseve të nevojshme për menaxhim efektiv të incidenteve dhe mbrojtje të Infrastrukturës Kryesore dhe Resurseve Kryesore (IKRK);
- Përmirësimin e komunikimit të menaxhmentit të incidentit dhe rritjen e të qenit të informuar, lidhur me situatën përgjatë juridiksioneve të ndryshme dhe midis publikut dhe sektorëve privat;

- Lehtësimin e shfrytëzimit të ndihmës reciproke emergjente dhe mbështetjes qendrore emergjente për nivelin regjional dhe lokal;
- Sigurimin e reagimit proaktiv dhe të integruar qendror për ngjarjet katastrofike dhe
- Adresimin e lidhjeve me planet tjera qendrore të menaxhimit të incidenteve dhe reagimit emergjent për llojet e veçanta të incidenteve dhe rreziqeve.

Caku dhe zbatueshmëria

PRK mbulon gamën e plotë të kërkesave komplekse dhe të ndryshueshme në mënyrë konstante, në parashikimin ose reagimin ndaj fatkeqësive të mëdha dhe emergjencave tjera, rreziqeve apo akteve të terrorizmit. PRK, gjithashtu siguron bazat për inicimin e aktiviteteve të rimëkëmbjes afatgjate të komunitetit dhe të aktiviteteve të parandalimit.

PRK vendos mekanizmat ligjor dhe ndërinstitucional për përfshirjen e Qeverisë (MPB-së si Koordinator) në operacionet e menaxhimit të incidenteve.

Kjo përfshinë koordinimin e strukturave dhe proceseve për incidentet që kërkojnë:

- Mbështetjen qendrore për organet shtetërore, lokale dhe regjionale;
- Mbështetjen brenda qeveritare;
- Ushtrimin e autorizimeve dhe përgjegjësive të drejtpërdrejta qendrore, sipas ligjit, dhe
- Integrimin e sektorit privat dhe publik në menaxhimin e incidenteve/emergjencave.

Ky plan bënë ndarjen midis incidenteve që kërkojnë koordinim nga MPB-ja, incidenteve të caktuara si Incidente me Karakter Kombëtar dhe shumicën e incidenteve që ndodhin për çdo ditë, të cilët përballohen nga autoritetet apo agjencitë përgjegjëse nëpërmjet autorizimeve dhe planeve tjera ekzistuese.

Për më tepër, PRK:

- Njeh dhe inkorporon autoritetet e ndryshme juridiksionale dhe funksionale të ministrive dhe agjencive qeveritare; pushtetit lokal dhe strukturave regjionale dhe organizatave të sektorit privat në menaxhimin e incidenteve/emergjencave.
- Saktëson në hollësi rolet dhe përgjegjësitë e veçanta në fushën e menaxhimit të incidenteve/emergjencave të Ministrisë së Punëve të Brendshme, Prokurorit të Shtetit, Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Forcës së Sigurisë së Kosovës, Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe ministrive dhe agjencive tjera të përfshira në menaxhimin e incidenteve/emergjencave sipas SIME-së.
- Vendos strukturat dhe proceset organizative ndërinstitucionale të nevojshme për zbatimin e autoritetit, rolit dhe përgjegjësive të Ministrisë së Punëve të Brendshme në cilësinë e “zyrtarit kryesor qendror” për menaxhimin e incidenteve vendore.

Ky plan është i zbatueshëm për të gjitha ministrinë dhe agjencitë qeveritare të cilat thirren sipas nevojës për të ofruar ndihmë apo për të zhvilluar operacione në kontekst të incidenteve aktuale, apo të mundshme me karakter kombëtar. Këtu përfshihen Kryqi i Kuq i Kosovës, i cili funksionon si organizatë parësore me Funksion të Mbështetjes Emergjente (FME), në koordinimin e shfrytëzimit të resurseve për kujdes masiv në situata emergjente.

Bazuar në kriteret e vendosura në SIME, Incidentet e Karakterit Kombëtar janë ngjarje me pasoja të rënda, që kërkojnë reagim të koordinuar dhe efektiv nga një kombinim i duhur i entiteteve

qendrore, regjionale, lokale, të sektorit privat dhe të atij jo qeveritar me qëllim të shpëtimit të jetëve, zvogëlimit të dëmeve dhe sigurimin e bazës për aktivitetet afatgjata të komunitetit të rimëkëmbjes dhe parandalimit.

Aktivitetet e menaxhimit të incidentit

Ky plan adreson tërë spektrin e aktiviteteve që lidhen me menaxhimin e incidenteve, përfshirë veprimet e parandalimit, gatishmërisë, reagimit dhe rimëkëmbjes. PRK përqendrohet në ato aktivitete të cilat kanë lidhje të drejtpërdrejt me një incident evolues apo një incident të mundshëm, se sa në aktivitetet e zakonshme të përgatitjes apo gatishmërisë të zhvilluara në mungesë të kërcënimit apo rrezikut të caktuar.

PRK ofron kornizë për menaxhimin e goditjeve të befasishme dhe incidenteve të shumëllojshme si dhe për parandalimin e ngjarjeve pasuese dhe përgatitjen për këto ngjarje. Në shembujt e aktiviteteve të menaxhimit të incidentit nga perspektiva kombëtare përfshihen:

- Rritja e vetëdijes publike gjithëkombëtare;
- Zhvillimi i mbikëqyrjes së shëndetit publik dhe vlerësimi i proceseve dhe zhvillimi i gamës së gjerë të masave parandaluese;
- Sigurimi i aseteve të reagimit të menjëhershëm dhe afatgjatë mjekësor dhe të shëndetit publik;
- Koordinimi i mbështetjes qendrore për autoritetet regjionale dhe lokale në vijim të një incidenti;
- Ofrimi i strategjisë për koordinimin e resurseve qendrore të nevojshme për përballimin e ngjarjeve pasuese;
- Vlerësimi i trendeve të aktiviteteve të mundshme terroriste;
- Rikthimi i besimit të publikut pas fatkeqësisë apo aktit terrorist dhe
- Mundësimi i menjëhershëm i aktiviteteve të rimëkëmbjes, si dhe adresimi i pasojave afatgjate në zonën e goditur.

Autorizimet

Autorizimet dhe politikat e ndryshme statusore qeveritare sigurojnë bazat për veprimet dhe aktivitetet qeveritare në kontekst të menaxhimit të incidenteve vendore. PRK shfrytëzon mbështetjen e siguruar nga vendimi i Kryeministrit të Kosovës për Integrimin e Menaxhimit të Emergjencave në Kosovë dhe Krijimin e Planit të Reagimit Kombëtar dhe Ligjin për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera, për të siguruar qasje gjithëpërfshirëse ndaj të gjitha rreziqeve për menaxhimin e incidenteve të të gjitha llojeve. Asgjë në PRK nuk i ndryshon autorizimet ekzistuese të ministrive dhe agjencive individuale qeveritare. PRK nuk bartë asnjë autorizim të ri tek Ministri i Punëve të Brendshme apo tek çdo zyrtar tjetër qeveritar.

Më saktë, ky plan vendos struktura koordinuese, procese dhe protokolle të nevojshme për integrimin e autoriteteve dhe politikave të veçanta statusore të ministrive dhe agjencive të ndryshme qeveritare, në kornizën e përbashkët për veprimet e përfshirjes së aktiviteteve të parandalimit, gatishmërisë, reagimit dhe rimëkëmbjes.

Konceptet kryesore

Ky seksion përmbledh konceptet kryesore të pasqyruara në këtë plan.

- Menaxhimi sistematik dhe i koordinuar i incidenteve përfshinë protokollet për:
 - raportimin e incidentit;
 - veprimet e koordinuara;
 - alarmimin dhe lajmërimin;
 - mobilizimin e resurseve qeveritare për plotësimin e kapaciteteve ekzistuese qendrore, lokale dhe regjionale;
 - veprimin nën kërcënimet e ndryshme ose të niveleve të ndryshme dhe
 - integrimin e funksioneve të menaxhimit të krizave dhe pasojave të tyre.
- Lajmërimi proaktiv dhe dislokimi i resurseve qendrore në parashikim të ngjarjes katastrofike apo reagim ndaj saj në koordinim dhe bashkëpunim me strukturat e nivelit lokal dhe regjional, dhe të sektorit privat kur është e mundur.
- Organizimin e përpjekjeve ndër-institucionale për zvogëlimin e dëmeve, rikthimin e zonave të goditura në gjendjen e para-incidentit nëse është e mundur dhe/ose implementimin e programeve për lehtësimin e dobësive përball ngjarjeve të ardhshme.
- Koordinimin e komunikimit në incident, sigurinë dhe shëndetin e reaguesve, përfshirjen e sektorit privat dhe aktiviteteve tjera të cilat janë të zakonshme për shumicën e incidenteve (shih anekset mbështetëse).
- Organizimin e FME-ve për ta ndihmuar shpërndarjen e resurseve, mjeteve dhe ndihmës esenciale qendrore.
- Sigurimin e mekanizmave për koordinim, komunikim dhe shkëmbim të informacioneve në rrafshin vertikal dhe horizontal në reagim ndaj kërcënimeve apo incidenteve.
- Lehtësimin e mbështetjes qendrore për ministritë dhe agjencitë qeveritare që veprojnë nën autorizimet vetjake.
- Hartimin e procedurave dhe planeve plotësuese operationale, taktike dhe atyre specifike për rreziqet e pritshme.
- Sigurimin e bazamentit për koordinimin e planifikimit, trajnimeve, ushtrimeve, vlerësimeve, koordinimeve dhe shkëmbimit të informacioneve midis akterëve kryesor.

II. PARASHIKIMET DHE KONSIDERATAT PËR PLANIFIKIM

PRK është i bazuar në situatat e parashikuara dhe konsideratat e prezantuara në këtë seksion.

- Incidentet në mënyrë tipike menaxhohen në nivelin më të ulët të mundshëm gjeografik, organizativ dhe juridiksional.
- Aktivitetet e menaxhimit të incidenteve do të iniciohen dhe zhvillohen duke përdorur parimet e përfshira në SIME.
- Ekspertiza dhe kapacitetet e qeverisjes në të gjitha nivelet, sektorin privat dhe organizata jo qeveritare do të jenë të nevojshme për parandalimin, përgatitjen, reagimin dhe rimëkëmbjen nga Incidentet me Karakter Kombëtar.
- Incidenti me Karakter Kombëtar kërkon nga Ministri i Punëve të Brendshme të bëjë koordinimin e operacioneve apo resurseve.
- Këto incidente mund të:
 - ndodhin në çdo kohë me apo pa paralajmërim në kontekst të kërcënimit apo rrezikut të përgjithshëm apo të veçantë;
 - kërkojnë shkëmbim domethënës të informacioneve në nivelet e klasifikuara dhe të pa klasifikuara përgjatë juridiksioneve të ndryshme, midis publikut dhe sektorit privat;
 - përfshijnë rreziqe dhe kërcënime të ndryshme dhe të mëdha në shkallë lokale, regjionale apo kombëtare;
 - kanë ndikim domethënës ndërkombëtar dhe kërkojnë shkëmbim të informacioneve, koordinim të resurseve dhe ndihmë domethënëse ndërkombëtare;
 - përfshijnë rreziqet ose kërcënimet e ndryshme të larta në nivelin lokal, regjional dhe kombëtar;
 - rezultojnë në numër të madh të të lënduarve, vdekjeve, njerëzve të zhvendosur, humbjeve në pronë, çrregullimin e sistemeve të jetës normale, shërbimeve esenciale publike, infrastrukturës elementare dhe dëmeve domethënëse të mjedisit;
 - mbingarkojnë kapacitetet e qeverisjes qendrore, lokale dhe regjionale dhe të pronarëve dhe operatorëve të infrastrukturës së sektorit privat;
 - nxitin fluks të madh të furnizimeve dhe vullnetarëve të pavarur dhe spontan;
 - kërkojnë koordinim dhe reagim të aseteve qeveritare me afat jashtëzakonisht të shkurtë të paralajmërimit dhe
 - kërkojnë aktivitete të zgjatura dhe të qëndrueshme të operacioneve dhe mbështetjes së menaxhimit të incidenteve;
- Dislokimi i resurseve dhe aktivitetet e menaxhimit të incidenteve gjatë një incidenti aktual apo të mundshëm terrorist zhvillohen në koordinim me Ministrinë e Drejtësisë.
- Nga ministrinë dhe agjencitë e të gjitha niveleve të qeverisjes dhe OJQ-të e caktuara si, Kryqi i Kuq i Kosovës, duhen që të angazhohen në Incidentet me Karakter Kombëtar me paralajmërim të menjëhershëm për të siguruar ndihma reciproke dhe/ose ndihmë efektive koherente.
- Shkalla e përfshirjes qeveritare në operacionet e incidentit varet shumë nga autoriteti apo juridiksioni specifik qeveritar. Në faktorët tjerë që mund të merren parasysh përfshihen:

- nevojat dhe kërkesat e nivelit lokal, regjional dhe qendror për mbështetje nga jashtë, mundësa e tyre për ta menaxhuar incidentin;
 - mundësitë ekonomike të entitetit të goditur për tu rimëkëmbur nga incidenti;
 - lloji dhe vendndodhja e incidentit;
 - ashpërsia dhe gjerësia e incidentit dhe
 - nevoja për mbrojtjen e shëndetit publik, mirëqenies së qytetarëve dhe mjedisit.
- Ministritë dhe agjencitë qeveritare mbështesin misionin e sigurisë kombëtare në përputhshmëri me autorizimet dhe udhëzimet, si dhe pritjet që të sigurojnë:
 - reagim fillestar dhe të vazhdueshëm kur kërkohet, sipas autoritetit dhe fondeve të tyre vetjake;
 - njoftim, paralajmërim, para-pozicionim dhe shpërndarje koherente të resurseve për ta mundësuar menaxhimin e incidenteve aktuale apo të mundshme të karakterit kombëtar dhe
 - mbështetje pro-aktive për incidentet katastrofike duke përdorur protokollet për shpërndarje të shpejt të resurseve.
 - Mbështetja brenda qeveritare i referohet rrethanave në të cilat ministria apo agjencia qeveritare kërkon mbështetjen e resurseve qendrore sipas PRK-së, e cila nuk është e adresuar me ligjin e lartpërmendur apo mekanizmat tjerë. (si: Udhëzimet Administrative, Marrëveshjet, Memorandumet e Mirëkuptimit, etj.)

III. ROLET DHE PËRGJEGJËSITË

Ky seksion shtjellon rolet dhe përgjegjësitë e organizmave qendror, lokal, regjional, sektorit privat, organizatave jo qeveritare dhe qytetarëve të përfshirë në mbështetje të menaxhimit të incidenteve vendore.

Pushteti Qendror, Lokal dhe Degët Regjionale

Pjesëtarët e policisë, zjarrfikjes dhe shpëtimit, shëndetit publik dhe urgjencës, menaxhimit emergjent, shërbimeve publike, reaguesve mjedisor dhe personeli tjetër, janë më së shpeshti të parët që arrijnë në vendin e incidentit dhe të fundit që largohen prej aty. Në disa raste, agjencia qeveritare në territorin lokal mund të veprojnë si reagues i parë dhe pronat e agjencisë qeveritare në territorin lokal mund të shfrytëzohen për t'i udhëzuar apo ndihmuar zyrtarët shtetëror apo lokal, në marrëveshje me autorizimet dhe procedurat e agjencisë. Marrëveshjet për ndihma reciproke sigurojnë mekanizma për mobilizimin dhe angazhimin e resurseve nga juridiksionet fqinje për ta mbështetur komandën e incidentit.

Kur resurset dhe kapacitetet lokale janë të mbingarkuara, kryetarët e komunave mund të kërkojnë mbështetje qendrore nën kushtet e shpalljes së gjendjes emergjente apo fatkeqësie. Përgjegjësitë e poshtme janë përgjegjësi të kryetarit të komunës.

Kryetari i Komunës

Si shef i ekzekutivit të komunës, kryetari është përgjegjës për siguri publike dhe mirëqenie të qytetarëve në atë komunë. Kryetari:

- Është përgjegjës për koordinimin e resurseve komunale për adresimin e spektrit të plotë të veprimeve të parandalimit, gatisshmërisë, reagimit dhe rimëkëmbjes nga incidentet në kontekstin e të gjitha rreziqeve duke përfshirë fatkeqësitë natyrore, teknologjike, aksidentet dhe rastisjet tjera;
- Nën rrethana të caktuara emergjente, ka fuqi politike për bërjen, ndryshimin dhe shfuqizimin e urdhrave dhe rregulloreve;
- Siguron udhëheqje dhe luan rol kyç në komunikim me publikun dhe ndihmën për njerëzit, bizneset dhe organizatat në përballje me pasojat e çdo emergjence të shpallur brenda juridiksionit të komunës;
- Nxitë pjesëmarrjen në ndihmat reciproke dhe ushtron autoritetin e tij për tu futur në marrëveshje për ndihmë reciproke me komunat tjera për ta lehtësuar shkëmbimin e resurseve;
- Kërkon asistencë qendrore, kur bëhet e qartë që kapacitetet komunale do të jenë të pamjaftueshme, të tejkaluara apo të raskapitura.

Qeveria

Ministria e Punëve të Brendshme

Misioni i Ministrisë së Punëve të Brendshme është zhvillimi, ruajtja dhe rritja e sigurisë për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës dhe në bashkëpunim me ta, të jetë e gatshme të parandaloj, përgatitet, reagojë dhe rimëkëmbet nga fatkeqësitë natyrore, teknologjike dhe ato të shkaktuara nga faktori njeri.

Ministri i Punëve të Brendshme

Ministri i Punëve të Brendshme është përgjegjës për koordinimin e operacioneve qendrore brenda Kosovës për tu përgatitur, reaguat dhe rimëkëmbur nga fatkeqësitë natyrore, teknologjike dhe të shkaktuara nga faktori njeri. Ministri i Punëve të Brendshme është “koordinator qeveritar” për menaxhimin e incidenteve vendore.

Në këtë rol, ministri gjithashtu është përgjegjës për koordinimin e resurseve qendrore të përdorura në reagim dhe rimëkëmbje nga fatkeqësitë natyrore, teknologjike, të faktorit njeri apo emergjencat tjera nëse dhe kur njëra nga katër kushtet në vijim aplikohet:

1. Ministria apo agjencia qeveritare në veprim (sipas autoritetit të saj vetjak) ka kërkuar ndihmën e Qeverisë;
2. Resurset regjionale dhe të autoriteteve lokale janë mbingarkuar dhe është kërkuar ndihma qendrore;
3. Më shumë se një ministri apo agjenci janë përfshirë thellësisht në reagim ndaj incidentit; apo
4. Ministri është urdhëruar që të marr përsipër përgjegjësinë e menaxhimit të incidentit nga ana e Kryeministrit.

Prokurori i Shtetit

Prokurori i Shtetit është Zyrtari Kryesor i Zbatimit të Ligjit në Republikën e Kosovës.

Në pajtueshmëri me ligjet në fuqi, Prokurori i Shtetit ka përgjegjësinë kryesore për hetimet kriminale të akteve apo kërcënimeve terroriste nga individët apo grupet brenda territorit të Republikës së Kosovës, apo të drejtuara drejt qytetarëve apo institucioneve jashtë RK-së ku aktet e tilla janë nën juridiksionin kriminal shtetëror të RK-së.

Duke vepruar në bashkëpunim me ministrinë dhe agjencitë tjera qendrore angazhohet në aktivitetet e anëtarëve tjerë të komunitetit të zbatimit të ligjit për të zbuluar, parandaluar, frenuar dhe çrregulluar aktet terroriste kundër RK-së.

Në vijim të kërcënimit terrorist apo një incidenti aktual i cili bie brenda juridiksionit kriminal të RK-së, tërë kapacitetet e vendit do t'i vihen në ndihmë Prokurorit të Shtetit për të identifikuar dhe vënë para drejtësisë keqbërësit në pajtueshmëri me ligjet e RK-së dhe me autoritetin e ministrive dhe agjencive tjera qendrore për ta mbrojtë sigurinë kombëtare.

Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës

Ministria e Forcës së Sigurisë së Sigurisë ka ekspertizë dhe resurse të dukshme për ta mbështetur reagimin qendror ndaj një incidenti me karakter kombëtar.

Ministri i Forcës së Sigurisë së Kosovës

Ministri i Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) autorizon mbështetjen e FSK-së për autoritetet civile për incidentet vendore sipas urdhërit të kryetarit, apo kur është në pajtueshmëri me operacionet e gatishmërisë së FSK-së dhe e duhur sipas rrethanave ekzistuese dhe ligjit. Ministri i FSK-së ruan autoritetin e komandimit të FSK-së në të gjitha situatat dhe operacionet.

Ministria e Punëve të Jashtme

Ministria e Punëve të Jashtme (MPJ) ka përgjegjësi të koordinimit ndërkombëtar.

Ministri i Punëve të Jashtme

Është përgjegjës për koordinimin e aktiviteteve ndërkombëtare të parandalimit, gatishmërisë, reagimit dhe rimëkëmbjes të lidhura për incidentet vendore dhe për mbrojtjen e qytetarëve dhe interesave të Republikës së Kosovës jashtë vendit.

Institucionet tjera qendrore

Gjatë një Incidenti të Karakterit Kombëtar, ministritë dhe agjencitë tjera qeveritare mund të luajnë rol parësor, koordinues dhe/apo mbështetës, varësisht nga resurset e tyre dhe natyra e incidentit. Në situatat ku agjencia e caktuar qeveritare ka autoritetin dhe përgjegjësinë juridiksionale për drejtimin apo menaxhimin e aspekteve kryesore të reagimit, kjo agjenci është pjesë e lidershit qendror. (Shih seksionin IV)

Disa agjenci qeveritare me përgjegjësi dhe autoritet ligjor, gjithashtu mund të marrin pjesë në Komandën e Bashkuar në Postë Komandën e Incidentit (PKI). Ministritë dhe agjencitë qeveritare marrin pjesë në strukturën e Funkcionit Mbështetës Emergjent (FME), si koordinatorë të agjencive kryesore apo mbështetëse, nga të cilat është kërkuar për t'i mbështetur aktivitetet e menaxhimit të incidentit të caktuar.

Disa agjenci qeveritare kanë autoritet të pavarur për të shpallur fatkeqësitë apo emergjencat. Këto autoritete mund të ushtrohen në harmoni me fatkeqësinë apo të bëhen pjesë e fatkeqësisë madhore apo emergjencës së shpallur, sipas ligjit për FNFT. Disa shembuj të agjencive që ushtrojnë autoritet të pavarur përfshijnë skenarët në vijim:

- Ministri i Bujqësisë mund të shpall fatkeqësi në situata të caktuara në të cilat një regjion ka pësuar humbje prej 30% e më shumë të prodhimit të saktuar, duke autorizuar hua emergjente për dëme në të mira materiale dhe humbjeve në të lashta.
- Ministri i Shëndetësisë mund të shpall emergjencë të shëndetit publik.
- Koordinatori Qeveritar në Vendngjarje (KQVN) i caktuar nga Ministria e Mjedist dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH), ka autoritetin për drejtimin e përpjekjeve të reagimit në vendngjarje të shkarkimit apo rrjedhjes së vajit, substancave të rrezikshme, ndotësve apo kontaminuesve varësisht nga substanca, vendi dhe burimi i rrjedhjes.

Anekset e funksioneve të mbështetjes emergjente, të mbështetjes dhe të incidenteve ofrojnë më tepër sqarime rreth roleve dhe përgjegjësi të ministrive dhe agjencive tjera qeveritare në menaxhimin e incidenteve.

Funksionet e mbështetjes emergjente

PRK përdorë qasjen funksionale e cila bashkon kapacitetet e ministrive dhe agjencive qeveritare dhe Kryqit të Kuq të Kosovës (KKK) në FME, për të siguruar planifikim, mbështetje, resurse, zbatim të programit dhe shërbime emergjente të cilat mund të duhen më së shumti gjatë Incidenteve me Karakter Kombëtar. Reagimi qendror ndaj incidenteve aktuale apo të mundshme të karakterit kombëtar në mënyrë tipike, sigurohet nëpërmjet aktivizimit të plotë apo të pjesshëm të strukturës së FME-së. FME shërben si mekanizëm koordinues për të siguruar ndihmë për autoritetet e nivelit lokal dhe regjional apo për ministrinë dhe agjencitë që kryejnë misione të përgjegjësive parësore qendrore. FME siguron personel plotësues për Qendrën e Situatave, Këshillit të Sigurisë Kombëtare (QSKSK), Qendrën Operative të Ministrisë së Punëve të Brendshme (QOMP), Qendrën Operative të Agjencisë së Menaxhimit Emergjent (QOAME), Qendrat Operative Emergjente Regjionale (QOER) të Agjencisë së Menaxhimit Emergjent, QBF-në dhe PKI-në sipas nevojës që dikton situata e dhënë.

FME është i përbërë nga agjencitë parësore dhe agjencitë mbështetëse. PRK - agjencitë parësore i përcakton mbi bazën e autoritetit, resurseve dhe kapaciteteve të tyre. Agjencitë mbështetëse janë të caktuara mbi bazën e resurseve dhe kapaciteteve në fushën e caktuar funksionale. Resurset e siguruar nga FME-të reflektojnë resurset e kategorizuara sipas llojit të përcaktuara në SIME. Fusha e secilit FME është e përmbledhur në Figurën 2 të faqes pasuese. Nga FME pritet që ta mbështesin njëra tjetrën në zbatim të roleve dhe përgjegjësi të tyre përkatëse.

Organizatat Jo Qeveritare dhe Vullnetare

OJQ-të bashkëpunojnë me reaguesit e parë, pushtetin e të dyja niveleve, agjencitë dhe organizatat tjera që ofrojnë shërbime ndihmash për mbështetjen jetësore, zvogëlimin e dhimbjeve fizike dhe emocionale dhe përkrahin rimëkëmbjen e viktimave të fatkeqësisë, kur ndihma nuk është e mundshme nga burimet tjera. Për shembull, KKK është një OJQ e cila ofron ndihma në nivelin lokal dhe gjithashtu koordinon elementin e kujdesit masiv të FME 6.

Organizatat vullnetare ofrojnë kapacitete domethënëse në përpjekjet për menaxhimin e incidenteve dhe reagimin ndaj tyre në të gjitha nivelet.

Figura 2: Funkzionet Mbështetëse Emergjente

FME	Fushëveprimi
FME 1 – Transporti	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Menaxhimi dhe kontrolli i aviacionit/hapësirës ajrore ▪ Siguria e transportit ▪ Riparimi dhe rimëkëmbja e infrastrukturës së transportit ▪ Kufizimet e lëvizjes ▪ Vlerësimi i dëmeve dhe efektit goditës
FME 2 – Komunikimi	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Koordinimi me industrinë e teknologjisë së telekomunikimit dhe informimit ▪ Riparimi dhe rimëkëmbja e infrastrukturës së telekomunikimit ▪ Mbrojtja, riparimi dhe mbajtja e resurseve kombëtare të teknologjisë informative ▪ Mospengimi i komunikimit brenda strukturave Qendrore të menaxhimit dhe reagimit ndaj incidenteve.
FME 3 – Punët publike dhe inxhinierike	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Mbrojtja dhe riparimi emergjent i infrastrukturës ▪ Restaurimi i infrastrukturës ▪ Shërbimet inxhinierike dhe menaxhimi i ndërtimeve ▪ Mbështetja e kontraktuar emergjente për shërbimet e shpëtimit të jetës dhe mirëqenies jetësore.
FME 4 – Zjarrfikja	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Koordinimi i aktiviteteve Qendrore të zjarrfikjes ▪ Mbështetja e operacioneve zjarrfikëse fushore, rurale dhe urbane
FME 5 – Menaxhimi emergjent	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Koordinimi i përpjekjeve të reagimit dhe menaxhimit të incidenteve ▪ Lëshimin e caktimit të misioneve ▪ Resurset dhe kapitali njerëzor ▪ Planifikimi i veprimeve për incident ▪ Menaxhimi financiar
FME 6 – Kujdesi masiv, asistenca emergjente, strehimi dhe shërbimi human	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Kujdesi masiv ▪ Asistenca emergjente ▪ Strehimi nga fatkeqësitë ▪ Shërbimet humane
FME 7 – Menaxhimi i logjistikës dhe mbështetja e resurseve	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Kapacitetet gjithëpërfshirëse kombëtare të planifikimit, menaxhimit dhe qëndrueshmërisë logjistike ▪ Mbështetja e resurseve (hapësira pune, pajisje dhe furnizime zyrash, shërbime kontraktuese, etj.)
FME 8 – Shëndeti publik dhe shërbimet mjekësore	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Shëndeti publik ▪ Mjekësia ▪ Shërbimet e shëndetit mendor ▪ Shërbimet mortore
FME 9 – Kërkim dhe shpëtimi	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Asistenca në shpëtimin e jetës ▪ Operacionet e kërkimit dhe shpëtimit
FME 10 – Reagimi ndaj vajrave dhe materialeve të rrezikshme	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Reagimi ndaj vajrave dhe materieve të rrezikshme (kimike, biologjike, radiologjike, etj.) ▪ Pastrimi afatshkurt dhe afatgjatë i mjedisit
FME 11 – Resurset bujqësore dhe natyrore	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Asistenca ushqimore ▪ Reagimi ndaj sëmundjeve të kafshëve, bimëve dhe insekteve ▪ Siguria e ushqimit ▪ Mbrojtja e resurseve natyrore, kulturore dhe pasurisë historike ▪ Siguria dhe mirëqenia e kafshëve shtëpiake
FME 12 – Energjia	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Vlerësimi, riparimi dhe rivendosja e infrastrukturës energjetike ▪ Koordinimi i shërbimeve të industrisë energjetike ▪ Parashikimet energjetike
FME 13 – Siguria publike	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Siguria e hapësirave dhe resurseve ▪ Planifikimi për siguri dhe asistenca e resurseve teknike ▪ Mbështetja e sigurisë publike ▪ Mbështetja e kontrollit të qasjeve, trafikut dhe turmave
FME 14 – Rimëkëmbja afatgjate e komunitetit	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Vlerësimi i efektit goditës në komunitetin social dhe ekonomik ▪ Asistencë në rimëkëmbjen afatgjate të komuniteteve të nivelit regjional, lokal dhe sektorit privat. ▪ Analizimi dhe rishikimi i zbatimit të programeve lehtësuese
FME 15 – Çështjet e jashtme	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Udhëzime për informim emergjent publik dhe veprime mbrojtëse ▪ Marrëdhëniet me media dhe komunitet ▪ Çështjet parlamentare dhe ndërkombëtare

Sektori privat

Agjencitë parësore dhe mbështetëse të MPB-së dhe PRK-së, koordinojnë me sektorin privat për shkëmbimin efektiv të informacioneve, formimin e kurseve të veprimit dhe përfshirjen e resurseve në dispozicion për të parandaluar, përgatitur, reaguar dhe rimëkëmbur nga Incidentet e Karakterit Kombëtar. Për më tepër Ministri i Punëve të Brendshme shfrytëzon grupin këshillues të sektorit privat, me prezencë të gjerë për të siguruar këshilla në çështjet e menaxhimit të incidenteve dhe reagimit emergjent, që godasin fushëveprimin e tyre.

Rolet: Rolet përgjegjësitë dhe pjesëmarrja e sektorit privat gjatë Incidenteve të Karakterit Kombëtar, ndryshon bazuar në natyrën e organizimit, llojit dhe efektit të incidentit. Rolet e organizatave të sektorit privat janë të përmbledhura më poshtë.

Lloji i Organizatës	Roli
Organizata apo infrastruktura e goditur	Organizatave të sektorit-privat mund të goditen nga pasojat e incidentit drejtpërdrejt apo tërthorazi, duke përfshirë infrastrukturën kritike në pronësi private, resurset kryesore dhe ato organizata të cilat janë domethënëse për rimëkëmbjen ekonomike nga incidentet e nivelit lokal, regjional dhe kombëtar. Shembujt e infrastrukturës në pronësi private përfshijnë transportin, telekomunikimin, institucionet financiare dhe spitalet.
Resurs Reagues	Organizatave të sektorit privat sigurojnë resurse reaguese (të dhuruara apo me kompensim) gjatë një incidenti (përfshirë ekipet e specializuara, pajisjet dhe teknologjinë e avancuar) nëpërmjet planeve lokale emergjente publike-private, marrëveshjeve të ndihmës reciproke, apo kërkesave të veçanta nga qeveria dhe iniciativat vullnetare të sektorit privat.
Palë rregulluese dhe/apo përgjegjëse	Pronarët/operatorët e objekteve me rregulla të veçanta apo me veprimtari të rrezikshme mund të bartin përgjegjësi sipas ligjit për tu përgatitur për incidente, për t'i parandaluar ato dhe të reagojnë ndaj tyre kur të ndodhin.
Anëtar i Organizatës Emergjente Qëndrore/Lokale	Organizatave të sektorit privat mund të shërbejnë si një partner aktiv në aktivitetet për gatishmëri dhe reagim emergjent ndaj një incidenti

Përgjegjësitë: Organizatave të sektorit privat mbështesin PRK-në (vullnetarisht apo me bindje sipas ligjeve dhe rregulloreve në fuqi) duke shkëmbyer informacione me qeverinë, duke identifikuar rreziqet, duke bërë vlerësimin e dobësive, duke hartuar plane për reagim emergjent dhe vijimësi të veprimtarisë, duke ngritur gatishmërinë e përgjithshme të tyre, duke implementuar programe përkatëse të parandalimit dhe mbrojtjes dhe duke dhuruar ose siguruar të mira dhe shërbime përmes marrëveshjeve kontraktuese për të ndihmuar në reagim dhe rimëkëmbje nga incidentet.

Sipas ligjeve dhe rregulloreve në fuqi organizatave të caktuara, u kërkohet për të marrë përsipër koston e planifikimit dhe reagimit ndaj incidenteve pavarësisht nga shkaku i tyre. Në rastet e Incidenteve të Karakterit Kombëtar nga këto organizata të sektorit privat pritet që të mobilizojnë dhe angazhojnë resurset e nevojshme në dispozicion në pajtueshmëri me planet e tyre për t'i adresuar pasojat e incidentit në ambientet e tyre vetjake, apo incidentet për të cilat në njëfarë mënyre ata janë përgjegjës.

Resurset reaguese: Edhe pse roli reagues është qenësisht qeveritar (si, zbatimi i ligjit, etj.), organizatat e sektorit privat janë të inkurajuara që të zhvillojnë dhe mirëmbajnë kapacitete reaguese për të reaguar dhe menaxhuar spektrin e plot të incidenteve dhe emergjencave. Qeveria mban ndërveprim të vazhdueshëm me industrinë e infrastrukturës kritike dhe resurseve kryesore për të siguruar koordinim për aktivitetet e parandalimit, gatishmërisë, reagimit dhe rimëkëmbjes. Kur është praktike apo kur kërkohet me ligj, përfaqësuesit e sektorit privat do të përfshihen në planifikim dhe ushtrime. Në disa raste qeveria mundet t'i urdhëroj resurset reaguese të sektorit privat kur ato kanë marrëdhënie kontraktuese.

Koordinimi funksional: Agjencia (it) parësore të secilit FME mbajnë marrëdhënie pune me homologët e tyre përkatës të sektorit privat, nëpërmjet komiteteve të partneritetit apo mënyrave tjera (si p.sh. FME 2 - Industria e Komunikimit-Telekomunikimit; FME 10 - Reagimi ndaj Vajrave dhe Materieve të Rrezikshme) me industrinë e vajrave dhe materieve të rrezikshme; etj.).

Përfshirja e qytetarëve

Partneriteti i fuqishëm me grupet dhe organizatat qytetare, siguron mbështetje për parandalim, gatishmëri, reagim, rimëkëmbje dhe lehtësim të menaxhimit të incidenteve.

Kryqi i Kuq i Kosovës, i bashkon këto grupe dhe i përqëndron përpjekjet e individëve përmes edukimit, trajnimeve dhe shërbimeve vullnetare për të ndihmuar në krijimin e komuniteteve më të sigurta më të fuqishme dhe më të përgatitura, për t'i adresuar kërcënimet e terrorizmit, krimit, çështjeve të shëndetit publik dhe fatkeqësive të të gjitha llojeve.

Këshillat Lokale për Siguri në Bashkësi, zbatojnë programet e vetëdijësimit të qytetarëve i cili përfshinë ngritjen e Ekipeve të Komunitetit për Reagim Emergjent (EREK).

Programet e tilla të përfshirjes së qytetarëve, zgjerojnë resurset dhe asetet në dispozicion të qeverisë dhe komuniteteve lokale për të ndihmuar reaguesit e parë, aktivitetet e ndihmave në fatkeqësi dhe përpjekjet për siguri të komuniteteve.

IV. KONCEPTI I VEPRIMIT

I përgjithshëm

Ky seksion përshkruan strukturat, proceset dhe protokollet koordinuese qendrore të angazhuara për menaxhimin e Incidenteve me Karakter Kombëtar. Këto struktura dhe procese koordinuese janë të destinuara për të mundësuar zbatimin e përgjegjësive të qeverisë, nëpërmjet ministrive dhe agjencive përkatëse qeveritare dhe për t'i integruar angazhimet e komunave, degëve regjionale, OJQ-ve dhe sektorit privat në qasjen gjithëpërfshirëse kombëtare ndaj menaxhimit të incidenteve në Kosovë.

Kushti paraprak themelor i PRK-së është që: incidentet në përgjithësi të përballen në nivelin më të ulët të mundshëm juridiksional. Policia, zjarrfikësit, shëndeti publik, menaxhimi emergjent dhe personeli tjetër janë përgjegjës për menaxhimin e incidentit në nivelin lokal. Në disa raste, agjencia qeveritare në territorin lokal mund të veproj si reagues i parë dhe mund të siguroj drejtim dhe ndihmë në pajtim me përgjegjësitë dhe autorizimet e saja ligjore. Normalisht, në shumicën e incidenteve, resurset regjionale dhe lokale dhe ndihmat reciproke ndër-komunale sigurojnë vijën e parë të reagimit emergjent dhe mbështetjen për menaxhmentin e incidentit.

Kur një incident aktual apo i mundshëm është i përmasave, gjerësisë dhe kompleksitetit të atillë sa që konsiderohet Incident me Karakter Kombëtar në bazë të kritereve të caktuara në këtë plan, Ministria e Punëve të Brendshme në koordinim me ministrinë dhe agjencitë tjera qeveritare, inicion veprimet për parandalimin, përgatitjen, reagimin dhe rimëkëmbjen nga incidenti. Këto veprime ndërmerren në lidhshmëri me entitetet regjionale, lokale, joqeveritare dhe të sektorit privat sipas kërcënimit apo incidentit të caktuar.

Koordinimi i përgjithshëm i aktiviteteve qendrore të Menaxhimit të Incidentit

Kryeministri e udhëheq vendin në reagimin efektiv dhe siguron që resurset e domosdoshme angazhohen shpejt dhe me efikasitet të plotë tek të gjitha Incidentet e Karakterit Kombëtar. Sipas nevojës, thërret takimet ndër-institucionale për t'i koordinuar çështjet e politikave dhe strategjive të veprimit.

Gjatë incidenteve aktuale apo të mundshme të Karakterit Kombëtar, koordinimi i të gjitha aktiviteteve qendrore të menaxhimit të incidentit bëhet nëpërmjet Ministrisë së Punëve të Brendshme. Ministrinë dhe agjencitë tjera qeveritare, autoritetin dhe përgjegjësitë e tyre për menaxhimin e incidenteve dhe të reagimit emergjent e bartin brenda kësaj kornize koordinuese.

Koordinimi i menaxhimit të incidentit dhe ndërtimi i kursit të veprimeve të nivelit strategjik ndihmohet nga GNMI, i cili gjithashtu shërben si trup këshillëdhënës për Ministrinë e Punëve të Brendshme. Çështjet për tu zgjidhur përtej autoritetit të ministrit i referohen për zgjidhje entitetit përkatës në Zyrën e Kryeministrit.

Në nivelin regjional koordinimi i resurseve ndër-institucionale dhe mbështetja shum-institucionale e incidentit sigurohet nga QOER. Në terren Ministri i Punëve të Brendshme përfaqësohet nga Zyratari i Deleguar i Ministrisë (IDM). Mbështetja e gjithmbarshme qendrore për strukturën komanduese në vendin e ngjarjes koordinohet nëpërmjet Qendrës së Bashkuar Fushore (QBF).

QOER koordinon përpjekjet reaguese regjionale, vendos prioritetet qendrore dhe implementon programin e mbështetjes lokale derisa të themelohet QBF.

QBF është entitet i përkohshëm qendror i themeluar në nivelin lokal për koordinimin e aktiviteteve operative të asistencës qendrore për juridiksionin (et) e goditur gjatë Incidenteve të Karakterit Kombëtar.


Korniza e krijuar nga këto struktura koordinuese është e destinuar për të akomoduar rolet e ndryshme që luan qeveria gjatë një incidenti, qoftë ajo mbështetje qendrore (nëpërmjet degëve regjionale për autoritetet lokale; mbështetje brenda qeveritare; apo zbatimi i drejtpërdrejt i autorizimeve dhe përgjegjësi qendrore të menaxhimit të incidenteve kur është në përputhje me ligjin. Kjo strukturë gjithashtu ngërthen rolet dhe përgjegjësitë e dyfishta të Ministrit të Punëve të Brendshme për koordinimin e operacioneve dhe resurseve në kontekstin e menaxhimit të incidenteve.

Struktura organizative

Struktura kombëtare për menaxhimin e incidenteve vendos rrjedhën e qartë të komunikimit dhe koordinimit nga niveli lokal tek ai regjional dhe deri tek ai i zyrave qendrore. Kjo strukturë është e skicuar në figurën 3..


Siç është ilustruar në figurën 3, strukturat komanduese të nivelit lokal (të emëruara PKI dhe Komanda Regjionale) janë përgjegjëse për drejtimin e menaxhimit emergjent në vendngjarje dhe për mbarëvajtjen e komandimit dhe kontrollit të operacioneve të incidentit në vendngjarje.

Pjesë e figurës 3. Komanda e Incidentit




Komponentet mbështetëse dhe koordinuese konsistojnë nga qendrat koordinuese ndërinstitucionale/qendrat operative emergjente (QOE) dhe entitetet koordinuese ndërinstitucionale. Qendrat koordinuese ndërinstitucionale sigurojnë lokacion qendror për shkëmbim të informacioneve operative dhe koordinim të resurseve në mbështetje të angazhimeve në vendngjarje.

**Pjesë e figurës 3.
QOE/Qendrat
Koordinuese
Ndërinstitucionale**



Entitetet Koordinuese Ndërinstitucionale ndihmojnë në vendosjen e prioriteteve midis incidenteve dhe ndarjen e resurseve, zgjidhjen e konflikteve të politikave të agjencisë përkatëse dhe për sigurimin e udhëzimeve strategjike për mbështetjen e aktiviteteve të menaxhimit të incidenteve.

**Pjesë e Figurës 3.
Entitetet Koordinuese
Ndërinstitucionale**



Në përputhje me proceset e SIME-së çështjet e resurseve dhe politikave praktikisht adresohen në nivelin më të ulët organizativ. Nëse çështja nuk mund të zgjidhet në atë nivel, ato dërgohen për zgjidhje tek niveli i radhës. Duke pasqyruar ndërtimin e SIME-së, PRK përfshinë strukturat komanduese dhe koordinuese si në vijim:

- PKI/KB në vendngjarje;
- Komanda Regjionale (nëse nevoitet);
- QOE lokale dhe të sektorit privat;
- QBF, e cila është përgjegjëse për koordinimin e ndihmës qendrore dhe për mbështetjen e aktiviteteve të menaxhimit të incidentit në nivel lokal;
- QOER dhe QO e AME-së të cilat shërbejnë si qendra të nivelit regjional dhe qendror ndërinstitucional për njohje të situatës dhe koordinim të operacioneve;
- QOMPB dhe QO tjera të nivelit qendror;
- GNMI, i cili shërban si zyre e nivelit qendror, entitet shumë-institucional koordinues për menaxhimin e incidenteve dhe
- QSKSK shërbenë si entitet shumë-institucional mbështetës i nivelit qendror.

Struktura organizative e PRK-së adreson të dyja anët – aktivitetet e menaxhimit të incidenteve të veçanta dhe aspektet e gjëra regjionale dhe qendrore të lidhura me incidentin, siç janë efektet në pjesën tjetër të komunitetit, veprimet e menjëhershme regjionale apo qendrore të nevojshme për evitimin ose përgatitjen për ngjarjet e mundshme pasuese dhe menaxhimin e kërcënimeve apo incidenteve të shumëllojshme (veçanërisht ato që nuk janë të përqendruar në një vend, gjeografikisht të shpërndarë apo që evoluojnë gjatë një periudhe të gjatë kohore).

Roli i strukturave regjionale koordinuese ndryshon varësisht nga situata. Shumë incidente mund të koordinohen nga strukturat regjionale kryesisht me shfrytëzimin e mjeteve regjionale. Ndërsa, incidentet e mëdha dhe më komplekse mund të kërkojnë koordinim të drejtpërdrejtë midis QBF dhe nivelit qendror me strukturat regjionale të përfshira në rolin mbështetës. Ndryshimet e strukturës themelore janë paraqitur në formë skeme në figurën në vijim:

Figura 3. Korniza e SIME-së

Struktura për Koordinimin e PRK-së është e bazuar në strukturën e SIME-së: SKI/Komanda e Bashkuar në vendngjarje e mbështetur nga Komanda Regjionale (nëse nevoitet), qendrat e koordinimit ndërinstitucional dhe entitetet e koordinimit ndërinstitucional.

Entiteti i Koordinimit Ndërinstitucional


- Koordinimi strategjik
- Caktimi i prioriteteve midis incidenteve dhe ndarja e resurseve përkatëse
- Pikë qendrore për zgjidhjen e çështjeve

QOE-të/Qendrat e Koordinimit Ndërinstitucional

- Mbështetje dhe koordinim
- Identifikimi i mungësave në resurse dhe i problemeve
- Grumbullimi dhe sigurimi i informacioneve
- Zbatimi i vendimeve të entitetit ndërinstitucional

Komanda e Incidentit

- Drejtimi i menaxhimit të incidentit në vendngjarje



Elementet themelore organizative të PRK-së

Ky seksion shtjellon elementet kryesore organizative në strukturë për koordinimin qendror të PRK-së, të skicuar në figurën X. Të përfshira në shtjellim janë ekipet speciale dhe komponentet tjera shoqëruese duke përfshirë edhe entitetet e nivelit të qeverisë.

Këshilli i Sigurisë së Kosovës

Sipas Ligjit për Themelimin e Këshillit të Sigurisë së Kosovës, Këshilli i Sigurisë së Kosovës është përgjegjës për koordinimin e politikave dhe strategjive ndër-institucionale lidhur me menaxhimin e incidenteve vendore dhe ndërkombëtare, përkatësisht, siç urdhërohet nga Presidenti i Republikës së Kosovës. Në vijim të një vlerësimi fillestar të Ministrit të Punëve të Brendshme, çështjet e politikave ndër-institucionale dhe kurset e veprimit të përshtatura nga GNMI, posaqërisht ato të natyrës senzitive kohore, ato që kërkojnë shpallje të politikave apo ato jashtë autoritetit të ministrit, siç është përcaktuar në ligjin e sipër përmendur, ligjin për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera dhe aktet tjera përkatëse, udhëzimet administrative dhe rregulloret dërgohen për zgjidhje tek mekanizmat e KSK-së.

Sekretariati i Këshillit të Sigurisë së Kosovës siguron që përpjekjet për menaxhimin e incidenteve vendore dhe ndërkombëtare bashkërendohen pa vështirësi.

Komitetet për Koordinimin e Politikave (KKP)

KKP-të koordinojnë çështjet e politikave si pjesë e procesit të Qeverisë. KKP-të mund të thirren me kërkesën e çdo agjencie anëtare e komitetit mbi baza emergjente të bazuar në kërcënim, një Incidenti të Karakterit Kombëtar apo ndonjë çështjeje politike të natyrës urgjente.

Grupi Ndër-institucional për Menaxhimin e Incidenteve (GNMI)

GNMI është entitet koordinues shumë-institucional i nivelit të zyrës qendrore i cili ndihmon menaxhimin strategjik të incidenteve vendore për Incidentet e Karakterit Kombëtar. Ministri i Punëve të Brendshme aktivizon GNMI-në bazuar në natyrën, ashpërsinë dhe kompleksitetin e kërcënimit apo incidentit. Ministri i Punëve të Brendshme mund ta aktivizoj GNMI-në për ngjarje me profil të lartë, të shkallës së gjerë që paraqesin caqe të probabilitetit të lartë dhe në situatat e kërcënimeve të larta. GNMI është i përbërë nga përfaqësuesit e lartë të segmenteve të MPB-së, ministritë dhe agjencitë tjera qeveritare dhe OJQ-të, sipas nevojës.

Anëtarësia e GNMI-së është fleksibile dhe mund të ngritet me rast apo të organizohet për detyrë të caktuar për të siguruar ekspertizë të fushave specifike, të nevojshme për kërcënimin specifik apo incidentin e dhënë. Kur aktivizohet GNMI:

- Shërben si pikë qendrore për planifikim dhe koordinim strategjik qendror të menaxhimit të incidenteve;
- Përcjell gjendjen e vlerësimeve të kërcënimeve si dhe operacioneve dhe aktiviteteve në zhvillim të lidhura me incidentin;
- Siguron mbështetje vendimmarrëse për përpjekjet e parandalimit, gatishmërisë, reagimit dhe rimëkëmbjes nga kërcënimi apo incidenti;
- Sintetizon informacionet, përmbyllë çështjet dhe bënë rekomandime për Ministrin e Punëve të Brendshme, rreth:

- ndërmarrjes së veprimeve në reagim ndaj kërcënimeve të besueshme,

- ndryshimeve në nivelin e alarmit,
 - çështjeve të politikave të veprimit,
 - kurseve operative të veprimit, dhe
 - prioriteteve të shfrytëzimit apo shpërndarjes së resurseve qendrore;
- Siguron koordinim dhe rekomandim strategjik për angazhimin e resurseve qendrore në bashkëpunim me menaxhmentin e resurseve ekzistuese institucionale, ndërinstitucionale dhe entiteteve të sektorit privat;
 - Vlerëson efektet kombëtare të incidentit(eve) sikurse edhe ato të lidhura me reagimin aktual apo të propozuar qendror;
 - Parashikon kërkesat e shtuara për resurse dhe operacione qendrore në vartësi me specifikat e situatës;
 - Mban koordinim të vazhdueshëm me IDM dhe Grupin Koordinues të QBF-së;
 - Ndihmon koordinimin operativ ndërinstitucional dhe koordinon me entitetet tjera publike dhe private të nevojshme për zbatimin e vendimeve dhe udhëzimeve nga Kryeministri/Presidenti apo entitetet tjera përkatëse të Qeverisë, dhe
 - Harton strategjitë për zbatimin e politikave ekzistuese dhe siguron informacione rreth incidentit për MPB-në dhe Qeverinë për ta ndihmuar bërjen e politikave. **Qeveria e Republikës së Kosovës fillon çdo politikë të re përkatëse për incidentin madhor dhe zgjidh polemikat rreth politikave ndërinstitucionale.**

Drejtuesi, zëvendësi, ose i caktuari i GNMI-së

GNMI koordinon dhe siguron informacione për qeverinë duke përfshirë: të qenit të informuar për situatën dhe aktivitetet operative për parandalim, mbrojtje, gatishmëri, reagim dhe rimëkëmbje, sikurse edhe për rekomandimet për kursin e veprimeve.

Struktura e GNMI-së

Siç tregohet më poshtë, GNMI përbëhet nga një staf ekzekutiv, grupi themelor dhe ekspertët e fushave specifike.

Stafi ekzekutiv i GNMI-së

Stafi ekzekutiv përfshinë drejtuesin, zëvendësin, zëvendësin për operacione, analistin e informacioneve, menaxherin e kërkesave për informacione, shënim-mbajtësin, raportuesin e situatës, përcjellësin e resurseve dhe asistentin administrativ. Ministri i Punëve të Brendshme do të caktoj një përfaqësues të lartë të ministrisë që të shërbej si drejtues i GNMI-së.

Grupi themelor i GNMI-së

Grupi themelor i GNMI-së përfshinë përfaqësuesit nga ministritë dhe agjencitë qeveritare, segmentet e MPB-së dhe organizatat tjera sipas nevojës. Komunitet e goditura mund të përfaqësojnë në GNMI qoftë nëpërmjet ministrisë përgjegjëse për pushtet lokal ose, nëse është e nevojshme, nëpërmjet përfaqësuesit të komunës në GNMI. Në kohën e aktivizimit të GNMI-së, anëtarësia dhe pjesëmarrja aktuale e GNMI-së është e detyruar të përfshijë ministritë dhe agjencitë me autoritet përkatës ligjor dhe me ekspertizë të nevojshme për incidentin e dhënë, përfshirë skenarët në vijim: ngjarjet kimike, biologjike, radiologjike apo nukleare, ngjarjet terroriste pa përdorimin e ASHM-ve, rrjedhjet e vajrave dhe materieve të rrezikshme, fatkeqësitë natyrore, ngjarjet e migrimeve në masë dhe emergjencat tjera sipas nevojës.

Organika e grupit themelor të GNMI-së

Zyrtarët të cilët e plotësojnë grupin themelor të GNMI-së, burojnë nga të gjitha institucionet dhe entitetet sipas përkatësisë.

Ekspertët e fushave specifike

Në plotësim të stafit ekzekutiv dhe grupit themelor, GNMI integron ekspertët e fushave specifike për tu përballë me kërkesat e incidentit të caktuar. Për disa reagime, grupet e paracaktuara të ekspertëve janë pjesë e përpjekjeve të planifikimit të FME-ve, mbështetjes, apo anekseve specifike për incidente dhe sigurojnë këshilla të nevojshme teknike (Aneksi A: Mbështetja Shkencore dhe Teknologjike.)

Procedurat e GNMI-së

Procedurat që drejtojnë përcaktimin, aktivizimin, kthimin, mbledhjen dhe ndërveprimin operativ të anëtarëve të GNMI-së do të zhvillohen në marrëveshje me ministritë dhe agjencitë tjera qeveritare dhe do të publikohen nga Ministria e Punëve të Brendshme në dokument të veçantë.

QO e MPB-së është nyja kryesore qendrore për menaxhimin e incidenteve vendore, koordinimin operativ dhe pasqyrën reale të situatës. QO e MPB-së është mekanizëm ndërinstitucional me pozicion 24/7, që shkrin raportet e strukturave të zbatimit të ligjit, reagimit emergjent dhe sektorit privat. QO e MPB-së ndihmon shkëmbimin e informacioneve dhe koordinimin operativ të sigurisë së vendit me QO tjera qendrore, regjionale, lokale dhe jo qeveritare.

Rolet dhe përgjegjësitë e QO të MPB-së përfshijnë:

- Vendosijen dhe mirëmbajtjen e lidhjeve në kohë-reale të komunikimit me QO tjera qendrore në nivelin kombëtar, sikurse edhe me QO përkatëse regjionale, lokale, jo qeveritare dhe me elementet përkatëse të sektorit privat;
- Mirëmbajtjen e komunikimit me entitetet e infrastrukturës kritike dhe shkëmbimin e informacioneve për resurset kryesore të sektorit privat;
- Mirëmbajtjen e komunikimit me zyrtarët qendror të menaxhimit të incidenteve;
- Koordinimin e resurseve përkatëse për menaxhimin e incidenteve vendore dhe parandalimin e akteve terroriste;
- Sigurimin e pasqyrës reale të situatës vendore, pasqyrën e përbashkët operative dhe mbështetjen e GNMI-së;
- Veprimin si kanal parësor i Qendrës së Situatave të Zyrës së Kryeministrit dhe GNMI-së për pasqyrën reale të situatës në vend.

QO e MPB-së përbëhet nga qendra e monitorimit dhe koordinimit operativ 24/7 e shumë-agjencive dhe elementet e integruara të segmentit të analizës së informacioneve dhe mbrojtjes së infrastrukturës kritike si dhe segmentit të gatishmërisë dhe reagimit emergjent. Këto elemente punojnë në koordinim të ngushtë për të adresuar analizimin e informacioneve dhe koordinimin e aktiviteteve të reagimit.

Qendra operative e MPB-së

QO e MPB-së integron përfaqësuesit nga MPB-ja, ministritë dhe agjencitë tjera qeveritare për t'i mbështetur nevojat e monitorimit të kërcënimeve të vazhdueshme dhe njohjen e gjendjes reale sikurse edhe koordinimin operativ të menaxhimit të incidenteve. Struktura organizative e QO-së e

MPB-së, është e destinuar për integrimin e tërë spektrit të ekspertizës dhe kapacitetit të gatshëm për tu ndesh me kërkesat e gamës së gjerë të skenarëve të mundshme.

Koordinimi i reagimit dhe resurseve

Qendra Operative e Agjencionit të Menaxhimit Emergjent (QOAME), është qendër shumë institucionale e cila siguron koordinim të përgjithshëm të reagimit qendror, për Incidentet me Karakter Kombëtar dhe zbatim të programit të menaxhimit emergjent. MPB/AME mban QOAME, si komponent funksionale të QO të MPB-së në mbështetje të operacioneve të menaxhimit të incidenteve.

QOAME monitoron incidentet e mundshme apo në zhvillim të karakterit kombëtar dhe mbështet përpjekjet e komponentëve regjionale dhe fushore. Funkzioni i QOAME-së në mbështetje të planifikimit dhe koordinimit të operacioneve të menaxhimit të incidenteve përfshinë:

- Monitorimin e gatishmërisë së nivelit kombëtar të ekipeve dhe resurseve të reagimit emergjent;
- Në koordinim me QOER bënë iniciimin e detyrave të caktuara për misione apo marrëveshje për kompensim për aktivizimin e ministrive dhe agjencive tjera qendrore;
- Aktivizimin dhe dislokimin e entiteteve të nivelit kombëtar siç janë Ekipet e Reagimit Emergjent (ERE);
- Koordinimi dhe mbështetja e reagimit qendror ndaj incidenteve aktuale apo të mundshme të Karakterit Kombëtar;
- Sigurimin e menaxhimit të objekteve, furnizimeve dhe pajisjeve fushore;
- Koordinimin reagimin operativ dhe planifikimin e ndarjes së resurseve me ministrinë dhe agjencitë përkatëse qeveritare, QOER-të dhe QBF-në;
- Përcjelljen dhe menaxhimin e ndarjes së resurseve qendrore;
- Grumbullimin, vlerësimin dhe shpërndarjen e informacioneve lidhur me reagimin ndaj incidentit dhe gjendjen e resurseve dhe
- Draftimin dhe shpërndarjen e paralajmërimeve dhe urdhrave operativ në koordinim me elementet tjerë të QO të MPB-së.

Për më tepër, QOAME zgjidh konfliktet e mbështetjes qendrore me resurse dhe çështjet tjera implementuese të dorëzuara nga QBF-ja. Ato çështje të cilat nuk mund të zgjidhen nga QOAME drejtohen tek GNMI.

Koordinimi regjional

Disa Incidente të Karakterit Kombëtar mund të menaxhohen kryesisht duke përdorur resurset regjionale nën monitorimin e nivelit qendror. Në situatat e përmasave të mëdha dhe të ndjeshme, QBF-ja koordinon drejtpërsëdrejti me QO-në e MPB-së dhe GNMI-në te nivelit qendror. Në këto situata elementet organizative regjionale mbesin në rol mbështetës.

QOER është shërbim i qëndrueshëm që operon pranë AME/MPB, e cila aktivizohet për të koordinuar përpjekjet regjionale, implementon prioritetet qendrore dhe zbaton programin qendror të mbështetjes lokale derisa të ngritet QBF në terren, apo derisa IDM të mund të marrë përsipër përgjegjësinë koordinuese të PRK-së. QOER mban komunikim me QOAME dhe QOE të lokalitetit të goditur, koordinon dislokimin e Elementit Avancues të Ekipit Regjional Emergjent në terren, vlerëson informacionet e dëmeve, harton raporte situatash dhe lëshon detyrat fillestare të misionit.

Koordinatori Regjional i AME-së aktivizon QOER bazuar në nivelin e nevojshëm të reagimit. QOER udhëhiqet nga një shef i QOER-së dhe përfshinë staf të AME/MPB-së dhe përfaqësuesit e FME-ve regjionale.

Qendra e Bashkuar Fushore

QBF është qendër koordinuese shumë-institucionale e themeluar në rrafshin lokal. Siguron vend qendror për koordinimin e mekanizmave qendror, regjional, lokal, jo qeveritar dhe të sektorit privat me përgjegjësi parësore për reagim ndaj kërcënimeve dhe për mbështetje të incidentit. QBF mundëson koordinim efektiv dhe efikas të veprimeve qendrore lidhur me parandalimin, reagimin dhe rimëkëmbjen nga incidenti.

QBF përdor strukturë fleksibile të SIME-së, në kontekst të aktiviteteve para dhe pas menaxhuese të incidentit. Organizimi i QBF-së përshtatet për gjerësinë dhe kompleksitetin e situatës së dhënë dhe inkorporon parimet e SIME-së lidhur me harkun e kontrollit dhe strukturën organizative: menaxhmentin, operativën, planifikimin, logjistikën dhe financat/administratën. Edhe pse QBF përdor strukturën e SKI, ajo nuk menaxhon operacionet në vendngjarje. Përkundrazi përqendrohet në sigurimin e mbështetjes për përpjekjet në vendngjarje dhe zhvillimin e operacioneve të gjëra të mbështetjes që mund të zgjerohen përtej vendit të incidentit.

Sipas SIME-së, QBF gjithashtu mund të inkorporon elementin e gjashtë të përqendruar në inteligjencë dhe informim. Elementi mund të përfshihet si pozitë në stafin koordinues, si njësi në Sektorin e Planifikimit, si degë në Sektorin Operativ apo si Sektor i veçantë i stafit të përgjithshëm. Vendosja e funksionit të inteligjencës përcaktohet nga Grupi Koordinues i QBF-së, bazuar në rolin që luan inteligjenca në incident dhe/ apo volumi i informacioneve të klasifikuara apo me ndjeshmëri të lartë. Personeli nga ministritë dhe agjencitë qeveritare, entitetet tjera ligjore dhe sektori privat, si dhe organizatat jo qeveritare sigurojnë staf për QBF-në, kryesisht nëpërmjet FME-ve përkatëse të tyre.

Në ngjarjet kur renditja krahas krahas nuk është praktike, agjencitë qeveritare lidhen virtualisht me QBF-në dhe caktojnë ndërlidhësa në QBF për ta lehtësuar koordinimin e menaxhimit qendror të incidentit dhe përpjekjeve për asistencë. Organet shtetërore, lokale, regjionale, të sektorit privat dhe atij jo qeveritare inkurajohen për caktimin e ndërlidhësve në QBF për ta lehtësuar bashkëveprimin, komunikimin dhe koordinimin.

Figura 4. Shembull i organizimit të QBF-së gjatë fatkeqësive natyrore


Grupi Koordinues



Stafi Koordinues



Sektorët



Komponentet e organizimit të QBF-së

Grupi Koordinues

Duke e përdorur parimin e SIME-së “Komanda e Bashkuar”, aktivitetet e QBF-së drejtohen nga Grupi Koordinues i QBF-së, i cili mund të përfshijë IDM, ZKQ/KRQ apo ZLQ tjerë me përgjegjësi kryesore ligjore apo autoritet funksional për incidentin.

Stafi Koordinues

Stafi Koordinues i QBF-së gjithashtu përfshinë numrin e kufizuar të përfaqësuesve të zyrtarëve lokal dhe regional, sikurse edhe përfaqësuesit e QJQ-ve dhe sektorit privat. Stafi Koordinues i QBF-së funksionon si entitet koordinues shumë-institucional dhe punon bashkërisht për të vendosur prioritetet (për incidentet e veçanta dhe të shumëllojshme) dhe shpërndarjen e resurseve përkatëse, zgjidhjen e çështjeve të politikave të agjencive dhe siguron udhëzime strategjike për t'i mbështetur aktivitetet e menaxhimit qendror të incidenteve. Kryesisht, IDM në konsultim me ZKQ dhe zyrtarët tjerë qeveritar përcakton kompozicionin e Grupit Koordinues të QBF-së. Kompozicioni i saktë i QBF-së varet nga natyra dhe madhësia e incidentit dhe kryesisht përfshinë personelin e përvijuar në nën-seksionet në vijim.

Grupi Koordinues i QBF-së siguron udhëzime strategjike dhe zgjidhje të çfarëdo konflikti rreth prioriteteve në ndarjen e resurseve kritike qendrore. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja për çështjet e politikave midis anëtarëve të Grupit Koordinues të QBF-së, çështja mund të ngritet tek GNMI apo nëpërmjet zinxhirit komandues përkatës të agjencisë për shqyrtim nga autoritetet më të larta. Çështjet e pa zgjidhura të resurseve përcillen tek QOAME-së pastaj tek GNMI, nëse kërkohet diskutim i mëtutjeshëm.

I Deleguari i Ministrit

IDM emërohet personalisht nga Ministri i Punëve të Brendshme (në cilësinë e Koordinatorit Qeveritar), për ta lehtësuar mbështetjen qendrore për strukturën e Komandës së Bashkuar të SKI-së të ngritur, dhe për të koordinuar aktivitetet qendrore të menaxhimit dhe ndihmës së incidentit, përgjatë spektrit të parandalimit, gatishmërisë, reagimit dhe rimëkëmbjes. IDM siguron që përpjekjet për menaxhimin e incidentit ngritën në maksimum nëpërmjet një koordinimi efektiv dhe efikas. IDM siguron pikën kryesore të kontaktit dhe të informimit për situatën në rrafshin lokal për Ministrin e Punëve të Brendshme. Ministri nuk kufizohet tek zyrtarët e MPB-së kur përzgjedh IDM.

IDM nuk e drejton apo ndërron strukturën e komandës së incidentit të ngritur në incident dhe as nuk ka autoritet drejtues mbi ZKQ-në apo zyrtarët tjerë qeveritar. Zyrtarët tjerë qendror të menaxhimit të incidentit mbajnë autoritetin e tyre sipas përcaktimit në ligje dhe rregullore.

Përgjegjësitë e IDM-së

Roli dhe përgjegjësitë specifike të IDM përfshijnë me sa vijon:

- Përfaqësimin e Ministrit të Punëve të Brendshme si zyrtar prijës i nivelit qendror;
- Sigurimin e koordinimit të të gjitha aktiviteteve qendrore të menaxhimit të incidenteve dhe ndarjes së resurseve;
- Sigurimin e integritetit të lehtë të aktiviteteve qendrore në mbështetje dhe në koordinim me kërkesat lokale;

- Sigurimin e udhëzimeve strategjike për entitetet qendrore;
- Lehtësimin e zgjidhjes së konflikteve ndërinstitucionale sipas nevojës;
- Të shërbyerit si pikë kryesore e kontaktit (jo ekskluzive) për ndërmjetësim qendror me zyrtarët e lartë të zgjedhur/emëruar lokal, mediat dhe sektorin privat;
- Sigurimin e informacioneve të kohës reale për Ministrin e Punëve të Brendshme nëpërmjet QOMPB-së dhe GNMI-së, sipas nevojës;
- Koordinimin e nevojave për resurse reaguese ndërmjet incidenteve të shumëfishta sipas nevojës, apo siç urdhërohet nga Ministri i Punëve të Brendshme;
- Koordinimin e plotë të strategjisë qendrore të rrafshit lokal për të siguruar përputhje të komunikimeve ndërinstitucionale me publikun dhe
- Sigurimin e lidhshmërisë adekuate midis QBF-së dhe QOMPB-së, QOE-ve lokale dhe regjionale, QOE-ve jo qeveritare dhe elementeve përkatëse të sektorit privat.

Zyrtari Koordinues Qeveritar

Zyrtari Koordinues Qeveritar (ZKQ), menaxhon dhe koordinon aktivitetet e mbështetjes qendrore me resurse për fatkeqësi dhe emergjenca. ZKQ ndihmon Komandën e Bashkuar dhe/apo Komandën Regjionale. ZKQ punon ngushtë me IDM-në dhe ZLQ-të tjerë.

Përgjegjësitë e ZKQ-së

Roli dhe përgjegjësitë e ZKQ-së përfshijnë me sa vijon:

- Zhvillimin e një vlerësimi fillestar të llojit të asistencës së nevojshme më urgjente;
- Koordinimin e dërgesave me kohë të asistencës qendrore tek autoritetet e goditura regjionale, lokale dhe tek viktimat e fatkeqësisë;
- Mbështetjen e IDM, kur është i caktuar;
- Punon në partneritet me ZKK (të caktuar nga Kryetari i Komunës për mbikëqyrjen e operacioneve për komunën).

Koordinatori i Resurseve Qendrore

Në situatat kur ministria apo agjencia qeveritare vepron nën autoritetin vetjak, ka kërkuar asistencë të Ministrisë të Punëve të Brendshme për të fituar mbështetje nga ministrinë dhe agjencitë tjera qendrore, MPB-ja cakton një KRQ. Në këto situata KRQ koordinon mbështetjen nëpërmjet marrëveshjeve ndërinstitucionale dhe MEM.

KRQ është përgjegjës për koordinimin e dërgimit me kohë të resurseve tek agjencia kërkuuese.

Zyrtari(ët) Lokal dhe Regjional

Grupi Koordinues i QBF-së gjithashtu përfshinë përfaqësuesit e komunave siç është ZKK, i cili shërben si homolog i ZKQ-së dhe menaxhon programet dhe aktivitetet e komunës për menaxhimin e incidenteve. Grupi Koordinues i QBF-së mundet gjithashtu të përfshijë përfaqësuesit regjional dhe lokal me autoritet parësor statusor për menaxhimin e incidentit.


Zyrtarët e Lartë Qeveritar

Grupi Koordinues i QBF-së gjithashtu mund të përfshijnë zyrtar që përfaqësojnë ministri dhe agjenci tjera me autoritet parësor ligjor për aspektet e caktuara të menaxhimit emergjent. ZLQ-të përdorin autoritetet, përvojën dhe mundësitë ekzistuese për të ndihmuar në menaxhim të

incidentit duke punuar në koordinim me IDM, ZKQ dhe anëtarët tjerë të Grupit Koordinues të QBF-së.

Stafi Koordinues i QBF-së

Në pajtim me parimet e SIME-së, struktura e QBF-së normalisht përfshinë edhe Stafin Koordinues. Grupi Koordinues i QBF-së, gjerësinë e stafit e përcakton në raport me llojin dhe madhësinë e incidentit.



Shefi i Stafit dhe Stafi Mbështetës

Stafi Koordinues i QBF-së mund të përfshij Shefin e Stafit dhe përfaqësues që ofrojnë asistencë të specializuar e cila mund të përfshij mbështetjen në fushat në vijim: sigurinë, këshillat juridike, të drejtat e barabarta, ndërlidhjen për infrastrukturë dhe ndërlidhës tjerë.

- **Koordinatori i Sigurisë** ka rolet në vijim:
 - a. Të siguroj që Shefi i Stafit dhe ZKQ marrin informacione të koordinuara, konsekuente, të sakta dhe aktuale rreth sigurisë, shëndetit dhe asistencës teknike;
 - b. Të mbështes Zyrtarin(ët) e Sigurisë në PKI (të) duke koordinuar sigurinë dhe shëndetin e punëtorëve dhe ofrimin e asistencës teknike sipas nevojës dhe
 - c. Të ruaj sigurinë e personelit në QBF.
- **Zyrtari për Çështje Ligjore** shërben si këshilltar parësor ligjor për Grupin Koordinues të QBF-së dhe gjithashtu mund të punoj me secilin shef sektori për t'i mbështetur çështjet pragmatike, logjistike dhe personelit sipas nevojës.
- **Zyrtari për të Drejtat e Barabarta** shërben për të përkrah punën pa diskriminim dhe qasjen e barabartë në programet dhe përfitimet nga rimëkëmbja.
- **Zyrtari për Siguri** është përgjegjës për ruajtjen e personelit të QBF-së dhe sigurinë e ambienteve të QBF-së.

- **Ndërlidhësit** shërbejnë si pikë kontakti për aktivitetet ndihmëse dhe koordinuese me agjencitë dhe grupet e ndryshme dhe caktohen sipas nevojës.
- **Ndërlidhësi për Infrastrukturë**, shërben si këshilltar kryesor për grupin Koordinues të QBF-së lidhur me të gjitha incidentet e nivelit kombëtar dhe regjional që kanë të bëjnë me IK/RK. Ndërlidhësi për Infrastrukturë:
 - Vepron si ndërlidhës për IK/RK midis nivelit kombëtar dhe regjional, sektorit privat dhe aktiviteteve të QBF-së;
 - Koordinon çështjet e IK/RK-së dhe FME-ve midis Grupit Koordinues të QBF-së dhe përfaqësuesve të IK/RK-së të vendosur në GNMI dhe QOMP;B;
 - Siguron pasqyrë reale të situatës lidhur me infrastrukturën e goditur dhe siguron përditësime periodike për Grupin Koordinues të QBF-së dhe
 - Komunikon informacionet tek përfaqësuesit e IK/RK në GNMI, dhe QOMP.

Zyrtari për Marrëdhënie me Jashtë Incidentit (ZMJI)

Zyrtari i Marrëdhënieve me Jashtë Incidentit ofron mbështetje për udhëheqjen e QBF në të gjitha funksionet që përfshijnë komunikimet me audiencat jashtë incidentit. Marrëdhëniet me Jashtë përfshijnë Marrëdhëniet me Publikun, Marrëdhëniet me Komunitet, Marrëdhëniet me Parlamentin, Koordinimin Lokal, Marrëdhëniet me Regjione dhe Marrëdhëniet Ndërkombëtare, kur është e nevojshme. Resurset për funksionet e ndryshme të Marrëdhënieve me Jashtë koordinohen përmes FME 15.

ZMJI gjithashtu është përgjegjës për mbikëqyrjen e operacioneve të Qendrës së Bashkuar Informative Qendrore (QBI) e themeluar për mbështetjen e QBF-ve. Në vijim është përshkrimi i QBI-së:

- QBI është lokacion fizik ku punojnë së bashku profesionistët e marrëdhënieve publike të organizatave të përfshira në aktivitetet e menaxhimit të incidentit, për të ofruar informacione kritike të emergjencës, komunikimet e krizave dhe mbështetjen e aktiviteteve të marrëdhënieve publike. QBI shërben si pikë qendrore për koordinimin dhe shpërndarjen e informacioneve për publikun dhe mediat lidhur me parandalimin, gatishmërinë, reagimin dhe rimëkëmbjen. QBI mund të ngritet në një vendngjarje në koordinim me agjencitë lokale varësisht nga kërkesat e incidentit. Në shumicën e rasteve QBI ngritet në, apo është e lidhur virtualisht me QBF-në dhe koordinohet nga Zyrtarët e Informimit Publik qendror dhe lokal. Në shumicën e Incidenteve të Karakterit Kombëtar udhëheqës qendror do të jetë Zyrtari i Informimit Publik i MPB-së i cili punon me personelin tjetër qendror, regjional, lokal, të OJQ-ve dhe të sektorit privat të fushës së marrëdhënieve publike. QBI e QBF-së punon në koordinim të ngushtë me QBI-të tjera për tu integruar në Sistemin e Përbashkët Informativ (SPI) duke siguruar informacione të qëndrueshme, të koordinuara dhe në kohë gjatë një incidenti.
- QBI zhvillon, koordinon dhe shpërndan publikimet e unifikuara për shtyp. Publikimet për shtyp redaktohen nëpërmjet Grupit Koordinues të QBF-së për të siguruar mesazhe të qëndrueshme, shmangien e publikimit të informacioneve konfliktuoze dhe parandalimin e efekteve negative në operacione. Ky proces aprovues formal për publikimet për shtyp siguron mbrojtje të informacioneve të ndjeshme të zbatimit të ligjit.
- IDM mbështetet nga Udhëheqësi i dedikuar për Marrëdhënie Publike i cili funksionon si Sekretar për Shtyp, koordinon aktivitetet e mediave, siguron udhëzime strategjike

komunikuese për QBI-në dhe shërben si zëdhënës i caktuar kur urdhërohet nga IDM dhe/apo Marrëdhëniet Publike të MPB-së.

- Elementet në vijim duhet të përfaqësohen në QBI:
 - a. Zyrtari për Informim Publik i AME-së dhe stafi;
 - b. Zyrtari për Informim Publik i PK-së dhe stafi; (kur aktivizohet në mbështetje të menaxhimit të incidentit terrorist)
 - c. Zyrtarët për Informim Publik të agjencive tjera sipas nevojës dhe
 - d. Zyrtarët për Informim Publik lokal dhe të OJQ-ve.

Zyrtari për Koordinimin e FSK-së

Nëse caktohet nga MFSK, ZKFS shërben si pikë e vetme kontakti e MFSK-së në QBF. Me disa përjashtime, kërkesat për mbështetje të FSK-së të krijuara në QBF koordinohen dhe procedohen nëpërmjet ZKFS-së. ZKFS mund të ketë Element Koordinues të FSK-së (EKFS) të përbërë nga stafi dhe zyrtari ndërlidhës i forcës së sigurisë me qëllim të lehtësimit të koordinimit dhe mbështetjes për FME-të e aktivizuara. Përgjegjësitë e veçanta të ZKFS-së (çështje e përshtatjes sipas situatës) përfshijnë përpunimin e kërkesave për mbështetje të forcës së sigurisë, përcjelljen e misioneve të ngarkuara tek struktura përkatëse e FSK-së nëpërmjet kanaleve të përcaktuara të MFSK-së dhe caktimi i ndërlidhësve për FME-të e aktivizuara, sipas nevojës.

Sektorët e QBF-së

QBF është e organizuar në katër sektor: Sektori Operativ, Sektori i Planifikimit, Sektori i Logjistikës dhe Sektori i Financave/Administratës.

Sektorët e QBF




Sektori Operativ

Sektori Operativ koordinon mbështetjen operative të përpjekjeve të menaxhimit të incidentit në vendngjarje. Mund t'i shtohen apo hiqen degë sipas nevojës, varësisht nga natyra e incidentit. Sektori Operativ gjithashtu është përgjegjës për koordinim me post komandat tjera qendrore të cilat mund të themelohen për t'i mbështet aktivitetet e menaxhimit të incidentit.

Për incidentet terroriste Sektori Operativ përfshinë Degën e Operacioneve Hetimore të Zbatimit të Ligjit dhe Degën e Reagimit dhe Rimëkëmbjes. Për NVSK, dega e tretë, Dega e Operacioneve të Sigurisë mund të shtohet për të koordinuar përpjekjet e mbrojtjes dhe sigurisë.

Degët e Sektorit Operativ



Në këto situata, Shefi i Sektorit Operativ përcaktohet me marrëveshje reciproke të Grupit Koordinues të QBF-së bazuar në agjencinë e përfshirë me juridiksion dhe autoritet statusor më të lartë për prioritetet aktuale të incidentit. Agjencia që e siguron Shefin e Sektorit Operativ mund të ndryshojë në raport me ndryshimin e prioriteteve të incidentit.

- **Dega e Operacioneve Hetimore të Zbatimit të Ligjit / Qendra e Bashkuar Operative(QBO):** ngritet për të bërë drejtimin dhe koordinimin e aktiviteteve hetimore të zbatimit të ligjit dhe atyre kriminale të lidhura me incidentin.

Përqëndrimi i QBO-së është në parandalimin e akteve kriminale, sikurse edhe grumbullimin e informacioneve inteligjente, hetimin dhe procedimin e akteve kriminale. Ky përqendrim përfshinë menaxhimin e çështjeve unike taktike të lidhura me situata krizash (si: situatat me pengje apo kërcënimet terroriste).

Kur kjo degë është e përfshirë si pjesë e QBO-së, ajo është përgjegjëse për koordinimin e funksionit të inteligjencës dhe informimit (sipas përshkrimit në SIME), që përfshinë sigurinë në aspektin operativ të informimit dhe grumbullimit, analizimit dhe shpërndarjes së të gjitha informacioneve inteligjente të lidhura për incidentin. Prandaj, Njësia e Inteligjencës brenda Degës së QBO-së shërben si qendër fuzive ndërinstitucionale për të gjitha informacionet inteligjente të lidhura për incidentin. Të gjitha informacionet inteligjente të grumbulluara në vendngjarje dhe nëpërmjet hetimeve tubohen në Njësinë e Inteligjencës. Për më tepër, informacionet inteligjente të grumbulluara nëpërmjet Komunitetit të Inteligjencës që mund të lidhen drejtpërsëdrejti me incidentin dërgohen në Njësinë e Inteligjencës. Njësia e Inteligjencës i grumbullon këto informacione inteligjente, i zbërthen sipas nevojës dhe i shpërndan tek anëtarët e QBO-së në mënyrë të duhur. (Aneksi Zbatimi i Ligjit dhe Inteligjenca për Incidentet Terroriste).

- **Dega e Operacioneve të Reagimit dhe Rimëkëmbjes:** Dega e Operacioneve të Reagimit dhe Rimëkëmbjes koordinon kërkesat dhe shpërndarjen e ndihmave dhe mbështetjes qendrore nga ekipet e ndryshme speciale. Kjo degë është e përbërë nga katër grupe: Shërbimet Emergjente, Shërbimet Humane, Mbështetja Infrastrukturore dhe Komunitetit të rimëkëmbjes dhe zbutjes së rrejtëve.
- **Dega e Operacioneve të Sigurisë:** Dega e Operacioneve të Sigurisë koordinon mbrojtjen dhe përpjekjet për siguri në vendngjarje.

Sektori i Planifikimit

Funksioni i Sektorit të Planifikimit përfshinë grumbullimin, vlerësimin, shpërndarjen dhe shfrytëzimin e informacioneve lidhur me kërcënimet apo incidentet dhe gjendjen e resurseve qendrore. Sektori i Planifikimit është përgjegjës për përgatitjen dhe dokumentimin e veprimeve mbështetëse qendrore dhe hartimin e planeve strategjike, kontingjente, afatgjate dhe plane tjera lidhur me kërcënimet dhe incidentet sipas nevojës. Sektori i planifikimit siguron për Grupin Koordinues të QBF-së informacione aktuale për të siguruar njohje të situatës, përcaktimin e efekteve anësore, identifikimin e implikimeve kombëtare dhe përcaktimin e zonave specifike të interesit që kërkojnë vëmendje afatgjate. Sektori i Planifikimit është i përbërë nga njësitë në vijim: situatave, resurseve, dokumentimit, specialistëve teknik dhe demobilizimit. Sektori i Planifikimit gjithashtu mund të përfshijë edhe një Njësi për Informim dhe Inteligjencë (nëse nuk është caktuar diku tjetër) dhe një përfaqësues të QOMPB-së i cili ndihmon në hartimin e raporteve për QOMPB-në dhe GNMI-në.

Sektori i Logjistikës

Ky sektor koordinon mbështetjen logjistike e cila përfshinë kontrollin dhe llogaridhënien për rezervat dhe pajisjet qendrore; porositjen e resurseve, ndarjen e pajisjeve, furnizimeve dhe shërbimeve për QBF-në dhe lokacionet tjera fushore; lokacionet hapësimore, vendosjen, menaxhimin e hapësirës, shërbimin e ndërtimeve dhe operacionet e përgjithshme të shërbimeve publike; koordinimin e transportit dhe menaxhimin e parqeve të automjeteve; shërbimet e sistemeve të informimit dhe teknologjisë siç janë menaxhimi i postës dhe shumëfishimit dhe ndihma doganore. Sektori i logjistikës mund të përfshijë koordinimin dhe planifikimin, menaxhimin e resurseve, furnizimin dhe degët e shërbimeve të informimit.

Sektori i Financave / Administratës

Sektori i Financave/ Administratës është përgjegjës për menaxhimin financiar, monitorimin dhe përcjelljen e shpenzimeve qendrore lidhur me incidentin dhe funksionimin e QBF-së. Pozita e Shefit të Financave / Administratës do të mbahet nga një zyrtar i lartë qendror i cili shërben si Këshilltar i Lartë Financiar për udhëheqësin e ekipit (QBF) dhe përfaqëson zyrtarët kryesor financiar të agjencive koordinuese.

Aneksi mbështetës për menaxhimin financiar siguron udhëzime për tu siguruar që fondet të sigurohen shpejtë dhe se operacionet financiare zhvillohen në përputhje me ligjet, rregulloret dhe standardet në fuqi.

Shërbimet tjera të incidentit

QOE rajonale dhe lokale përfaqësojnë lokacionin fizik ku normalisht zhvillohet koordinimi i informacioneve dhe resurseve në mbështetje të aktiviteteve të menaxhimit të incidenteve. QOE zakonisht organizohen nga disiplinat kryesore funksionale (si: zjarrfikja, zbatimi i ligjit, shërbimet mjekësore, etj); nga autoriteti (si: shteti, regjioni, lokaliteti e kështu me radhë); apo nga kombinimi i të dyjave.

QOE regjionale dhe lokale ndihmojnë zbatimin e marrëveshjeve ndër regjionale dhe ndër komunale për ndihmë reciproke për mbështetjen e operacioneve në vendngjarje. Gjatë incidenteve të rëndësisë kombëtare, QBF punon në koordinim me QOE regjionale dhe lokale për t'i mbështetur përpjekjet e menaxhimit të incidenteve.

Post Komanda e Incidentit

Niveli taktik i organizimit në vendngjarje për komandim dhe menaxhim të incidentit është i vendosur në PKI. Normalisht është i përbërë prej zyrtarëve të caktuar për menaxhim të incidentit dhe reaguesit e agjencive qendrore, degëve regjionale dhe shërbimeve lokale si dhe nga sektori privat dhe organizatat joqeveritare. Kur janë të përfshirë shumë autoritete komanduese PKI mund të udhëhiqet nga Komanda e Bashkuar, e përbërë prej zyrtarëve që kanë autoritet legal apo përgjegjësi funksionale për incidentin. Komanda e Bashkuar siguron drejtpërsëdrejti në vendngjarje kontroll të operacioneve taktike dhe ndihmon SKI-në e SIME-së, ku përfshihen Sektorët e Operativës, Planifikimit, Logjistikës dhe Financave / Administratës.

PKI zakonisht vendoset në apo në afërsi të vendit të incidentit. Vendi përzgjidhet nga agjencioni i cili ka autoritetin parësor legal për menaxhimin e incidentit në këtë nivel. Në përgjithësi, për çdo incident ngritet nga një PKI. Varësisht nga numri dhe vendet e incidentit, ekzistojnë edhe PKI të menaxhuara nga një komandë regjionale.

Komanda Regjionale / Komanda e Bashkuar Regjionale

Komanda regjionale ngritet për mbikëqyrjen e menaxhimit të incidenteve të shumëfishta të cilat menaxhohen nga strukturat e ndara të SKI-së apo për ta mbikëqyrë menaxhimin e incidenteve shumë të mëdha apo shumë komplekse që kanë të përfshirë ekipe të shumëllojshme të menaxhimit të incidentit. Komanda regjionale ka përgjegjësi për vendosjen e strategjisë dhe prioritetëve të përgjithshme, alokimin e resurseve kritike në përputhje me prioritetet, të siguroj që incidentet të menaxhohen si duhet, të siguroj që të përmbushen objektivat dhe të siguroj që të ndiqet strategjia. Komanda regjionale bëhet komandë e bashkuar regjionale kur incidentet janë shumë juridiksionale.

Qendra për Rimëkëmbje nga Fatkeqësitë (QRF)

Kur ngritet në koordinim me degët regjionale dhe autoritetet lokale, QRF është komponent satelite e QBF-së dhe siguron hapësirë qendrore ku personat e goditur nga fatkeqësia mund të pajisen me informacione lidhur me programet e ndihmave për rimëkëmbje nga fatkeqësitë nga organizatat e ndryshme qendrore, regjionale, lokale, sektorit privat dhe organizatave vullnetare.

Mjedis i Përkohshëm Operativ (MPO)

MPO është mjedis i përkohshëm fushor i përdorur nga AME në fazat e para të një incidenti kur ekipi nuk mund të operoj në QOER për shkak të kufizimeve hapësinore apo arsyeve tjera dhe kur QBF nuk është ngritur ende. Një MPO në përgjithësi vendoset në apo afër QOER-së apo afër vendit të incidentit. MPO mbetet aktiv derisa të themelohet QBF. Në funksionet që përmbushen në MPO, përfshihen ndërveprimi me përfaqësuesit regjional dhe agjencitë kryesore të FME-ve, grumbullimi dhe vlerësimi i informacioneve dhe inicimi i programeve të ndihmave.

Ekipi për Reagim Emergjent

ERE është grup kryesor ndër-sektorial i cili e plotëson QBF me personel. ERE është i përbërë nga stafi i AME/MPB dhe personeli i FME-ve. ERE përfshinë një element avancues të quajtur ERE-A i cili kryen vlerësime dhe inicion koordinimin me nivelin lokal dhe dislokimin fillestar të resurseve qendrore. Secili regjion i AME-së mban një ERE të gatshëm për dislokim në reagim ndaj kërcënimeve apo incidenteve aktuale.

ERE siguron personelin për QBF-në dhe siguron që rezervat qendrore të janë në dispozicion për përmbushjen e kërkesave të menaxhmentit qendror dhe ato të nivelit lokal të identifikuar nga ZKK. Madhësia dhe përbërja e ERE-së është e ndryshueshme varësisht nga shtrirja dhe madhësia e ngjarjes.

Zakonisht, struktura organizative e ERE-së ngërthen Grupin Koordinues të QBF-së, Stafin Koordinues të QBF-së dhe katër sektorët e QBF-së (Operativën, Planifikimin, Logjistikën, Financat/Administratën).

ERE-A dislokohet gjatë fazave të hershme të një incidenti. Udhëhiqet nga një udhëheqës ekipi nga AME-ja dhe është i përbërë nga stafi programor dhe mbështetës dhe përfaqësuesit e agjencive të FME-ve të zgjedhura. Një pjesë e ERE-A dislokohet në QOER apo në mjedise tjera për të punuar drejtpërsëdrejti me komunat për të marr informacione lidhur me efektin e ngjarjes dhe për t'i identifikuar kërkesat specifike të komunave për ndihmën qendrore në menaxhimin e incidentit.

ERE-A konsultohet dhe koordinon me entitetet qendrore, regjionale dhe lokale për të përcaktuar vendin e QBF-së dhe qendrës për mobilizim. ERE-A zhvillon analizën fillestare të njohjes së situatës duke përfshirë ndryshimet në topografi të shkaktuara nga incidenti, efektet në mjedisin fizik dhe social dhe dokumentimin e humbjeve të shmangura nga masat paraprake të parandalimit për të shërbyer si bazament për strategjitë mbështetëse të shtetit.

Reagimi Pro-aktiv Qendror ndaj Ngjarjeve Katastrofike

PRK vendos politikat, procedurat dhe mekanizmat për reagimin pro-aktiv qendror ndaj ngjarjeve katastrofike. Ngjarja katastrofike është çdo incident natyror dhe i shkaktuar nga faktori njeri, përfshirë terrorizmin që rezulton me lëndime, dëme apo çrregullime të niveleve jashtëzakonisht të mëdha që ndikojnë keq në popullatë, infrastrukturë, mjedis, ekonomi, moralin kombëtar dhe/apo funksionet qeveritare. Ngjarja katastrofike mund të rezultojë në efekte të periudhës së gjatë kohore; shpeshherë tejkalon menjëherë resurset e zakonshme në dispozicion të autoriteteve regjionale, lokale dhe të sektorit privat në zonën e goditur dhe çrregullon dukshëm funksionet qeveritare dhe shërbimet emergjente deri në masën që siguria kombëtare mund të kërcënohet. Të gjitha ngjarjet katastrofike janë Incidente të Karakterit Kombëtar.

Implementimi i Protokolleve Pro-aktive Qendrore

Protokollet për reagimin pro-aktiv qeveritar më së shumti do të implementohen për rastet katastrofike të cilat përfshijnë armë kimike, biologjike, radiologjike, nukleare dhe të shkatërrimit në masë apo termetet e shkallës së lartë apo fatkeqësitë tjera natyrore dhe teknologjike në apo afër zonave të populluara.

Parimet Udhëzuese për Reagimin Pro-aktiv Qendror

Parimet udhëzuese për reagimin pro-aktiv qendror përfshijnë me sa vijon:

- Misioni parësor është shpëtimi i jetës; mbrojtja e infrastrukturës kritike, pronave dhe mjedisit, kontrolli i ngjarjes dhe ruajtja e sigurisë kombëtare.
- Procedurat standarde lidhur me kërkesat për asistencë mund të shpejtohen apo (nën rrethana të jashtëzakonshme), të suspendohen në prag të një ngjarje të shkallës katastrofike.
- Resurset reaguese qendrore të identifikuar do të dislokohen dhe fillojnë operacionet e domosdoshme sipas nevojës për të filluar aktivitetet për shpëtimin e jetës.

- Do të ndodh njoftimi dhe koordinimi i plotë me regjione dhe komuna, por procesi i koordinimit nuk guxon të vonoj apo ndaloj dislokimin e shpejtë dhe përdorimin e resurseve kritike. Regjionet janë të nxitura për të njoftuar dhe koordinuar me pushtetet lokale lidhur me reagimin mbrojtës qendror.
- Regjionet dhe pushteti lokal janë të inkurajuar të bëjnë plane të përbashkëta me qeverinë qendrore si pjesë e gatishmërisë “gjendje e rregullt” për incidentet katastrofike.

Mekanizmat Implementues për Reagimin Qendror Pro-aktiv ndaj Ngjarjeve Katastrofike

Shtojca e PRK-së për Incidentet Katastrofike adreson implikimet procedurale dhe të resurseve të ngjarjeve katastrofike për të siguruar ndarje të shpejtë dhe efikase të resurseve dhe mjeteve, përfshirë ekipet speciale, pajisjet dhe furnizimet të cilat sigurojnë kapacitete mbështetëse për shpëtimin e jetës dhe kontrollin e incidentit. Këto mjete mundën të jenë aq të specializuara apo përafërsisht të specializuara, sa në shumicën e lokaliteteve ose nuk janë në dispozicion ose nuk janë të mjaftueshme.

Procedurat e renditura në shtojcën e Incidenteve Katastrofike janë të bazuara në, me sa vijon:

- Para-përcaktimi i mjeteve dhe kapaciteteve qendrore;
- Vendndodhjen strategjike të mjeteve të para-përcaktuara për dislokim të shpejtë dhe
- Përdorimi i detyrave dhe përgjegjësisë të paracaktuara në Ligjin për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera, apo autorizimeve individuale të agjencive për përsheptimin e dislokimit me rastin e njoftimit nga MPB (në pajtueshmëri me procedurat e caktuara në shtojcën e PRK-së për Incidente Katastrofike) për ngjarjen e caktuar katastrofike.

Agjencionet përgjegjëse për këto mjete do ta mbajnë MPB-në të informuar, nëpërmjet QO të saj, lidhur me gjendjen e tyre të vazhdueshme dhe vendodhjen e tyre derisa të themelohet QBF-ja. Me të arritur në vendngjarje, asetet qendrore do të koordinojnë me Komandën e Bashkuar dhe QBF kur është e ngritur. Proceset e demobilizimit, përfshirë koordinimin e plotë me Grupin Koordinues të QBF-së, iniciohen qoftë kur përmbushet misioni apo kur përcaktohet që madhësia e ngjarjes nuk dikton shfrytëzimin e mëtutjeshëm të asetit përkatës.

V. VEPRIMET E MENAXHIMIT TË INCIDENTIT

Veprimet

Ky seksion përshkruan veprimet e menaxhimit të incidentit duke u renditur nga njoftimi fillestar për kërcënimin deri tek përpjekjet e hershme koordinuese për ta vlerësuar dhe përçarë kërcënimin, deri tek aktivizimi paraprak i strukturës së FME-së përkatëse, e deri tek dislokimi i resurseve qendrore në mbështetje të operacioneve të reagimit dhe rimëkëmbjes nga incidenti. Këto veprime jo patjetër ndodhin sipas radhës; shumica mund të ndërmerren njëkohësisht në reagim ndaj kërcënimeve apo incidenteve individuale apo të shumëllojshme.

Figura X përshkruan veprimet fillestare të menaxhimit të incidentit. Në rastet kur parashihet që një Incident i Karakterit Kombëtar është i pashmangshëm apo kur tanimë ka ndodhur, vlerësimi dhe koordinimi e brendshëm paraprak zakonisht bashkohen apo ngjishen. Në këtë rast MPB-ja lëviz shpejt në drejtim të koordinimit të aktiviteteve të shumëfishta qendrore për të përfshirë me sa vijon: shkëmbimin e informacioneve, zhvillimin e kursit të brendshëm të veprimit, alarmimin dhe dislokimin e resurseve, koordinimin operacional dhe ndihmat tjera sipas nevojës, në konsultim dhe koordinim me ministritë dhe agjencionet tjera qendrore dhe juridiksionet e goditura.

Njoftimi dhe vlerësimi

Organizatat qendrore, regjionale, lokale, të sektorit privat dhe ato joqeveritare raportojnë kërcënimet, incidentet aktuale dhe të mundshme duke përdorur linjat dhe kanalet e caktuara të komunikimit. QO e MPB-së pranon informacione lidhur me kërcënimet dhe operacionet lidhur me incidentet apo incidentet e mundshme dhe bënë një përcaktim fillestar për të koordinuar aktivitetet e shkëmbimit qendror të informacioneve dhe të menaxhimit të incidenteve.

Obligimet për raportim

QOE qendrore, regjionale, lokale, të sektorit privat dhe OJQ-ve janë ose të obliguara ose të inkurajuar për t'i raportuar informacionet për incidentin tek QO e MPB-së, e cila të njëjtat i raporton tek QSKSKSë. Në shumicën e rasteve, informacionet për incidentin raportohen duke përdorur mekanizmat ekzistues të qendrave operative regjionale apo qendrore, të cilat pastaj do t'i raportojnë informacionet tek QO e MPB-së.


- **Ministritë dhe agjencitë qendrore:** Nga ministritë dhe agjencitë qendrore kërkohet që t'i raportojnë informacionet lidhur me Incidentet aktuale apo të mundshme të Karakterit Kombëtar në QO të MPB-së. Ky informacion mund të përfshijë:
 - Implementimin e planit të reagimit emergjent të ministrisë apo agjencionit qendror;
 - Veprimet e parandalimit, reagimit apo rimëkëmbjes nga një Incident të Karakterit Kombëtar për të cilin ministria apo agjencioni qendror bartë përgjegjësinë sipas ligjit apo udhëzimit përkatës;
 - Dorëzimi i kërkesave për ndihmë, apo pranimitë të kërkesave nga një ministri apo agjenci tjetër qendrore në kontekst të një Incidenti me Karakter Kombëtar;
 - Pranimin e kërkesave për ndihmë nga pushteti lokal; OJQ-të; apo sektori privat në kontekst të një Incidenti me Karakter Kombëtar dhe
 - Aktivitetet e dyshimta apo kërcënimet me lidhje të mundshme terroriste (normalisht nëpërmjet kanaleve të caktuara zyrtare).

- **Strukturat qendrore regjionale:** Strukturat qendrore regjionale dhe strukturat e menaxhimit emergjent përdorin mekanizmat ekzistues të raportimit dhe janë të inkurajuar t'i raportojnë informacionet lidhur me Incidentet aktuale apo të mundshme me Karakter Kombëtar në QO të MPB-së, duke përdorur procedurat e vendosura nga MPB-ja. Në këto informacione përfshihen:
 - Implementimi i një plani apo veprimi të menaxhimit të incidentit apo të reagimit emergjent për parandalim, reagim apo rimëkëmbje nga Incidenti me Karakter kombëtar;
 - Njoftimin për shpalljet e gjendjeve emergjente nga autoriteti lokal gjegjës;
 - Aktivizimin e marrëveshjeve regjionale për ndihmë reciproke në reagim ndaj incidenteve që rezultojnë me shpallje të gjendjes emergjente apo që kërkojnë ndihmë qendrore.

- **Qeveritë lokale: Informacionet lidhur me incidentet e karakterit kombëtar qeveritë lokale i komunikojnë nëpërmjet mekanizmave të caktuar në QO të MPB-së në koordinim me zyrtarët e strukturave regjionale dhe QOE-të.**

- **Spektori privat / Organizatat joqeveritare:** Spektori privat dhe organizatat joqeveritare janë të inkurajuara t'i komunikojnë informacionet lidhur me incidentet aktuale apo të mundshme me karakter kombëtar në QO të MPB-së nëpërmjet mekanizmave ekzistues të raportimit legal sikurse edhe nëpërmjet organizatave për shkëmbimin dhe analizimin e informacioneve.

Fig. 5. Rrjedha e veprimeve fillestare të nivelit qendror të menaxhimit të incidentit



Shpërndarja e paralajmërimeve dhe buletineve

Vëzhgimet, paralajmërimet dhe buletinet tjera emergjente lëshohen nga agjencitë e ndryshme mbi bazën e misioneve dhe autoritetit të tyre. Për shembull Instituti Kombëtar Meteorologjik lëshon njoftime të lidhura me motin për t'i paralajmëruar qytetarët për shtrëngatat dhe motin e lig të mundshëm.

QOMPB koordinon me QOPK, DAK, Ministrinë e Shëndetësisë dhe programet e ngjashme për analizat dhe paralajmërimet për rreziqet që kanë të bëjnë me terrorizmin dhe shpërndanë paralajmërimet dhe buletine këshilluese lidhur me rreziqet për sigurinë kombëtare. QOMPB e bënë këtë detyrë në përputhje me funksionin e saj të qëndrueshëm të monitorimit, vlerësimit, hulumtimit dhe raportimit të kërcënimeve.

QOAME në koordinim me QOMPB, ndihmon shpërndarjen e paralajmërimeve, alarmeve dhe buletineve tek komuniteti i menaxhimit emergjent duke përdorur sisteme të ndryshme të komunikimit

Kërcënimet në rritje të identifikuara në nivelin qendror

Shkrirja e vazhdueshme e informacioneve inteligjente në nivelin qendror mund të përfundoj në zbulimin e kërcënimit të mundshëm terrorist të natyrës specifike dhe të besueshme apo të një fatkeqësie tjetër. Ndryshe nga incidentet e raportuara nga terreni, ky proces rezulton në iniciimin e veprimeve fillestare të menaxhimit emergjent në nivelin e zyrave qendrore dhe gjeneron reagimin “Lartë- Poshtë” për zbulimin, parandalimin ose reagimin ndaj kërcënimit terrorist.

QOMPb, QOPK, Drejtoria për Intelgjencë dhe Analizë e PK (DIA) dhe QOAME koordinon informacionet lidhur me kërcënimet nga fatkeqësitë natyrore, teknologjike dhe aktet e terrorizmit. Kur DIA përcakton që ekziston kërcënimi i besueshëm nëpërmjet QOPK e njofton dhe koordinon me QOMPb-në, e cila menjëherë e njofton QSKSK-në, nëse nuk është informuar ende. QOMPb pastaj njofton ministrin e Punëve të Brendshme, i cili mund të vendos që të aktivizohet një apo të gjitha elementet organizative të PRK-së, sikurse edhe iniciimin e koordinimit të çështjeve të politikave ndërinstitucionale dhe kurset e veprimit operativ Qeverinë, sipas nevojës. Ministri (në cilësinë e koordinatorit qeveritar), gjithashtu mund të vendos të aktivizoj apo përgatis për dislokim ekipet e ndryshme speciale për të zhvilluar aktivitete të parandalimit, gatishmërisë, reagimit dhe të rimëkëmbjes.

Aktivizimi

Ky seksion shtjellon përpjekjet e fazës së hershme për aktivizimin dhe dislokimin e elementeve organizative të PRK-së dhe resurseve qendrore, përfshirë ekipet speciale, shërbimet emergjente dhe resurset tjera reaguese.

Për incidentet aktuale apo të mundshme të karakterit kombëtar, QOMPb situatën e raporton tek Ministri i Punëve të Brendshme dhe/apo stafi i lartë sipas udhëzimit të Ministrisë, i cili pastaj përcakton nevojën për aktivizimin e komponentëve të PRK-së për të zhvilluar vlerësime të mëtutjeshme të situatës, iniciimin e koordinimit ndërinstitucional, shkëmbimin e informacioneve me juridiksionet e goditura dhe sektorin privat dhe/apo iniciimin e dislokimit të resurseve. Njëkohësisht, ministri gjithashtu bënë përcaktimin se nëse një ngjarje i plotëson kriteret e caktuara për incidentin aktual apo të mundshëm të karakterit kombëtar, sipas përcaktimit në këtë plan.

Kur ministri pas konsultimit me Kabinetin Qeveritar e shpall një Incident të Karakterit Kombëtar, ministrinë dhe agjencionet qendrore njoftohen nga QOMPb-së dhe mund të thirren për të plotësuar GNMI-në dhe QOAME. Komunitet e goditura, gjithashtu njoftohen nga QOMPb duke përdorur protokollin përkatës operativ të sigurisë. Në gjendjen para-incidentit, njoftimi i tillë mund të bëhet në formë diskrete, mbi bazën e nevojës për të ditur, me qëllim të ruajtjes së sigurisë operative dhe sekretin e operacioneve të caktuara hetimore dhe të zbatimit të ligjit.

QOAME dhe QOER dislokojnë, përcjellin dhe sigurojnë informacione lidhur me incidente derisa të themelohet QBF-ja.

Seksioni i radhës shtjellon elementet organizative të PRK-së të cilat mund të aktivizohen dhe kryejnë veprimet e tyre fillestare.

Elementet organizative të Zyrave Qendrore

Elementet organizative të zyrave qendrore përfshijnë me sa vijon:

Elementi	Përshkrimi
Grupi Ndërinstitucional i Menaxhimit të Incidentit	Kur aktivizohet për një takim fillestar GNMI mund të mblidhet në Zyrat Qendrore të MPB-së. Anëtarët e GNMI apo zëvendësuesit e tyre mbesin në thirrje për tu takuar në çdo kohë gjatë periudhave të alarmeve të ngritura apo gjatë një incidentit apo mbi bazën 24/7 sipas kërkesës së situatës së dhënë. GNMI mund të caktoj zyrtar ndërlidhës për QOMPB dhe/apo QOE tjera, sipas nevojës, dhe mund të vendos komunikim me Zyrtarët Qendror të Menaxhimit Emergjent.
Qendra Operative e Agjencisë së Menaxhimit Emergjent	QOAME fillon operacionet ndërinstitucionale duke koordinuar aktivizimin fillestar, dislokimin e ekipeve speciale, inicimin dhe monitorimin e misioneve të ngarkuara apo kërkesat tjera ndërinstitucionale dhe QOER aktivizohen sipas nevojës dhe sipas rrethanave. QOAME nëpërmjet QOMPB-së informon agjencitë parësore për aktivizimin. Agjencitë parësore mund t'i njoftojnë agjencitë mbështetëse nëse është nevoja.
Qendrat Operative Qendrore	Ministritë dhe agjencionet qendrore mund t'i aktivizojnë QOE-të e tyre për të siguruar koordinim dhe udhëzime për zyrat e tyre qendrore dhe elementet regjionale të reagimit. QOQ-të mbajnë kontakt dhe koordinim të vazhdueshëm me QOMPB-në dhe QSKSK-në.
Qendra Operative e Policisë së Kosovës	Me rastin e përcaktimit se kërcënimi terrorist është i besueshëm apo që një akt terrorist tanimë ka ndodhur, Zyra Qendrore e PK-së inicion lidhjen me agjencionet tjera qendrore për t'i aktivizuar qendrat e tyre operative dhe për të siguruar zyrtar ndërlidhës për QOPK-në. Zyrtari i PK-së në terren vendos prioritetet fillestare operative bazuar në rrethanat specifike të kërcënimit apo incidentit. Ky informacion pastaj bartet tek Zyra Qendrore e PK-së për të koordinuar përcaktimin dhe dislokimin e resurseve të nevojshme. QOPK do ta njoftoj QOMPB menjëherë pas konfirmimit të lidhjes së sigurt të kërcënimit apo incidentit me terrorizëm.
I Deleguari i Ministrit	Ministri siguron njoftimin formal për emërimin e IDM për kryetarin e komunës së goditur dhe ministritë dhe agjencitë qendrore. QOMPB njofton QSKSK dhe QOE tjera qendrore dhe regjionale për IDM-në e emëruar. Nga QOER-të pritet që këtë informacion ta plasojnë tek strukturat regjionale dhe autoritetet lokale si dhe tek QOE tjera sipas nevojës.

Elementet Regjionale

Resurset regjionale mund të aktivizohen për të monitoruar dhe vlerësuar nevojat për mbështetje qendrore të menaxhimit të incidentit. Koordinatorët Regjional të AME-së dislokojnë ndërlidhës tek QOE lokale për të ofruar asistencë teknike dhe këshilla mbi procesin e shpalljes së gjendjes emergjente sipas ligjit dhe për ndihmat qendrore në dispozicion, dhe gjithashtu aktivizojnë pjesërisht apo plotësisht QOER-të përfshirë, sipas nevojës, përfaqësuesit regjional të degëve të ministrive dhe agjencive qendrore.

Sektorët e Logjistikës të QOER dhe QOAME ndihmojnë vendosjen e QBF-së dhe qendrave të mobilizimit. QOER koordinon ndihmat qendrore të kërkesave të komunave derisa këto funksione t'i marr përsipër QBF-ja. Për të siguruar pikë qendrore për koordinimin e aktiviteteve të informimit publik mund të themelohet QBI-ja.

Elementet Fushore

Elementet fushore përfshijnë me sa vijon:

Elementi	Përshkrimi
Ekipi i reagimit emergjent	<p>AME fillimisht dislokohet ERE-A përfshirë personelin për vlerësimin e nevojave urgjente dhe përfaqësuesit e duhur të FME-ve tek mjediset operative regjionale dhe vendet e incidentit për të vlerësuar efektin goditës të situatës, për të grumbulluar informacione për dëmet, për të bërë grupimin e kërkesave për ndihma të menjëhershme qendrore dhe për të bërë aranzhimet paraprake për vendosjen e mjediseve fushore qendrore. Kur resurset regjionale tejkalohen apo kur një ngjarje paraqet pasoja të mundshme të konsiderueshme, Zyra Qendrore e MPB-së mund të dislokojë një ekip qendror për ta koordinuar reagimin fillestar.</p> <p>ZKQ/KRQ kryeson ERE ndërinstitucional. ERE punon me komunën e goditur dhe koordinon ndihmën qendrore nga QBF-ja. ERE mund të themelojë një MPO për të shërbyer si një mjedis ndërmjetësues derisa të themelohet QBF. Agjencitë qendrore dhe entitetet përkatëse sigurojnë resurse për t'i mbështetur përpjekjet e menaxhimit të incidentit sipas misionëve të ngarkuara nga MPB-ja apo sipas autoriteteve tjera të tyre.</p>
Ekipet tjera qendrore	<p>Varësisht nga natyra e incidentit mund të dislokohen ekipe tjera speciale në koordinim me ministrinë dhe agjencitë tjera. Aneksat e PRK-së përfshijnë informacionet e hollësishme lidhur me ekipet dhe resurset speciale.</p>
Reaguesit e parë qendror	<p>Disa agjenci qendrore kanë përgjegjësi dhe autoritet legal për të dislokuar drejtpërsëdrejti reagues të parë me rastin e njoftimit për një incident apo incident të mundshëm. Këta reagues mund të arrijnë në vendngjarje para përcaktimit se një incident është i karakterit kombëtar por, kur të shpallet si i tillë, do të veprojnë në përputhje me protokollin e vendosur në PRK.</p>

Kërkesat për asistencë të MPB-së

Kërkesat për asistencë të MPB-së mund të vijnë nga kryetarët e komunave të cilët kërkojnë ndihmë sipas ligji FNFT apo nga agjencitë qendrore për nevojat mbështetëse brenda qeveritare.

- **Mbështetja qendrore për komunitet:** Sipas udhëzimeve të ligjit FNFT, AME e MPB-së i përpunon kërkesat e kryetarëve të komunave për shpallje të gjendjes emergjente. Kryetarët e komunave i dorëzojnë këto kërkesa tek AME/MPB duke pasqyruar gjerësinë e dëmeve dhe llojin e ndihmës së nevojshme qendrore. AME/MPB pastaj kërkesën e kryetarit së bashku me kursin e propozuar të veprimit (nëpërmjet ministrit të MPB-së) e përcjell në qeveri për procedim të mëtutjeshëm.

Paralelisht me shpalljen e gjendjes emergjente dhe emërimit zyrtar të një ZKQ, AME/MPB cakton llojet e ndihmave që duhet vënë në dispozicion dhe strukturat e zgjedhura për pranimin e tyre. Në ngjarjet me shtrirje të gjerë apo katastrofike procesi i shpalljes mund të përshpejtohet.

- **Mbështetja brenda qeveritare:** Për disa incidente për të cilat nuk është bërë shpallja e gjendjes emergjente dhe ku është duke reaguar entiteti qendror nën autoritetin e tij, ai entitet mund të kërkojë asistencë plotësuese nga ministrinë dhe agjencitë tjera qendrore. Në

rrethanat e tilla, ministria apo agjencia qendrore e goditur mund të kërkoj koordinimin e MPB-së për marrjen e ndihmës së tillë.

Agjencitë qendrore pjesëmarrëse në PRK do të kërkojnë dhe sigurojnë mbështetje brenda qeveritare duke zbatuar marrëveshjet pa pagesë ndërinstitucionale apo jashtë institucionale në pajtim me ligjet në fuqi. Agjencitë qendrore që sigurojnë ndihmë reciproke mund të kërkojnë shpazim nga agjencia kërkuese për shpenzimet e pranueshme (Shtojca 3 Aneksi për Mbështetjen e Menaxhimit Financiar – Memorandumin e Mirëkuptimit: Ndhima Reciproke për Incidentet e Karakterit Kombëtar).

MPB do t'i përdor FME-të si mekanizëm për koordinimin e mbështetjes së kërkuar nga agjencitë tjera. Kur ndihma e tillë e MPB-së sigurohet, incidenti bëhet i karakterit kombëtar dhe MPB-ja koordinon resurset qendrore sipas autorizimeve të siguruara nga vendimi Nr. 1231. Në këto situata MPB cakton një KRQ për të zbatuar funksion të koordinimit të resurseve.

Kërkesat për ndihmë dërgohen tek sekretari përgjithshëm i MPB-së për përpunim dhe marrje në konsideratë apo aprovim nga ministri. Me aprovimin e kërkesës, ministri lëshon një urdhër operativ për QOMP-bë. QOMP-bë nëpërmjet QOAME koordinon aktivizimin e FME-së përkatëse. Në këtë kohë ministri i Punëve të Brendshme, gjithashtu mund të zgjedh që ta aktivizoj edhe GNMI-në për të filluar monitorimin e situatës dhe bërjen e rekomandimeve të kurseve të nevojshme të veprimit.

Veprimet para-incidentit

“Veprime të ndërmarra për shmangien e një incidenti apo për të ndërhyrë me qëllim të ndaljes së tij. Parandalimi përfshinë veprimet e ndërmarra për mbrojtjen e jetës dhe të mirave materiale.”

Në nivelin kombëtar QOMP-bë ndihmon aktivitetet e shkëmbimit ndërinstitucional të informacioneve për të mundësuar vlerësimin, parandalimin apo zgjidhjen e incidenteve të mundshme. Bazuar në udhëzimet nga KSK, MPB koordinon me agjencitë përkatëse (sipas nevojës) gjatë situatave në zhvillim për të ndihmuar resurset dhe autoritetet e agjencisë për të parandaluar një incident, sikurse edhe për të iniciuar masat e nevojshme përgatitore dhe lehtësuese për zvogëlimin e dobësive. Nëse është e nevojshme, GNMI mund të propozoj aktivizimin e elementeve plotësuese organizative të PRK-së për t'i siguruar resurset e nevojshme për të mundësuar aktivitete më të fuqishme të parandalimit apo gatishmërisë.

Veprimet parandaluese të lidhura me kërcënimet dhe incidentet e mundshme përfshijnë aktivitetet e zbatimit të ligjit dhe aktivitetet mbrojtëse. Përpjekjet fillestare të parandalimit përfshijnë (por nuk kufizohen me kaq) veprimet për:

- Grumbullimin, analizimin dhe përdorimin e informacioneve inteligjente dhe informacioneve tjera;
- Zhvillimin e hetimeve për përcaktimin e natyrës dhe burimit të plotë të kërcënimit;
- Zbatimin e kundërmasave siç janë vrojtimi dhe kundër-inteligenca;
- Zbatimin e operacioneve të sigurisë, përfshirë vlerësimin e dobësive, sigurinë e vendit dhe mbrojtjen e infrastrukturës;
- Zbatimin e operacioneve taktike për parandalimin, ndalimin, izolimin apo përçarjen e aktivitetit ilegal (për rastet e shkaktuara nga faktori njeri);
- Zbatimin e hetimeve të mbuluara, përfshirë një vlerësim të mundësive për incidentet e ardhshme të lidhura dhe

- Zbatimin e aktiviteteve për parandalimin e terroristëve, armëve të terroristëve dhe materialet shoqëruese nga hyrja dhe lëvizja brenda Kosovës.

Shumica e veprimeve fillestare në zonën e kërcënuar apo të rrezikuar ndërmerren nga reaguesit e parë dhe autoritetet e pushtetit lokal dhe përfshijnë përpjekjet për mbrojtjen e popullit dhe zvogëlimin e dëmeve ndaj pronave dhe mjedisit, si në vijim:

- **Siguria dhe shëndeti publik:** Përpjekjet fillestare të sigurisë përqendrohen në veprimet për zbulimin, parandalimin apo zvogëlimin e efekteve dëmtuese në shëndetin dhe sigurinë publike. Veprimet e tilla mund të përfshijnë analizimin e mjedisit, strukturën e pendave, evakuimet, strehimin emergjent, monitorimin e cilësisë së ajrit, dekontaminimin, përcjelljen e shpërthimit të sëmundjeve ngjithëse, parashikimet emergjente, etj. Këto përpjekje mundën gjithashtu të përfshijnë edukimin për shëndetin publik, vrojtimin e shëndetit publik dhe testimin e procedurave dhe vaksinimet, masat parandaluese, izolimet dhe karantinën për kërcënimet biologjike të koordinuara nga MSH dhe zyrtarët regional dhe lokal të shëndetit publik. (Aneksi i FME 8).
- **Siguria dhe shëndeti i reaguesve:** Siguria dhe shëndeti i reaguesve është gjithashtu prioritet. Veprimet esenciale për kufizimin e rrezikut të tyre përfshijnë integrimin e plotë të mjeteve dhe ekspertizës së dislokuar të sigurisë dhe shëndetit, vlerësimin e rrezikut të bazuar në të dhëna aktuale dhe njohje të situatës e cila merr parasysh sigurinë e reaguesit dhe punëtorit të rimëkëmbjes.

Plani i sigurisë së operacioneve të reagimit është qelësi i zvogëlimit të rreziqeve me të cilat ballafaqohen reaguesit. Këto përpjekje përfshijnë identifikimin dhe kategorizimin e rrezikut të incidentit; zbatimin dhe monitorimin e zgjedhjes, përdorimit dhe dekontaminimit të pajisjeve për mbrojtje personale; zbulimin dhe analizimin e mostrave; analizimin e rrezikut për sigurinë dhe shëndetin e punëtorëve; monitorimin e sigurisë dhe shëndetit dhe zhvillimin e vazhdueshëm të vlerësimit të planit të sigurisë për veçorinë e vendit. (Aneksi për Siguri dhe Mbështetje Shëndetësore për Punëtorët).

- **Të mirat materiale dhe mjedisi:** Reaguesit gjithashtu mund të ndërmarrin veprime për zbutjen e incidentit për mbrojtjen e të mirave materiale publike dhe private dhe mjedisit. Veprimet e tilla mund të përfshijnë mbushjen e thasëve me rërë në pritjen e ndonjë vërshimi, apo pyllëzimin e zonave të ndjeshme të mjedisit në reagim ndaj rrjedhjeve të mundshme të vajrave.

Veprimet reaguese

“Aktivitete të cilat adresojnë efektet e shpejta dhe të drejtpërdrejta të një incidenti. Këto aktivitete përfshijnë veprimet e menjëhershme për ruajtjen e jetës, të mirave materiale dhe mjedisit; plotësimin e nevojave themelore njerëzore dhe mirëmbajtjen e strukturën sociale, ekonomike dhe politike të komunitetit të goditur.”

Kur një incident ndodh, prioriteti nga parandalimi, gatishmëria dhe zvogëlimi i incidentit kalon në aktivitetet e reagimit të shpejtë dhe të menjëhershëm për ruajtjen e jetës, të mirave materiale, mjedisit dhe strukturës sociale, ekonomike dhe politike të komunitetit.

Për përforcimin e reagimit fillestar ndaj një incidenti disa agjenci qendrore mund të veprojnë në PKI si reagues të parë qendror dhe të marrin pjesë në strukturën e Komandës së Bashkuar. Kur QBF ngritet, Grupi koordinues i saj vendos prioritetet operative qendrore. QBF siguron resurse në

mbështetje të KB dhe ekipet e menaxhimit të incidentit që zhvillojnë operacione në vendin e ngjarjes nëpërmjet QOE-ve regjionale dhe atyre lokale.

Varësisht nga shtrirja dhe madhësia e incidentit QOAME apo QOER aktivizon FME-të përkatëse (sipas nevojës) për t'i mobilizuar mjetet dhe dislokimin e resurseve për mbështetjen e incidentit. QOAME apo QOER ndihmon dislokimin dhe transportin e ERE-ve dhe ekipeve tjera dhe kapaciteteve të specializuara varësisht nga natyra e incidentit. Veprimet tjera reaguese përfshijnë vendosjen e QBF-së dhe mjediseve tjera fushore dhe sigurimi i një varg mbështetjesh për menaxhimin e incidentit, shëndetit publik dhe nevojave tjera të komunitetit.

Veprimet reaguese, gjithashtu përfshijnë veprimet e zbatimit menjëhershëm të ligjit, zjarrfikjes, ambulancave dhe shërbimeve emergjente mjekësore, luftimit emergjent të vërshimeve; evakuimet, informimin publik emergjent, veprimet e ndërmarra për zvogëlimin e dëmeve shtesë, kërkim-shpëtimin urban, vendosjen e mjediseve për përkujdes masiv, furnizimin me shërbime shëndetësore, të ushqimit, ujit të pijshëm dhe domosdoshmëritë tjera emergjente; pastrimin e rrënojave; sanimin emergjent të infrastrukturës kritike; kontrollin, frenimin dhe zhvendosjen e ndotësve mjedisor dhe mbrojtjen e shëndetit dhe sigurisë së reaguesve.

Gjatë reagimit ndaj ngjarjes terroriste, veprimet e zbatimit të ligjit për grumbullimin dhe ruajtjen e provave dhe kapjen e autorëve të krimit janë kritike. Këto veprime ndodhin paralelisht me operacionet e reagimit të domosdoshme për shpëtimin e jetës dhe mbrojtjen e të mirave materiale dhe koordinohen ngushtë me përpjekjen për zbatimin e ligjit për të ndihmuar grumbullimin e provave pa ndikuar në operacionet në zhvillim për shpëtimin e jetës.

Në kontekst të incidentit të vetëm, kur përfundojnë aktivitetet reaguese dhe misionet e shpëtimit të jetës, përkushtimi kalon nga operacionet e reagimit në ato të rimëkëmbjes dhe nëse është e mundshme në ato të zvogëlimin të rrezikut. Sektori i Planifikimit i QBF-së harton planin e demobilizimit për lirin e komponentëve përkatëse.

Veprimet rimëkëmbëse

“Zhvillimi, koordinimi dhe zbatimi i planeve për riparimin e shërbimeve dhe vendngjarjes, si dhe rivendosja e operacioneve dhe shërbimeve qeveritare përmes programeve të ndihmës individuale, të sektorit privat, joqeveritare dhe publike.”

Rimëkëmbja përfshinë veprimet e nevojshme për t'i ndihmuar individët dhe komunitetet të kthehen në gjendje normale, kur është e mundshme. QBF është pika qendrore koordinuese midis agjencive qendrore, regjionale, lokale dhe organizatave vullnetare për shpërndarjen e programeve të ndihmave.

Sektori Operativ i QBF-së ndërthet në vete Degën e Shërbimeve Humane, Degën e Mbështetjes së Infrastrukturës dhe Degën e Rimëkëmbjes së Komuniteteve. Degët e burimeve humane dhe të mbështetjes së infrastrukturës të Sektorit Operativ të QBF-së vlerësojnë nevojat rimëkëmbëse të komunave në prag të një incidenti dhe zhvillojnë afatet kohore përkatëse për shpërndarjen e programeve. Këto degë sigurojnë që agjencionet qendrore të cilat posedojnë ndihmën e nevojshme të rimëkëmbjes të njoftohen për një incident dhe shkëmbejnë informacionet përkatëse të aplikimit dhe të dëmeve, me të gjitha agjencionet e përfshira (sipas nevojës) duke siguruar që privatësia e individëve është e mbrojtur.

Degët e sipër përmendura koordinojnë midis tyre për identifikimin e programeve për ndihma të agjencive përkatëse për plotësimin e nevojave të aplikuesve, sinkronizimin e shpërndarjes së ndihmave dhe kur është e mundur, inkurajimin e integritit të masave për zvogëlimin e rreziqeve. Masat e zvogëlimit të rreziqeve përcaktohen në ujdi me planet e zhvilluara nga niveli lokal dhe të mandatuara nga niveli qendror. Analizat e rrezikshmërisë për zvogëlimin e rreziqeve; ndihma teknike për qeveritë lokale, qytetarët dhe bizneset dhe grantet e ndihmave janë të përfshira në kornizën e zvogëlimit të rreziqeve. Për më tepër, këto degë punojnë së bashku për përcjelljen e progresit të gjithëmbarshtëm të përpjekjeve të rimëkëmbjes, veçanërisht duke shënuar mungesat dhe fushat problematike të mundshme të programit.

Rimëkëmbja afatgjate e mjedisit mund të përfshijë pastrimin dhe restaurimin e objekteve publike, bizneseve dhe vendbanimeve, zhvendosjen e banorëve dhe parandalimin e dëmeve pasuese ndaj burimeve natyrore, mbrojtjen e hapësirave kulturore dhe arkeologjike dhe mbrojtjen e resurseve natyrore, kulturore dhe historike nga dëmtimi i qëllimshëm gjatë operacioneve tjera të rimëkëmbjes.

Dega e Rimëkëmbjes së Komunitetit punon me Degët e Burimeve Humane dhe atë të Infrastrukturës dhe me zyrtarët regjional dhe lokal për ta ndihmuar zhvillimin e strategjisë afatgjate të rimëkëmbjes për zonat e goditura.

Demobilizimi

Kur prezenca e koordinimit të centralizuar qendror nuk është më e nevojshme në zonën e goditur, Grupi Koordinues i QBF-së zbaton planin e demobilizimit për transferimin e përgjegjësive dhe mbylljen e QBF-së. Pas mbylljes së QBF-së, menaxhimi dhe monitorimi i programeve afatgjate të rimëkëmbjes kalon tek agjencitë individuale, zyrat regjionale dhe/apo zyrat qendrore, sipas nevojës.

Veprimet riparuese

MPB-ja formalisht thërret takime të brendshme të quajtura “Diskutimet e nxehta” për identifikimin e çështjeve kritike të cilat kërkojnë vëmendjen e nivelit të zyrës qendrore, mësimet e nxjerra dhe përvojat më të mira të shoqëruara me reagimin qendror ndaj Incidenteve të Karakterit Kombëtar. Diskutimet e nxehta në mënyrë tipike zhvillohen në pikat e mëdha kalimtare përgjatë kursit të operacioneve të menaxhimit të incidentit dhe përfshinë pjesëmarrjen regjionale, dhe lokale, sipas nevojës.

Raporti pas veprimit

Në vijim të një incidenti grupi koordinues i QBF-së e dorëzon një raport pas veprimit tek Zyra Qendrore e MPB-së duke renditur sukseset, problemet dhe çështjet kyçe operative që kanë ndikim në menaxhimin e incidentit. Raporti përfshinë informacionet e nevojshme kthyes nga të gjithë partnerët qendror, regjional, lokal, joqeveritar dhe të sektorit privat pjesëmarrës në incident.

Secila agjenci qendrore e përfshirë duhet të mbaj shënime për aktivitetet e saj për të ndihmuar në përgatitjen e raportit të saj pas veprimit. Instituti i Menaxhimit Emergjent i SIME-së e mbështet dhe kontribuon në këtë aktivitet.

VI. MENAXHIMI DHE MIRËMBAJTJA E VAZHDUESHME E PLANIT

Mirëmbajtja e Planit

AME/MPB në koordinim të ngushtë me Kabinetin e Ministrisë të MPB-së është përgjegjës për menaxhimin dhe mirëmbajtjen e PRK-së. PRK do të plotësohet periodikisht sipas nevojave të inkorporimit të udhëzimeve të reja, ndryshimeve legjislative dhe procedurale bazuar në mësimet e nxjerra nga ushtrimet dhe ngjarjeve aktuale. Ky seksion vendos procedurat për ndryshimet e brendshme dhe plotësimet e PRK-së.

- **Llojet e ndryshimeve.** Ndryshimet përfshijnë shtimin e materialeve të reja apo plotësuese dhe shlyerjet. Asnjë ndryshim i propozuar nuk duhet të jetë në kundërshtim me autorizimet apo planet tjera.
- **Koordinimi dhe miratimi.** Çdo ministri apo agjenci me përgjegjësi të caktuara sipas PRK-së mund të propozoj ndryshim të planit. MPB-ja është përgjegjëse për koordinimin e të gjitha modifikimeve të propozuara të PRK-së me agjencitë parësore dhe mbështetëse dhe palët tjera të interesit (sipas nevojës). MPB-ja do të koordinoj rishikimin dhe miratimin për modifikimet e propozuara nëpërmjet KSK-së (sipas nevojës).
- **Njoftimi i ndryshimeve.** Pasi të jetë kryer koordinimi, përfshirë nënshkrimin e aprovimit përfundimtar të gjuhës së ndryshimit, MPB-ja do të lëshoj një Njoftim Zyrtar për Ndryshimin.

Njoftimi do të specifikoj datën, numrin, lëndën, qëllimin, historikun dhe veprimet e nevojshme dhe siguron gjuhën e ndryshimeve në një apo më shumë faqe me numër dhe datë të cilat do t'i zëvendësojnë faqet e modifikuara në PRK. Kur publikohen modifikimet do të konsiderohen pjesë e PRK për qëllime operative duke u varur nga rishikimi dhe ri-lëshimi formal i tërë dokumentit. Ndryshimet e brendshme mund të modifikohen apo plotësohen në të ardhmen duke e përdorur procesin e sipër përmendur.

- **Shpërndarja.** Njoftimin për Ndryshime MPB-ja do ta shpërndaj tek të gjitha agjencitë pjesëmarrëse, Zyrtar Qendror të MPB-së dhe zyrtarë regjionale të menaxhimit emergjent. Njoftimi i Ndryshimeve për organizmat tjerë do të bëhet me kërkesë.
- **Ri-lëshimi i PRK-së.** Duke punuar në drejtim të përmirësimit të vazhdueshëm, MPB është përgjegjëse për koordinimin e plot të rishikimeve dhe plotësimeve të PRK-së çdo 4 vite, apo më shpesh nëse Ministri e sheh të arsyeshme. Rishikimi dhe plotësimi do t'i marr parasysh mësimet e nxjerra dhe përvojat më të mira të përcaktuara gjatë ushtrimeve dhe reagimeve ndaj ngjarjeve aktuale dhe do të përfshijë teknologjitë e reja informative. MPB do t'i shpërndaj dokumentet e rishikuara të PRK-së tek KSK për qëllime të rishikimit dhe konkurrencës ndërinstitucionale.

Instituti i Menaxhimit Emergjent i SIME-së

Në përputhje me SIME-në, Instituti i Menaxhimit Emergjent i SIME-së është përgjegjës për lehtësimin e zhvillimit dhe adaptimit të standardeve, udhëzimeve dhe protokolleve të nivelit kombëtar të lidhura me SIME-në. AME/MPB do të konsultohet me Institutin e Menaxhimit Emergjent të SIME-së sipas nevojës për menaxhimin dhe mirëmbajtjen e PRK-së.

PRK dhe Gatishmëria Kombëtare

PRK siguron aspektet kyçe të pajtueshmërisë së ministrive dhe agjencive qendrore me aspektet e gatishmërisë kombëtare. Ministria e Punëve të Brendshme do t'i koordinoj përpjekjet për vlerësimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të gatishmërisë kombëtare. Detyrat e gatishmërisë të lidhura me PRK-në dhe plotësimet shoqëruese janë të përmbledhura në vijim:

- MPB ndërton qëllimin e gatishmërisë për të gjitha rreziqet kombëtare në koordinim me ministrinë dhe agjencitë tjera qendrore dhe në konsultim me strukturat regjionale dhe qeveritë lokale. Qëllimi vendos sistemin e vlerësimit dhe raportimit të gatishmërisë kombëtare, i cili prodhon një raport vjetor të gjendjes për kryeministrin lidhur me nivelin e gatishmërisë së vendit.
- Ministrinë dhe agjencitë përkatëse ndërmarrin veprime për mbështetjen e qëllimit të gatishmërisë kombëtare, përfshirë adaptimin e njësisë matëse të performancës kuantitative në fushat e trajnimeve, planifikimit, pajisjeve dhe ushtrimeve për gatishmërinë kombëtare. Masat e performancës dorëzohen në MPB për sistemin e vlerësimit dhe raportimit të gatishmërisë kombëtare.
- Raporti vjetori i kryeministrit përfshinë (por nuk është i kufizuar me kaq) informacionet për gatishmërinë e aseteve të reagimit qendror. Ministrinë dhe agjencitë përkatëse qendrore janë të obliguara të mirëmbajnë asete të specializuara qendrore, siç janë ekipet, rezervat dhe depot në nivelet konsistente me qëllimin e gatishmërisë kombëtare dhe për t'i bërë ato të disponueshme për aktivitetet e reagimit sipas përcaktimit në PRK.
- MPB ndërton dhe mirëmban inventarin e kapaciteteve reaguese qendrore në koordinim me ministrinë dhe agjencitë tjera përkatëse, i cili përfshinë parametrat performuese të kapacitetit të caktuar, afatin kohor brenda të cilit kapaciteti mund të silllet në një incident dhe gatishmërinë e kapacitetit të tillë për menaxhimin e incidenteve. Zotuesit (agjencitë përkatëse) e kapaciteteve reaguese qendrore janë përgjegjës për pajisjen e MPB-së me informacione plotësuese për të siguruar koherencë të inventarit.
- MPB, në koordinim me ministrinë dhe agjencitë përkatëse qendrore dhe në konsultim me strukturat regjionale dhe qeveritë lokale mirëmban një program gjithëpërfshirës kombëtar të trajnimit, programin kombëtar të ushtrimeve dhe sistemin kombëtar të shkëmbimit të informacioneve për mësimet e mësuara, për përmbushjen e qëllimit të gatishmërisë kombëtare. Këto programe dhe sisteme përdorin SIME-në përfshijnë nevojat për mbështetjen e PRK-së sipas nevojës.

Standardet dhe dokumentet mbështetëse të PRK-së për planet tjera qendrore

PRK është plani kryesor për menaxhimin e incidenteve, siguron strukturat dhe proceset për koordinimin e aktiviteteve të menaxhimit të incidenteve për fatkeqësitë natyrore, emergjencat tjera dhe aktet terroriste, të cilat plotësojnë kriteret e caktuara për Incidentet e Karakterit Kombëtar. PRK inkorporon planet ekzistuese qendrore të menaxhimit të incidenteve (me modifikimet dhe përmirësimet përkatëse) si përbërës të integruar të tij, si plane plotësuese, apo si plane operative mbështetëse.

Paralelisht, ministrinë dhe agjencitë qendrore duhet t'i inkorporojnë konceptet dhe procedurat kryesore të PRK-së për të punuar me elementet organizative të tij, kur hartojnë apo plotësojnë planet e menaxhimit të incidenteve dhe planet e reagimit emergjent të tyre. Kur një agjenci harton

plan qendror ndërinstitucional i cili përfshinë ngjarje brenda shtrirjes së Incidenteve të Karakterit Kombëtar, këto plane koordinohen me MPB-në për të siguruar përputhje me PRK-në dhe inkorporohen në të, qoftë përmes referencës apo si të tërë. AME/MPB do t'i mirëmbaj tërë planet ekzistuese qendrore ndërinstitucionale dhe do të siguroj qasje pa pengesë në këto plane përmes faqes së internetit apo mjeteve tjera përkatëse.

Planet për menaxhimin e incidenteve dhe reagimit emergjent, në gjerësinë e lejuar me ligj, duhet të përfshin,:

- Parimet dhe terminologjinë e SIME-së;
- Obligimet raportuese të PRK-së;
- Lidhjet e elementeve kyçe organizative të PRK-së (siç janë GNMI, QOAME, QOER, QBF, etj.) dhe
- Procedurat për kalimin nga incidentet e lokalizuara në Incidentet e Karakterit Kombëtar.

Vargu më i gjerë i dokumenteve mbështetëse të PRK-së përfshinë planet dhe procedurat kontingjente strategjike, operative, taktike dhe specifike për rrezikun apo incidentin e caktuar. Planet strategjike zhvillohen nga entitetet e nivelit të zyrave qendrore duke u bazuar në qëllimet, objektivat dhe prioritetet afatgjata. Planet e nivelit operativ shkrijnë çështjet taktike të vendngjarjes me objektivat e përgjithshme strategjike. Planet taktike përfshijnë veprimet e veçanta të hollësishme dhe përshkrimin e resurseve të nevojshme për menaxhimin e një incidenti aktual apo të mundshëm. Planet kontingjente janë të bazuar në skenar të veçantë dhe parashikime të planifikuara të lidhura me hapësirën gjeografike apo goditjet e paramenduara të një rreziku individual. Në vijim është një përshkrim i shkurt i dokumenteve të lidhura me PRK-në:

Dokumenti	Përshkrimi
Sistemi i Integruar i Menaxhimit të Emergjencave	SIME ofron bërthamën kryesore të doktrinave, koncepteve, terminologjisë dhe proceseve organizative për të mundësuar menaxhim efektiv, efikas dhe bashkëpunues të incidenteve në të gjitha nivelet.
Planet qendrore ndërinstitucionale	Planet qendrore ndërinstitucionale janë të bazuara ose në autoritetin legal ose në atë rregullativ dhe/apo kontigjencat e veçanta apo llojet e incidenteve. Këto plane sigurojnë protokolle për menaxhimin e shumicës së incidenteve të cilat kanë gjasa të ndodhjes në të gjitha nivelet e qeverisjes, e të cilat normalisht mund të menaxhohen pa nevojën koordinuese të MPB-së. Këto plane mund të zbatohen pavarësisht apo paralelisht me PRK-në. Kur PRK është i aktivizuar, këto plane ndërinstitucionale inkorporohen në të si plane mbështetëse dhe/apo operative. Për qëllime të inkorporimit të plotë në PRK, këto plane këtu do të referohen si shtojca të PRK-së për raste specifike apo fushë misioni që formojnë përqendrimin kryesor të planeve të tilla.
Planet specifike të agjencive	Planet specifike të agjencive janë krijuar për menaxhimin e rreziqeve apo kontigjencave individuale nën fushëveprimin e ministrisë apo agjencisë përgjegjëse.
Dokumenti	Përshkrimi
Shtojcat operative	Shtojcat operative në mënyrë tipike janë plane të hollësishme të lidhura me incidentet apo ngjarjet e veçanta.
Planet regjionale	Planet regjionale në mënyrë tipike janë shtojca operative të planeve qendrore dhe sigurojnë procedura dhe udhëzime specifike për regjionin përkatës.

Planet lokale	Planet lokale të operacioneve emergjente janë të krijuar për adresimin e rreziqeve të ndryshme.
Planet lokale për zvogëlimin e rreziqeve	Planet lokale për zvogëlimin e rreziqeve hartohen nga komunitetet lokale për të siguruar kornizë pune për kuptimin e dobësive dhe shkallës së rrezikshmërisë nga rreziqet e identifikuara dhe për përcaktimin e masave para dhe pas fatkeqësive për zvogëlimin e shkallës së rrezikshmërisë.
Planet e sektorit privat	Planet e sektorit privat krijohen nga kompanitë/operatorët privat. Disa përpjekje planifikuese janë të mandatuara me ligj, derisa të tjerët hartohen për sigurimin e vijimësisë së biznesit të tyre.
Planet e organizatave vullnetare dhe joqeveritare	Planet e organizatave vullnetare dhe joqeveritare janë plane të krijuara për mbështetjen e operacioneve emergjente lokale, regjionale dhe qendrore të parandalimit, reagimit dhe rimëkëmbjes. Ato përfshijnë procesin e vazhdueshëm të llogaritjes, vlerësimit dhe përgatitjes për tu siguruar që autoritetet, organizatat, resurset, koordinimet dhe procedurat operative të nevojshme ekzistojnë, për të siguruar shpërndarje efektive të shërbimeve tek viktimat e fatkeqësisë sikurse edhe për të siguruar integrim në përpjekjet planifikuese në të gjitha nivelet e qeverisjes.
Planet ndërkombëtare	Planet ndërkombëtare midis qeverisë dhe shteteve tjera në mënyrë tipike merren me fatkeqësi natyrore, incidentet me lëndimeve masive, incidentet me ndotje, terrorizmin apo emergjencat e shëndetit publik.
Procedurat	Procedurat sigurojnë udhëzime operative për tu përdor nga ekipet emergjente dhe personeli tjetër i përfshirë në kryerjen apo mbështetjen e operacioneve të menaxhimit të incidenteve.

SHTOJCA 1

Fjalori i termave kryesore

Për qëllime të Planit të Reagimit Kombëtar janë përdorur termet dhe definicionet në vijim:

Agjenci. Entitet qeveritar me funksion të veçantë i cili ofron lloj të caktuar të shërbimit. Në SKI agjencitë janë të përcaktuara si: justiksionale (me përgjegjësi ligjore për menaxhimin e incidentit) apo si asistuese apo mbështetëse (me përgjegjësi për ofrimin e resurseve apo asistencës tjetër).

Armët e Shkatërrimit në Masë (ASHM). (1) çdo mjet plasës, ndezës apo gazë helmues, bombë, granatë, raketë me mbushje shtytëse të më shumë se 110 gramëve, predhë me eksploziv apo mbushje ndezëse të më shumë se 8 gramëve, minë apo mjetë i ngjashëm; (2) çdo armë e destinuar për të shkaktuar vdekje apo lëndime të rënda trupore përmes lirit, shpërndarjes apo efektit të materieve kimike toksike, helmuese apo pararendësve të tyre; (3) çdo armë që përfshinë organizma të sëmurë; apo (4) çdo armë e destinuar për të liruar rrezatim apo radioaktivitet në nivelin e rrezikshëm për jetën e njeriut.

Emergjencë. Çdo ndodhi për të cilën është e nevojshme ndihma qendrore për plotësimin e kapaciteteve dhe përpjekjeve regjionale dhe lokale për shpëtimin e jetëve, mbrojtjen e të mirave materiale dhe shëndetit publik apo për zvogëlimin ose shmangien e rrezikut të katastrofës në çdo pjesë të Republikës së Kosovës.

Ekipi i Menaxhimit të Incidentit (EMI). Komandanti i incidentit dhe personeli përkatës i Stafit të Komandës dhe Stafit të Përgjithshëm i caktuar për një incident.

Ekipi Reagues Kombëtar (ERK). ERK i përbërë prej institucioneve qendrore me përgjegjësi kryesore mjedisore dhe të shëndetit publik, është mjeti parësor për koordinimin e aktiviteteve të agjencive qendrore sipas PKK-së. ERK kujdeset për koordinimin e planifikimit dhe reagimit qendror dhe është kryesues i rrjetit të gjerë të reagimit ndaj rrjedhjeve të vajrave dhe materieve të rrezikshme. MMPH shërben si Kryesues i ERK-së ndërsa AME shërben si Zëvendës Kryesues i ERK-së.

Ekipe Reaguese Regjionale (ERR-të). Ekiye homologe të ERK-së të përbëra nga përfaqësuesit regjional të agjencive qendrore të ERK-së dhe përfaqësuesve të secilës komunë brenda regjionit. ERR-të shërbejnë si trupa për planifikim dhe gatishmëri para reagimit dhe sigurojnë koordinim dhe udhëzime për KVN të nivelit qendror gjatë veprimeve reaguese.

Evakuimi. Largimi apo zhvendosja e organizuar në faza, e civilëve nga zonat me potencial rreziku apo të rrezikshme si dhe pranimi i tyre dhe kujdesi në zona të sigurta.

Funksioni Mbështetës Emergjent (FME). Grupimi i kapaciteteve qeveritare dhe kapaciteteve të caktuara të sektorit privat në një strukturë organizative unike për të ofruar mbështetje, resurse, implementim të programit dhe shërbime që kanë gjasa të nevojiten më së shumti për shpëtimin e jetës, mbrojtjen e të mirave materiale dhe mjedisit, restaurimin e shërbimeve esenciale dhe infrastrukturës kritike dhe për t'i ndihmuar viktimat dhe komunitetet të kthehen në normalitet (kur është e mundur). FME shërben si mekanizëm parësor i nivelit operativ për të ofruar asistencë për qeveritë lokale apo ministritë dhe agjencitë e nivelit qendror që zbatojnë misione të përgjegjësisë parësore qendrore.

Gatishmëria. Aktivitete efektive të menaxhimit emergjent dhe reagimit në incident, të cilat fillojnë me një mori aktiviteteve përgatitore, të kryera në vijimësi shumë herët para çdo incidenti të mundshëm. Gatishmëria përfshinë një kombinim të integruar të vlerësimit, planifikimit, procedurave dhe protokolleve, trajnimeve dhe ushtrimeve, kualifikimit, licencimit dhe certifikimit të personelit, si dhe certifikimit, vlerësimit dhe inspektimit të pajisjeve.

Informimi publik emergjent. Informacione që parimisht shpërndahet në pritje të një emergjence apo gjatë saj. Në plotësim të sigurimit të informacioneve lidhur me situatën, sistematikisht, siguron edhe udhëzime për veprimet që duhet të ndërmerren nga publiku i gjerë në raste emergjente.

Incident katastrofik. Çdo incident natyror apo i shkaktuar nga faktori njeri (përfshirë terrorizmin), i cili rezulton në nivele të jashtëzakonshme të lëndimeve në masë, dëmeve apo çrregullime të mëdha të popullatës, infrastrukturës, mjedisit, ekonomisë, moralit kombëtar apo funksioneve qeveritare. Incidenti katastrofik mund të rezultojë në efekt të gjatë kombëtar për një periudhë kohore të zgjatur, dhe pothuajse menjëherë tejkalon resurset e autoriteteve të nivelit regjional dhe lokal dhe të sektorit privat të zonës së goditur; si dhe pengon dukshëm operacionet qeverisëse dhe shërbimet emergjente në masën e cila mund ta rrezikojë sigurinë kombëtare. Të gjitha Incidentet Katastrofike janë të Karakterit Kombëtar.

Infrastruktura kritike. Sisteme dhe asete (fizike apo virtuale) aq jetike për Republikën e Kosovës sa që mos funksionimi apo shkatërrimi i tyre do të kishin efekt molisës në siguri kombëtare, siguri ekonomike, shëndet apo siguri publike apo në kombinimin e cilës do prej tyre.

Incident. Një ndodhi apo ngjarje natyrore ose e shkaktuar nga faktori njeri e cila kërkon një reagim emergjent për mbrojtjen e jetës apo të mirave materiale. Në incidente mund të përfshihen: fatkeqësitë e mëdha, emergjencat, sulmet terroriste, zjarret urbane dhe malore, vërshimet, rrjedhjet e materieve të rrezikshme, aksidentet nukleare, aksidentet ajrore, tërmetet, shtrëngatat, fatkeqësitë e lidhura me luftën, emergjencat e shëndetit publik dhe ndodhit tjera që kërkojnë reagim emergjent.

Incidentet e karakterit kombëtar. Një ngjarje aktuale apo e mundshme e efektit të lartë goditës e cila kërkon reagim të koordinuar dhe efektiv të entiteteve të sektorit qendror, regjional, lokal, joqeveritar dhe të sektorit privat me qëllim të shpëtimit të jetëve dhe zvogëlimit të dëmeve dhe për të siguruar bazat për aktivitetet e rimëkëmbjes afatgjate të komunitetit.

Infrastruktura. Sisteme, asete, projekte dhe struktura të krijuara nga njeriu, në pronësi publike apo private, që përdoren nga publiku apo që ofrojnë shërbime për publikun. Në shembuj të infrastrukturës përfshihen objektet, urat, digat, sistemet e ujit të pijshëm, sistemet e energjisë elektrike, sistemet kritike, sistemet e komunikimit, sistemet e kanalizimit dhe rrugët.

Incident shumë juridiksional. Një incident i cili kërkon veprime të shumë agjencive prej të cilave secila prej tyre ka juridiksion për menaxhimin e aspekteve të caktuara të një incidenti. sipas SKI-së këto incidente menaxhohen sipas Komandës së Bashkuar.

I Deleguari i Ministrit (IDM). Zyrtar qeveritar i caktuar nga Ministri i Punëve të Brendshme për të vepruar si përfaqësues i tij/saj në nivelin lokal për t'i mbikëqyrë, koordinuar dhe zbatuar përgjegjësitë e Ministrit në menaxhimin e incidentit, për Incidentet e Karakterit Kombëtar.

Juridiksion. Shkallë apo sferë e autoritetit. Agjencitë publike kanë juridiksion në një incident të lidhur me përgjegjësitë dhe autoritetin e tyre ligjor. Autoriteti juridiksional në një incident

mund të jetë politik apo gjeografik (si: kufijtë e qyteteve, komunave, regjioneve apo shteteve) ose funksional (si: zbatimi i ligjit, shëndeti publik).

Komanda Regjionale (Komanda e Bashkuar Regjionale). Një strukturë e ngritur për: (1) të mbikëqyrë menaxhimin e incidenteve të shumëfishta. (2) të mbikëqyrë menaxhimin e incidenteve të mëdha apo të shumëfishta për të cilët janë caktuar disa Ekipte të Menaxhimit të Incidentit. Komanda Regjionale ka përgjegjësi për vendosjen e prioriteteve dhe strategjisë së përgjithshme, të siguroj që incidentet menaxhohen si duhet dhe të siguroj arritjen e objektivave dhe ndjekjen e strategjive. Komanda Regjionale bëhet Komandë e Bashkuar Regjionale atëherë kur incidentet janë shumë juridiksionale. Komanda regjionale mund të ngritet në hapësirat e QOE apo në hapësira të ngjashme ndryshe nga PKI.

Kapaciteti transportues civil. Tërësia e përgjithshme e shërbimeve, pajisjeve, objekteve dhe sistemeve të të gjitha mënyrave në pronësi private.

Kërcënim i besueshëm. Kërcënim i mundshëm terrorist i cili në bazë të vlerësimit të rrezikut është i besueshëm dhe ka gjasa të përfshijë ASHM-të.

Kibernetikë. Lidhjet me kompjuterët dhe sistemet e tyre mbështetëse siç janë “serverët”, “ruterët” dhe “suiqet” të cilët mbështesin infrastrukturën kritike.

Koordinatori Qendror në Vendngjarje (KQVN ose KVN). Zyrtar qendror i përfaqësuar nga MMPH për koordinimin e reagimeve sipas PKK, apo zyrtar qeveritar i caktuar për koordinim dhe drejtim të veprimeve të zhvendosjes së vajrave dhe materieve të rrezikshme sipas PKK.

Koordinatori i Resurseve Qendrore (KRQ). Zyrtar qeveritar i caktuar për menaxhimin e aktiviteteve mbështetëse të resurseve qendrore. KRQ është përgjegjës për koordinimin e mbështetjes nga ministritë dhe agjencitë tjera me përdorimin e marrëveshjeve ndërinstitucionale dhe marrëveshjeve të mirëkuptimit.

Komandanti i Incidentit (KI). Person përgjegjës për të gjitha aktivitetet në incident, përfshirë zhvillimin e strategjive dhe taktikave si dhe porositjen dhe lirimimin e resurseve. KI ka përgjegjësinë dhe autoritetin e plotë për zhvillimin e operacioneve në incident dhe është përgjegjës për menaxhimin e të gjitha operacioneve në vendin e ngjarjes.

Kërcënim. Një indikacion i dhunës, dëmit apo rrezikut.

Komanda e bashkuar. Një formë e SKI-së e përdorur në rastet kur ekzistojnë më shumë se një agjenci me juridiksion në incident apo kur incidentet kalojnë juridiksionet politike.

Kërkimi dhe shpëtimi urban. Aktivitete operative të cilat përfshijnë gjetjen, nxjerrjen dhe trajtimin në vendngjarje të viktimave të ngujuara në strukturat e rrënuara.

Mbështetja e Forcës së Sigurisë për Autoritetet Civile (MFSAC). I referohet mbështetjes së MFSK-së, forcave të sigurisë, personelit kontraktues të MFSK-së, strukturave dhe komponentëve të MFSK-së për emergjencat vendore dhe për aktivitetet tjera të zbatimit të ligjit.

Materie e rrezikshme. Çdo materie në gjendje të ngurtë, të gaztë apo të lëngët, e cila me rrjedhje të pakontrolluar në mjedis paraqet rrezik të pashmangshëm për jetën apo shëndetin e njerëzve dhe kafshëve apo shkakton çrregullim ose dëmtim të të mirave materiale dhe ndikon dëmshëm në mjedis. Në materie të rrezikshme hyjnë helmet, kancerogjenet, kaustikët, oksidet dhe ngacmuesit

(irrituesit), radioaktivët, infektuesit, eksplozuesit, materiet ndezëse ose materiet që shkaktojnë ndezje në kontakt me substanca tjera.

Mobilizimi. Procesi dhe procedurat e përdorura nga të gjitha strukturat (qendrore, regjionale dhe lokale) për aktivizimin, grumbullimin dhe transportimin e të gjitha resurseve të cilat janë kërkuar për të reaguar ndaj një incidenti apo për ta mbështetur atë.

Ndërlidhësi për infrastrukturë. Ndërlidhësi për Infrastrukturë (i caktuar nga MPB-ja), shërben si këshilltar kryesor i Grupit Koordinues të QBF për të gjitha çështjet e lidhura me infrastrukturën dhe resurset kritike kombëtare, të nivelit qendror dhe regjional.

Përfaqësues i agjencisë. Person i caktuar nga agjencia qeveritare e nivelit lokal, regjional apo qendror ose entiteti privat të cilit i është deleguar autoriteti për të marr vendime (duke ndjekur konsultimet e nevojshme me liderhipin), në emër të agjencisë pjesëmarrëse në aktivitetet e menaxhimit të incidentit.

Pasqyra e Përbashkët Operative (PPO). Këndvështrim i gjerë i situatës e cila pasqyrohet nëpërmjet raporteve të situatës, fotografive nga ajri apo nga burimet tjera të informacionit.

Plani Operativ Emergjent (POE). Plan “i gatishmërisë së lartë” i mirëmbajtur nga nivelet e ndryshme juridiksionale për menaxhimin e rreziqeve të ndryshme të mundshme.

Plani veprues për incidentin. Një plan gojor apo i shkruar i cili përmban në vete objektivat e përgjithshme, të cilat reflektojnë strategjinë e përgjithshme për menaxhimin e incidentit. Mund të përfshijë përcaktimin e detyrave dhe resurseve operative. Gjithashtu mund të përfshijë shtojcat të cilat ofrojnë drejtim dhe informacione të rëndësishme për menaxhimin e incidentit, gjatë një apo më shumë periudhave operative.

Post Komanda e Incidentit (PKI). Lokacion fushor në të cilin kryhen funksionet parësore të nivelit taktik të komandimit në vendngjarje. PKI mund të bashkëvendoset me bazën e incidentit apo objektet tjera të incidentit dhe normalisht identifikohet nëpërmjet simboleve të dukshme.

Parandalimi. Veprime të ndërmarra për shmangien e një incidenti apo ndërhyrje për ta penguar ndodhjen e tij. Parandalimi përfshinë veprimet e ndërmarra për mbrojtjen e jetës dhe të mirave materiale. Përfshinë aplikimin e informacioneve të zakonshme dhe inteligjente në morinë e aktiviteteve të cilat mund të përfshijnë kundërmasat si: operacionet e përmbajtjes; inspektimet e shtuara; operacionet e sigurisë dhe mbikëqyrjes së përmirësuar; hetimet për përcaktimin e natyrës dhe burimit të kërcënimit; mbikëqyrjen e shëndetit publik dhe bujqësor dhe proceset e testimi; imunizimet, izolimet apo karantinën; dhe sipas nevojës, operacionet e veçanta të zbatimit të ligjit të destinuar për pengimin, kapjen, ndalimin apo çrregullimin e aktiviteteve ilegale dhe kapjen e autorëve të mundshëm kriminal dhe dërgimin e tyre para organeve të drejtësisë.

Punët publike. Punët, objektet fizike dhe shërbimet e ofruara nga qeveritë, në dobi të publikut dhe për përdorim nga të njëjtit.

Plani strategjik. Plan i cili adreson çështjet afatgjata siç janë efektet e parashikimeve të motit, kërkesat e afatizuara të resurseve dhe problemet si: strehimi i përkohshëm për viktimat e zhvendosura si pasojë e fatkeqësisë, ndotjet mjedisore dhe restaurimi i infrastrukturës.

Qendra për Rimëkëmbje nga Fatkeqësia (QRF). Hapësirë e ngritur në vend të centralizuar, brenda apo afër zonës së fatkeqësisë në të cilën viktimat e fatkeqësisë (individët, familjet apo bizneset), aplikojnë për ndihmë në fatkeqësi.

Qendra Operative Emergjente (QOE). Lokacion fizik në të cilin zhvillohet koordinimi i informacioneve dhe resurseve për mbështetjen e aktiviteteve të menaxhimit të incidentit. QOE mund të jetë hapësirë e përkohshme ose mund të vendoset në objekt të përhershëm qendror, zakonisht në nivelin më të lartë organizativ në juridiksion. QOE-të mund të organizohen sipas disiplinave kryesore funksionale (si: zjarrfikja, zbatimi i ligjit dhe shërbimet mjekësore), sipas juridiksionit (si: qendror, regjional, lokal), apo sipas kombinimit të formave të sipër përmendura.

Qendror. Entitet i Qeverisë Qendrore të Republikës së Kosovës.

Qendra e Bashkuar Fushore (QBF). Hapësirë e përkohshme qendrore e ngritur në rrafshin lokal për të siguruar pikë qendrore për ekzekutivët e nivelit qendror, regjional dhe lokal që mbajnë përgjegjësi të mbikëqyrjes, drejtimit dhe/apo ndihmës për t'i koordinuar më me efektivitet aktivitetet e mbrojtjes, parandalimit, gatishmërisë, reagimit dhe rimëkëmbjes nga incidenti.

Qendra e Informimit të Përbashkët (QIP). Hapësirë e ngritur për koordinimin e të gjitha aktiviteteve të lidhura me informimin publik. Është pikë qendrore e kontaktit për të gjitha mediet në vendin e ngjarjes së një incidenti. Zyrtarët e informimit publik të të gjitha agjencive pjesëmarrëse duhet të bashkë-vendosen në QIP.

Qendra e Bashkuar Operative (QBO). Është pikë qendrore për të gjitha aktivitetet qendrore hetimore të zbatimit të ligjit gjatë incidenteve aktuale apo të mundshme terroriste apo gjatë çdo incidenti kriminal dhe menaxhohet nga ZLQ i Zbatimit të Ligjit. QBO bëhet komponent e QBF me rastin e aktivizimit të PRK.

Qeveria Lokale bazohet në parimet e Qeverisjes së mirë, transparencës, efikasitetit dhe efektivitetit në ofrimin e shërbimeve publike, duke u kushtuar kujdes të gjithë qytetarëve që jetojnë në territorin e komunës. Qeverisja lokale në Republikën e Kosovës është e organizuar në sistemin njëshkallësh, ku Komuna përcaktohet si njësi themelore e vetëqeverisjes lokale, e përbërë nga një komunitet i qytetarëve në një territor të caktuar, të përcaktuar me ligj, e cila ushtron tërë pushtetin i cili nuk është i rezervuar shprehimisht për institucionet qendrore.

Qendër e Mobilizimit. Një hapësirë e përkohshme në të cilën personeli reagues dhe pajisjet pranohen dhe para-pozicionohen për dislokim në një bazë logjistike të një incidenti, në një pikë grumbullimi apo drejtpërsëdrejti në një incident, sipas nevojës. Qendra e mobilizimit gjithashtu ofron shërbime të përkohshme mbështetëse siç janë: ushqimi dhe strehimi për personelin reagues në pritje të caktimit të detyrës, lirimit apo ricaktimit të detyrës, si dhe shërben si vend për realizimin e procesit të demobilizimit.

Qendra e Reagimit Kombëtar. Qendër kombëtare e komunikimit për aktivitetet e lidhura me veprimet ndaj vajrave dhe materieve të rrezikshme. E vendosur në zyrat qendrore të MMPH-së pranon dhe dërgon njoftimet lidhur me rrjedhjet e vajrave dhe materieve të rrezikshme tek KVN përkatës Qendror.

Resurse në Dispozicion. Resurse të caktuara për një incident, të kontrolluara në hyrje, të gatshme për tu përdor, zakonisht të vendosura në Pikën e Grumbullimit.

Reagimi. Aktivitete të cilat adresojnë efektet afatshkurta të drejtpërdrejta të një incidenti. Reagimi përfshinë veprimet e menjëhershme për shpëtimin e jetëve, mbrojtjen e të mirave materiale dhe për plotësimin e nevojave elementare njerëzore. Reagimi gjithashtu përfshinë zbatimin e planeve operative emergjente dhe aktiviteteve të zbutjes jashtë incidentit, të destinuara për kufizimin e humbjeve në jetë, lëndimeve personale, dëmeve në të mira materiale dhe pasojave tjera të pafavorshme. Sipas diktimit të situatës, aktivitetet reaguese përfshijnë: aplikimin e informacioneve inteligjente dhe të tjera për pakësimin e efekteve apo pasojave të një incidenti; shtimin e operacioneve të sigurisë; vazhdimin e hetimeve të natyrës dhe burimit të kërcënimit; mbikëqyrjen e vijueshme të shëndetit publik dhe bujqësor, si dhe proceseve testuese; imunizimin, izolimin apo karantinën; dhe operacionet e posaçme të zbatimit të ligjit të destinuara për pengimin, ndalimin apo përçarjen e aktiviteteve ilegale dhe kapjen e aktorëve të krimin si dhe vënien e tyre para organeve të drejtësisë.

Rimëkëmbja e komunitetit. Proces i vlerësimit të efekteve të një Incidenti të Karakterit Kombëtar (në kontekstin e PRK-së), i cili përcakton resurset, ndërton dhe zbaton kursin e veprimit për rivendosjen dhe rivitalizimin e strukturës socio-ekonomike dhe fizike të komunitetit.

Reagues i parë. Personel lokal qeveritar dhe joqeveritar i policisë, zjarrfikjes dhe emergjencave të cilët në fazat e hershme të një incidenti janë përgjegjës për mbrojtjen dhe ruajtjen e jetës, të mirave materiale, provave dhe mjedisit, përfshirë personelin e menaxhimit emergjent, shëndetit publik, kujdesit spitalor, punëve publike dhe personelin tjetër me përvojë, të cilët ofrojnë shërbime të menjëhershme mbështetëse gjatë operacioneve të parandalimit, reagimit dhe rimëkëmbjes. Në reaguesit e parë mund të përfshihet personeli i strukturave qendrore, regjionale, lokale apo i atyre joqeveritare.

Reagimi fillestar. Resurset e para të zotuarat për një incident.

Rimëkëmbja. Hartimi, koordinimi dhe zbatimi i planeve të restaurimit të vendit dhe shërbimeve për komunitetet e goditura dhe rivendosjen e operacioneve dhe shërbimeve të qeverisjes nëpërmjet programeve të asistencës individuale, të sektorit privat, asaj joqeveritare dhe të sektorit publik të cilët: identifikojnë nevojat dhe përcaktojnë resurset; sigurojnë strehim dhe mbështesin restaurimin; adresojnë kujdesin dhe trajtimin afatgjatë të personave të goditur; zbatojnë masa shtesë për rimëkëmbjen e komuniteteve; inkorporojnë masat dhe teknikat e zbutjes; vlerësojnë incidentet për t'i identifikuar mësimet e mësuara; dhe zhvillojnë iniciativa për zbutjen e efekteve të incidenteve të ardhshme.

Resurset. Personeli dhe gjërat kryesore të pajisjeve, furnizimeve dhe shërbimeve të gatshme apo me mundësi gatishmërie për tu ngarkuar me detyrë në operacionet e incidentit dhe për të cilat bëhet përcjellja e gjendjes së gatishmërisë. Resurset përcaktohen sipas llojit dhe tipit dhe mund të përdoren në mbështetje operative apo kapacitete mbikëqyrëse në një incident apo në një QOE.

Rrezik. Diçka që ka potencial rreziku apo dëmtimi, në të shumtën e rasteve shkaktar i pasojave të padëshirueshme.

Strategjik. Elementet strategjike të menaxhmentit të incidentit karakterizohen nga planifikimi i vazhdueshëm, afatgjatë dhe i nivelit të lartë i organizatave të udhëhequra nga zyrtarët e zgjedhur apo zyrtarë tjerë të lartë. Këto elemente përfshijnë përshtatjen e qëllimeve dhe objektivave afatgjata, vendosjen e prioriteteve, zhvillimin e politikave dhe aplikimin e masave të performancës apo efektivitetit.

Stafi i komandës. Në një strukturë të menaxhimit të incidentit, stafi i komandës konsiston nga Komandanti i Incidentit dhe pozitat e stafit special të Zyrtarit për Informim Publik, Zyrtarit për Siguri, Zyrtarit Ndërlidhës dhe pozitave tjera sipas nevojës, të cilët raportojnë drejtpërsëdrejti tek Komandanti i Incidentit.

Sistemi i Komandës së Incidentit (SKI). Sistem menaxhues i përdorur gjerësisht, i dizajnuar për të mundësuar menaxhim efektiv dhe efikas të incidentit duke integruar kombinimin e shërbimeve, pajisjeve, personelit, procedurave dhe komunikimit që operojnë brenda strukturës së përbashkët organizative. SKI është formë themelore e menaxhmentit e krijuar në model standard, me qëllimin e përkrahjes së menaxherëve të incidentit, që të identifikojnë çështjet kryesore të lidhura për incidentin (në të shumtën e rasteve nën rrethana urgjente), pa sakrifikuar vëmendjen e cilës do komponentë të sistemit të komandës. SKI përdoret për organizimin e operacioneve në vendngjarje për spektrin e gjerë të emergjencave nga incidentet e vogla deri tek ato komplekse, natyrore dhe të shkaktuara nga faktori njeri.

Sistemi i Integruar i Menaxhimit Emergjent (SIME). Sistem i cili siguron qasje sistematike, pro-aktive për udhëzimin e ministrive dhe agjencive të të gjitha niveleve të qeverisjes, organizatave joqeveritare dhe sektorit privat për të punuar bashkërisht dhe me vëmendje, të përqendruar në fushën e parandalimit, mbrojtjes, reagimit, rimëkëmbjes dhe zbutjes së efekteve të incidenteve, pa marrë parasysh shkakun, madhësinë, vendndodhjen apo kompleksitetin e tyre, me qëllim të zvogëlimit të humbjeve në jetë dhe të mira materiale, si dhe efekteve të dëmshme në mjedis.

Sistemi i Informimit të Përbashkët (SIP). Integron informacionet e incidentit dhe marrëdhëniet publike në një strukturë të bashkuar të destinuar për të ofruar informacione me kohë, të qëndrueshme dhe të koordinuara gjatë krizave apo operacioneve në incident. Misioni i SIP-it është të ofroj strukturë dhe sistem për përpilimin dhe shpërndarjen e mesazheve të koordinuara ndër-institucionale; zhvillimin, rekomandimin dhe zbatimin e planeve dhe strategjive të informimit publik në emër të KI; këshillimin e KI-së lidhur me çështjet e marrëdhënieve me publikun të cilat do mund të kishin efekt në përpjekjet reaguese; dhe kontrollimin e thashethemeve dhe informacioneve të pasakta të cilat do të luhatin besimin e publikut ndaj përpjekjeve të reagimit emergjent.

Sektori privat. Organizatat dhe entitetet të cilat nuk janë pjesë e asnjë strukture qeveritare. Përfshinë organizatat fitimprurëse dhe jo fitimprurëse, strukturat formale dhe informale, industrinë dhe tregtinë, organizatat private të reagimit emergjent dhe organizatat vullnetare private.

Shëndeti publik. Mbrojtja, siguria, përmirësimi dhe ndërlidhja e shëndetit dhe parandalimit të sëmundjeve midis njerëzve, kafshëve shtëpiake dhe atyre të egra.

Trashëgimi kulturore. Ndërtesat dhe pjesët e ndërtesave, anekset, ngastrat e tokës, vendbanimet, vegetacioni dhe format tjera natyrore të krijuara nga njeriu, objektet kulturore dhe historike (objektet e palëvizshme të trashëgimisë kulturore), objektet lëvizëse dhe koleksionet e gjësendeve me vlera kulturore për shtetin (objekte të lëvizshme të trashëgimisë kulturore).

Terrorizmi. Çdo aktivitet i cili: (1) përfshinë një akt i cili: (a) është i rrezikshëm për jetën e njeriut apo ka potencial të shkatërrimit të infrastrukturës kritike ose resurseve kryesore; dhe (b) është shkelje e ligjeve të Republikës së Kosovës; dhe (2) del i qëllimshëm (a) në trembjen apo frikësimin e popullatës civile; (b) në influencimin e politikave të shtetit nëpërmjet trembjes apo

frikësimit; apo (c) në aspektin e të ndikuarit në mënyrën e drejtimit të qeverisë nëpërmjet çorientimit, vrasjeve apo kidnapimeve në masë.

Viktimë. Çdo person i cili është shpallur i vdekur apo i humbur, i sëmur apo i lënduar.

Vullnetar. Çdo person i pranueshëm për të kryer shërbime nga një agjenci e cila ka autoritetin për të pranuar shërbime të vullnetarëve, ku vullnetari i caktuar kryen shërbime pa premtim, pritje apo pranim të kompensimit për shërbimet e kryera.

Zinxhiri komandues. Seria e pozitive të komandimit, kontrollit, ekzekutivit apo menaxhimit, sipas rendit hierarkik të autoritetit.

Veprimet fillestare. Veprimet e ndërmarra nga ata që arrijnë të parët në vendin e incidentit.

Vlerësimi i situatës. Vlerësimi dhe interpretimi e informacioneve të grumbulluara nga burimet e ndryshme (përfshirë informacionet dhe parashikimet e motit, modelet kompjuteristike, të dhënat e GIS-it, etj.), të cilat kur komunikohen tek menaxherët emergjent dhe vendimmarrësit, mund të sigurojnë bazamentin për vendimmarrje nga menaxhmenti i incidentit.

Zyrtari Koordinator Qendror (ZKQ). Zyrtar qeveritar i cili caktohet për t'i menaxhuar aktivitetet mbështetëse të resurseve qendrore. ZKQ është përgjegjës për koordinimin e shpërndarjes koherente të resurseve dhe programeve të asistencës qendrore për, pushtetin lokal të goditur, viktimat individuale dhe për sektorin privat.

Zyrtar i Lartë Qendror (ZLQ). Person i cili përfaqëson ministrinë apo agjencinë qendrore me përgjegjësi parësore juridike të menaxhimit të incidentit. ZLQ-të përdorin autorizimet, përvojën dhe kapacitetin ekzistues për të ndihmuar në menaxhimin e incidentit duke punuar në koordinim me pjesëtarët tjerë të grupit Koordinator të QBF-së.

Zvogëlimi i rrezikut. Çdo masë e kostos së arsyeshme e cila do të zvogëlonte dëmtimin e objektit nga ngjarja fatkeqe.

Zbutja e incidentit. Veprime të ndërmarra gjatë një incidenti, të destinuara për zvogëlimin e efekteve apo përmbajtjen e dëmeve ndaj të mirave materiale apo mjedisit.

Zyrtari ndërlidhës. Pjesëtar i Stafit të Komandës për koordinim me përfaqësuesit e agjencive bashkëpunuese dhe mbështetëse.

Zyrtari për Informim Publik (ZIP). Pjesëtar i Stafit të Komandës përgjegjës për ndërveprim me publikun dhe mediet apo me agjencitë tjera me kërkesa për informacione të lidhura me incidentin.

Zbutja. Aktivitete të destinuara për zvogëlimin, eliminimin e rreziqeve ndaj personave apo të mirave materiale apo për zvogëlimin e efekteve, pasojave aktuale ose të mundshme të një incidenti. Masat zbutëse mund të zbatohen në prag, gjatë dhe pas një incidenti. Në të shumtën e rasteve zhvillohen në raport me mësimet e mësuara nga incidentet e kaluara. Në këto masa mund të përfshihen normat e zonimit dhe ndërtimit. Zbutja mund të përfshijë përpjekjet për edukimin e qeverive, bizneseve dhe publikut lidhur me masat që ata mund t'i ndërmarrin për zvogëlimin e humbjeve dhe lëndimeve të mundshme.

SHTOJCA 2

Lista e Shkurtesave

AME	Agjencia e Menaxhimit Emergjent
AIMI	Analizimi i Informacioneve edhe Mbrojtja e Infrastrukturës
ASHM	Armët e Shkatërrimit në Masë
DIA	Drejtoria për Inteligjencë dhe Analizë
EKNI	Entitet Koordinues Ndërinstitucional
EME	Ekipi Mbështetës Emergjent
EMI	Ekipi i Menaxhimit të Incidentit
ERK	Ekipi Reagues Kombëtar
ERE-A	Ekipi Reagues Emergjent—Elementi Avancues
ERE-Q	Ekipi Reagues Emergjent Qendror
EREK	Ekipi Reagues Emergjent i Komunitetit
ERR	Ekipi Reagues Regjional
FME	Funksion Mbështetës Emergjent
FNFT	Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera
GNMI	Grupi Ndërinstitucional për Menaxhimin e Incidentit
IDM	I Deleguari i Ministrit
IK/RK	Infrastruktura Kritike/Resurset Kryesore
KDRNI	Komiteti Drejtues Regjional Ndërinstitucional
KI	Komandanti i Incidentit
IHMK	Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës
KKP	Komiteti për Koordinimin e Politikave
KRQ	Koordinatori i Resurseve Qendrore
KSK	Këshilli i Sigurisë së Kosovës
KVN	Koordinatori në Vendngjarje
KSHU	Kërkimi dhe Shpëtimi Urban
KSH	Kërkimi dhe Shpëtimi
KKK	Kryqi i Kuq i Kosovës
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
MEF	Ministria e Ekonomisë dhe Financave
MFSK	Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës
MEM	Ministria e Energjisë dhe Minierave
MD	Ministria e Drejtësisë
MPMS	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
MPJ	Ministria e Punëve të Jashtme
MTT	Ministria e Transportit dhe Telekomunikacionit
MMPH	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
MAP	Ministria e Administratës Publike
MSH	Ministria e Shëndetësisë
MBPZHR	Ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe e Zhvillimit Rural
MFSAC	Mbështetja e Forcës së Sigurisë për Autoritetet Civile
MPO	Mjedis i Përkohshëm Operativ
MEM	Marrëveshje e Mirëkuptimit
NVSK	Ngjarje Veçantë e Sigurisë Kombëtare
NjXHFSK	Njësia e Xhenios e Forcës së Sigurisë së Kosovës
OJQ	Organizatë Jo Qeveritare

OVAF	Organizatat Vullnetare Aktive në Fatkeqësi
PK	Policia e Kosovës
PSO	Procedura Standarde Operative
PKR	Plani Kontingjent Regjional
PK	Pikë Kontakti
PRK	Plani i Reagimit Kombëtar
PKK	Plani Kontingjent Kombëtar
PAIKK	Përfaqësuesi i Autorizuar i Kryetarit të Komunës
PKU	Programi Kombëtar i Ushtrimeve
PKI	Post Komanda e Incidentit
QRF	Qendra e Rimëkëmbjes nga Fatkeqësia
QM	Qendra e Mobilizimit
QBF	Qendra e Bashkuar Fushore
QIP	Qendra e Informimit të Përbashkët
QBO	Qendra e Bashkuar Operative
QSMFSK	Qendra e Situatave e Ministrisë së Forcës së Sigurisë së Kosovës Qendra e
QSKSK	Situatave e Këshillit të Sigurisë së Kosovës
QOAME	Qendra Operative e Agjencisë së Menaxhimit Emergjent
QOMP	Qendra Operative e Ministrisë së Punëve të Brendshme
QOPK	Qendra Operative e Policisë së Kosovës
QSFSK	Qendra Operative e Forcës së Sigurisë së Kosovës
QOE	Qendra Operative Emergjente
QOER	Qendra Operative Emergjente Regjionale
SAE	Sistemi i Alarmimit Emergjent
SIGJ	Sistemi Informativ Gjeografik
SKI	Sistemi i Komandës së Incidentit
SIP	Sistemi Informativ i Përbashkët
SKK	Sistemi Kombëtar i Komunikimit
SIME	Sistemi i Integruar i Menaxhimit Emergjent
UA	Udhëzim Administrativ
VPD	Vlerësimi Preliminar i Dëmeve
ZKFSK	Zyrtari për Koordinim të Forcës së Sigurisë së Kosovës
ZKQ	Zyrtari Koordinues Qendror
ZQ	Zyrë Qendrore
ZNT	Zyrtari i Ngarkuar në Terren
ZKK	Zyrtari Koordinues Komunal
ZLQZL	Zyrtar i Lartë Qendror i Zbatimit të Ligjit
ZLQ	Zyrtar i Lartë Qendror
ZMJI	Zyrtari për Marrëdhënie me Jashtë Incidentit

SHTOJCA 3

Autoritetet dhe Referencat

Autoriteti kryesor që drejton strukturimin, zhvillimin dhe implementimin e PRK-së është vendimi i Kryeministrit të Republikës së Kosovës Nr. 685/10 për themelimin e sistemit të integruar të Menaxhimit të Emergjencave në Kosovë dhe hartimin e Planit të Reagimit Kombëtar. Midis shumicës së ligjeve, urdhrave dhe udhëzimeve relevante për PRK janë ato të përmbledhura në vijim.

Korniza ligjore dhe instrumentet ndërkombëtare

1. Kushtetuta e Republikës së Kosovës
2. Ligji për Fatkeqësi Natyrore dhe Fatkeqësi tjera Nr.2006/02/L-68;
3. Ligji për themelimin e Këshillit të Sigurisë së Kosovës Nr.2008/03-L050;
4. Ligji për Mbrojtje nga Zjarri Nr.2006/02-L41;
5. Projektligji për Zjarrfikje dhe Shpëtim
6. Ligji për Menaxhimin e Financave Publike dhe Pergjegjësit Nr.2008/03-L048;
7. ligji për Rezervat Shtetërore të Mallrave;
8. Ligji për Ministrinë për Forcën e Sigurisë së Kosovës Nr.2008/03-L045;
9. Ligji për Policinë Nr. 03/L-035;
10. Ligji për Telekomunikacionin Nr.2002/7;
11. Ligji për Transportin Rrugor Nr. 2004/1;
12. Ligji për Shendetësi Publike Nr. 02/L-78;
13. Ligji për Kujdesin Shendetësor Emergjent Nr.2006/02-L50;
14. ligji për Mbrojtjen e Ambientit;
15. Ligji për Kryqin e Kuq të Kosovës Nr.03/L-179
16. Ligji për Plotësim Ndryshimin e Kodit Penal të Kosovës Nr.2008/03-L-002;
17. Ligji për Plotësim ndryshimin e Kodit të Procedurës Penale të Kosovës Nr.2008/03-L-002;
18. Ligji për Procedurën Kontestimore Nr.03/L-006;
19. Ligji për Procedurën Jokontestimore Nr.03/L-007;
20. Ligji për Ndërrmarjet Publike Nr.2008/03-L087;
21. Ligji për vetëqeverisje lokale Nr.2008/03-L040;
22. ligji për Financat e Pushtetit Lokal;
23. Ligji për Kufijt Administrativ Komunal;
24. Udhëzim Administrativ për kriteret e themelimit dhe organizimit të shërbimit zjarrfikës dhe shpëtimit në Kosovë Nr.05/2007;
25. Udhëzim Administrativ për Metodologjinë e hartimit të vlersimit të rrezikut dhe planeve për mbrojtje dhe shpëtim Nr.19.2008;
26. Udhëzim Administrativ për themelimin e këshillit për sigurinë në komunikacionin rrugor Nr.18/2008;
27. Vendimi për Themelimin e Sistemit të Inegruar të Menaxhimit Emergjent

SHTOJCA 4

Përshkrimi i përfshirjes fillestare qendrore


Ky vështrim ilustron veprimet që ka të ngjar t'i ndërmarrin institucionet qendrore për mbështetjen e regjioneve dhe qeverive lokale që janë të mbingarkuara nga fatkeqësia apo emergjenca e madhe. Në elementet kryesore operative që do të mund të aktivizoheshin përfshihen Grupi Ndërinstitucional për Menaxhimin e Incidenteve (GNMI), Qendra Operative e Agjencionit të Menaxhimit Emergjent (QOAME), Qendrat Operative Emergjente Regjionale të AME-së (QOER), Ekipi i Reagimit Emergjent – elementi avancues (ERE-A), Ekipi Qendror i Reagimit Emergjent (ERE-Q), Qendra e Bashkuar Fushore (QBF) dhe Qendra e Rimëkëmbjes nga Fatkeqësitë (QRF).

1. Qendra Operative e Ministrisë së Punëve të Brendshme (QO e MPB-së) monitoron vazhdimisht fatkeqësitë dhe emergjencat e mëdha të mundshme. Kur paralajmërimi i hershëm është i mundur, MPB-ja mund të dislokoj dhe mund të kërkoj nga agjencitë tjera qendrore për të dislokuar zyrtar ndërlidhës dhe personel tek Qendra Operative Emergjente Lokale apo Regjionale për ta vlerësuar situatën emergjente. Një QOER mund të aktivizohet, plotësisht apo pjesërisht. Objektet përcjellëse siç janë qendrat mobilizuese mund të themelohen për akomodimin e personelit, pajisjeve dhe furnizimeve.
2. Menjëherë pas një incidenti, autoritetet lokale reagojnë duke përdorur resurset në dispozicion dhe njoftojnë elementet reaguese regjionale. Ata e paraqesin dhe e vlerësojnë situatën dhe nevojat për ndihmë qendrore. Regjioni e rishikon situatën, i mobilizon resurset regjionale dhe e informon Zyrën Qendrore të MPB/AME për planin e veprimit. Kryetari i komunës aktivizon planet komunale të operacioneve emergjente, deklaron apo shpall emergjencën dhe kërkon vlerësimin e përbashkët (Komunë/MPB) të dëmeve fillestare për të përcaktuar shkallën e incidentit. Bazuar në rezultatet e këtij vlerësimi Kryetari i komunës mund të kërkoj dhe përcaktoj llojin e ndihmës së nevojshme qendrore.
3. Pas përcaktimit të shkallës së incidentit QOER, e plotësuar me personel regjional, koordinon aktivitetet fillestare regjionale dhe fushore, siç janë dislokimi i një ERE-A. ERE-A vlerëson efektin goditës të ngjarjes, llogaritë nevojat imediate komunale dhe bënë aranzhimet preliminare për vendosjen e hapësirave për operacione fushore. (Nëse ndodh që resurset regjionale të mbingarkohen apo nëse ngjarja ka pasoja të mundshme domethënëse MPB-ja mund të dislokoj një ERE-Q).
4. Varësisht nga gjerësia dhe efekti goditës i ngjarjes QOAME e përbërë nga përfaqësuesit e Funksioneve Mbështetëse Emergjente (FME) dhe personeli mbështetës i AME/MPB kujdeset për aktivizimin fillestar dhe operacionet e misioneve të ngarkuara dhe mbështet QOAME.
5. Zyrtari Koordinues Qendror (ZKQ), i caktuar nga ministri i Punëve të Brendshme në emër të kryeministrit, koordinon aktivitetet mbështetëse Qendrore. ZKQ punon me Zyrtarin Koordinues Komunal (ZKK) për t'i përcaktuar nevojat. Gjithashtu, mund të caktohet një Zyrtar i Autorizuar Qendror (IDM) si përfaqësues i ministrit të Punëve të Brendshme për t'i koordinuar përpjekjet e gjithëmbarshme qendrore të menaxhimit të incidentit.
6. ERE punon me komunën e goditur dhe zhvillon operacione fushore nga QBF-ja. Agjencionet parësore të FME-ve e vlerësojnë situatën dhe përcaktojnë nevojat dhe

ndihmojnë komunën të reagoj në mënyrë efektive. Agjencitë qendrore sigurojnë resurset sipas misioneve të caktuara nga MPB/AME apo autoriteti tjetër i tyre.

7. GNMI mblidhet kur nevojitet për të siguruar koordinim të nivelit strategjik të kursit të veprimeve që kanë të bëjnë me çështjet e ndryshme operative dhe linjat e veprimit. QOMPB-së e mbështet GNMI-në dhe koordinon me QBF-në.
8. Operatorët telefonik aktivizojnë numrin falas të telefonit ku individët mund të aplikojnë për ndihmë. Kjo lidhje vendoset për tu përgjigjur në pyetjet e zakonshme lidhur me ndihmat, udhëzimet dhe këshillat për asistencë. Aplikacionet individuale përpunohen në Zyrat Qendrore të MPB-së. Inspektorët verifikojnë humbjet dhe sigurojnë dokumentacionin që përdoret për përcaktimin e llojit të ndihmës e cila duhet siguruar për individ dhe familje.
9. Me rastin e përmbushjes së prioriteteve të reagimit fillojnë aktivitetet e rimëkëmbjes. Agjencionet qendrore dhe komunale që ndihmojnë në aktivitetet e rimëkëmbjes dhe zbutjes së pasojave mblidhen për t'i diskutuar nevojat e komunës.
10. Brifingjet për aplikuesit e ndihmës publike zhvillohen për zyrtarët e pushtetit lokal dhe organizatave të caktuara private joprofitabile për t'i informuar ata lidhur me ndihmën në dispozicion dhe mënyrën se si duhet aplikuar.
11. Gjatë reagimit dhe rimëkëmbjes, stafi parandalues në QBF analizon mënyrat për rritjen deri në maksimum të masave për zvogëlimin e rreziqeve, gjithmonë në përputhje me planet ekzistuese komunale.
12. Ashtu siç përfundon nevoja për koordinim ndërinstitucional në QBF, edhe ERE planifikon për shkarkimin, demobilizimin dhe lirim selektiv të resurseve qendrore. Pastaj agjencionet qendrore veprojnë me grantet e tyre drejtpërsëdrejti nga zyrat regjionale apo qendrore të tyre për administrimin dhe monitorimin e programeve individuale të rimëkëmbjes, mbështetjes dhe shërbimeve teknike.

Fig. 6. Pasqyra e përfshirjes fillestare qendrore



SHTOJCA 5


Përshkrimi i mbështetjes brenda-qeveritare

Kjo pasqyrë ilustron veprimet që ka gjasa t'i ndërmarrin MPB-ja dhe agjencitë qendrore për mbështetjen e ministrisë apo agjencisë qendrore (e cila ka kërkuar ndihmë të MPB-së) për tu ballafaquar si duhet me një incident nën juridiksionin e saj. Në elementet kryesore operacionale të cilët do të mund të aktivizoheshin përfshihen Grupi Ndërinstitucional për Menaxhimin e Incidentit (GNMI), Qendra Operative e Agjencionit të Menaxhimit Emergjent (QOAME), Qendrat Operative Emergjente Regjionale (QOER) të AME-së dhe Qendra e Bashkuar Fushore (QBF).

1. Ministrinë dhe agjencitë qendrore rregullisht menaxhojnë reagimin ndaj incidenteve të cilët nuk ngritën në nivelin e një incidenti me karakter kombëtar. Kur entiteti qendror me përgjegjësi parësore dhe autoritet ligjor për ballafaqimin e një incidenti kërkon ndihmë përtej operacioneve të tija të zakonshme (për një incident i cili nuk është përcaktuar si Incident i Karakterit Kombëtar), ajo agjenci mund të kërkojë ndihmë nga MPB-ja për koordinimin e ndihmës qendrore, për mbështetjen e përpjekjeve të menaxhimit të incidentit. MPB-ja e koordinon ndihmën duke përdorur strukturat koordinuese shumë institucionale në Planin e Reagimit Kombëtar (PRK).
2. Për inicimin e mbështetjes brenda qeveritare, kërkesat për ndihmë dorëzohen tek sekretari përgjithshëm i MPB-së (nëpërmjet Qendrës Operative të Ministrisë së Punëve të Brendshme (QOMP)) për shqyrtim dhe miratim. Kërkesat duhet të përfshijnë përmbledhjen e situatës, llojin dhe sasinë e ndihmave të nevojshme, informacionet funksionale dhe çdo informacion tjetër të nevojshëm.
3. Me rastin e miratimit të kërkesës, ministri i Punëve të Brendshme lëshon një urdhër operativ për QOMP-në. QOMP nëpërmjet QOAME koordinon aktivizimin e Funkcionit përkatës të Mbështetjes Emergjente (FME). Për më tepër, ministri i Punëve të Brendshme e cakton Koordinatorin e Resurseve Qendrore (KRQ) për të shërbyer si përfaqësues i ministrit në terren. Zyrtari Autorizuar Qendror (IDM), gjithashtu mund të caktohet si përfaqësues i ministrit për koordinimin e përpjekjeve të gjithëmbarshme qendrore ndërinstitucionale të menaxhimit të incidentit.
4. Agjencia qendrore kërkuese cakton një Zyrtar të Lartë Qendror (ZLQ) për të punuar në koordinim me KRQ për përcaktimin e nevojave për mbështetje.
5. Agjencia kërkuese gjithashtu siguron zyrtar financiar për QOAME, QOER dhe QBF, sipas nevojës, për t'i mbikëqyrë aktivitetet e menaxhimit financiar.
6. Një QOER mund të aktivizohet plotësisht apo pjesërisht për të ndihmuar dislokimin e resurseve derisa të themelohet QBF-ja. Mjediset si qendrat mobilizuese mund të ngriten për akomodimin e personelit, pajisjeve dhe furnizimeve.
7. Agjencitë qendrore sigurojnë resurset sipas marrëveshjeve ndërinstitucionale sipas autoritetit të tyre vetjak.
8. Kur ngritet QBF-ja, ajo shërben si pikë qendrore për koordinimin e ndihmave qendrore për agjencinë kërkuese dhe strukturat e komandës së incidentit në vendngjarje.

9. Sipas nevojës, GNMI mbledhet për të ofruar koordinim të nivelit strategjik dhe kornizë të kursit të veprimeve lidhur me çështjet e ndryshme të operacioneve dhe politikave të veprimit.
10. Ashtu siç mbaron nevoja për koordinim ndërinstytucional me kohë të plotë në QBF, grupi Koordinues i QBF-së planifikon për shkarkimin selektiv të resurseve qendrore dhe demobilizimin dhe lirin e tyre.

Fig. 7. Pasqyra e mbështetjes brenda-qeveritare



Anekset e Funksioneve Mbështetëse Emergjente (FME)

Anekset e Funksioneve Mbështetëse Emergjente (FME)

Parathënie

- Fme 1 - Transporti
- Fme 2 - Komunikimi
- Fme 3 - Punët Publike dhe Inxhinierike**
- Fme 4 - Zjarrfikja
- Fme 5 - Menaxhimi Emergjent**
- Fme 6 - Kujdesi Masiv, Strehimi dhe Shërbimet Humane**
- Fme 7 - Mbështetja e Resurseve
- Fme 8 - Shëndeti Publik dhe Shërbimet Mjekësore
- Fme 9 - Kërkimi dhe Shpëtimi Urban
- Fme 10 - Reagimi ndaj Vajrave dhe Materieve të Rrezikshme
- Fme 11 - Resurset Natyrore dhe Bujqësore
- Fme 12 - Energjia
- Fme 13 - Siguria Publike
- Fme 14 - Rimëkëmbja Afatgjate e Komunitetit
- Fme 15 - Marrëdhëniet me Jashtë

PARATHËNIE

Qëllimi

Përshkrimi i strukturës së Funksioneve Mbështetëse Emergjente (FME), elementeve të përbashkëta të secilit funksion dhe përbërësit themelor të përfshirë në secilin prej tyre.

Historiku

FME-të ofrojnë strukturë për koordinimin e mbështetjes ndërinstitucionale qendrore për Incidentet e Karakterit Kombëtar. Struktura e FME-së përfshinë mekanizmat që përdoren për të siguruar mbështetjen qendrore për komunat dhe mbështetjen brenda qeveritare, për fatkeqësitë natyrore, emergjencat tjera dhe incidentet e shkaktuara nga faktori njeri. Seksioni në vijim përfshinë serinë e anekseve që përshkruajnë rolet dhe përgjegjësitë e ministrive/agjencive qendrore dhe Kryqit të Kuq të Kosovës si koordinator të funksionit, si agjenci parësore apo si agjenci mbështetëse.

Struktura e FME-së ofron mekanizma për koordinim ndërinstitucional gjatë të gjitha fazave të menaxhimit të incidentit. Disa prej ministrive dhe agjencive ofrojnë resurse për reagim, mbështetje dhe implementim të programeve gjatë fazës së hershme të një ngjarje, derisa të tjerat janë më të spikatura në fazën e rimëkëmbjes.

NJOFTIMI DHE AKTIVIZIMI I FME-ve

Qendra Operative e Agjencisë së Menaxhimit Emergjent (QOAME), komponent e Qendrës Operative të Ministrisë së Punëve të Brendshme (QOMP), harton dhe lëshon urdhëra operativ për aktivizimin e FME-ve individuale bazuar në gjerësinë dhe madhësinë e kërcënimit apo incidentit të dhënë.


Agjencitë parësore të FME-ve njoftohen për urdhëratë operativ dhe kohën për të raportuar në QOAME nga Qendra Operative e Agjencisë së Menaxhimit Emergjent të Ministrisë së Punëve të Brendshme (QOAME). Në nivelin regjional, FME-të njoftohen nga Qendrat Operative Emergjente Regjionale të AME-së (QOER) sipas protokolleve të caktuara. Figura 1 në faqen e tjetër tregon organizimin e QOAME dhe QOER si dhe marrëdhënien e tyre me FME-të.

Agjencitë parësore të FME-ve njoftojnë dhe aktivizojnë agjencitë mbështetëse sipas nevojës së kërcënimit apo incidentit aktual, përfshirë edhe mbështetjen për ekipet e specializuara. Secili FME është i obliguar të zhvilloj procedura standarde operative (PSO) dhe protokolle për njoftim dhe të mbaj regjistra dhe lista të kontaktit.

ROLET DHE PËRGJEGJËSITË E FME-ve

Çdo aneks i FME-së përcakton koordinatorin, agjencitë parësore dhe agjencitë mbështetëse për funksionin përkatës. Disa FME inkorporojnë komponentë të shumtë me agjencitë parësore të caktuara për secilën komponent për të siguruar integrim të lehtë në aktivitetet e gatishmërisë, parandalimit, reagimit dhe lehtësimit. FME-të me shumë agjenci parësore caktojnë një koordinator të FME-së për qëllime të planifikimit dhe koordinimit para-incidenteve.

Fig. 1. Shembull i organizimit të QOAME-së dhe QOER



Koordinatori i FME-së

Koordinatori i FME-së ka përgjegjësi të vazhdueshme përgjatë fazës së parandalimit, gatishmërisë, reagimit, rimëkëmbjes dhe lehtësimit të menaxhimit të incidentit. Roli i koordinatorit të FME-së realizohet nëpërmjet konceptit “komanda e bashkuar” sipas marrëveshjes kolektive të agjencive të caktuara si parësore. Përgjegjësitë e koordinatorit të FME-së përfshijnë:

- Koordinimin dhe planifikimin para-incidentit;
- Mbajtjen e kontaktit të vazhdueshëm me agjencitë parësore dhe mbështetëse të FME-së përkatëse;
- Zhvillimin e takimeve dhe konferencave periodike me FME-të përkatëse;
- Koordinimin e përpjekjeve me organizatat përkatëse të sektorit-privat dhe
- Koordinimin e aktiviteteve të funksionit të lidhura me planifikimin për incidente katastrofike dhe përgatitjes së infrastrukturës kritike sipas nevojës.

Agjencitë parësore

Agjencia e caktuar si agjenci parësore e FME-së së caktuar, shërben si organ ekzekutiv qendror nën Zyrtarin Koordinues Qendror (apo Koordinatorin e Resurseve Qendrore) për përmbushjen e misionit të FME-së përkatëse. Kur FME është i aktivizuar për reagim ndaj një Incidenti të Karakterit Kombëtar, agjencia parësore është përgjegjëse për:

- Organizimin e mbështetjes qendrore brenda fushës funksionale për një komunë të goditur;
- Sigurimin e personelit për funksionet operative në mjediset statike dhe fushore;
- Njoftimin dhe kërkimin e asistencës nga agjencitë mbështetëse;
- Menaxhimin e detyrave të misionit dhe koordinimin me agjencitë mbështetëse dhe strukturat komunale sipas nevojës;
- Të punuar me organizatat përkatëse të sektorit privat për shfrytëzimin maksimal të të gjitha resurseve në dispozicion;
- Mbështetjen dhe mbajtjen e FME-ve dhe elementet tjera organizative të informuar për aktivitetet dhe prioritetet operative të FME-së;
- Zbatimin e kontratave dhe prokurimin e të mirave dhe shërbimeve sipas nevojës;
- Sigurimin e llogaridhënjes për aktivitetet e FME-së në sferën financiare dhe pronësore;
- Planifikimin për mbështetjen afatshkurte dhe afatgjate të operacioneve të menaxhimit të incidentit dhe të rimëkëmbjes dhe
- Mirëmbajtjen e personelit të trajnuar për zbatimin e përgjegjësive të tyre përkatëse të mbështetjes.

Agjencitë mbështetëse

Kur një FME është i aktivizuar në reagim ndaj një incidenti me karakter kombëtar, agjencitë mbështetëse janë përgjegjëse për:

- Zhvillimin e operacioneve (kur kërkohet nga MPB-ja apo agjencia parësore) duke përdorur autoritetin, ekspertët e fushave të caktuara, kapacitetet apo resurset e tyre vetjake;
- Pjesëmarrje në planifikimin për menaxhimin afatshkurtër dhe afatgjatë të incidentit dhe operacioneve të rimëkëmbjes, si dhe hartimin e planeve mbështetëse operative, PSO-ve, listave kontrolluese apo mjeteve tjera për lehtësimin e punës në harmoni me standardet ekzistuese të reaguesve të parë;
- Asistimin në zhvillimin e vlerësimeve të situatës;
- Furnizimin me personel, pajisje apo resurse tjera në dispozicion ashtu siç kërkohet nga MPB-ja apo agjencia parësore;
- Angazhimin në vlerësimet periodike të gatishmërisë;
- Pjesëmarrje në trajnime dhe ushtrime të destinuara për përmirësimin e vazhdueshëm të kapaciteteve të parandalimit, reagimit dhe rimëkëmbjes;
- Identifikimin e kapaciteteve apo pajisjeve të reja të nevojshme për parandalimin apo reagimin ndaj kërcënimeve apo rreziqeve të reja, apo atyre në rritje, apo për përmirësimin e aftësive për adresimin e kërcënimeve ekzistuese;
- Propozimin e teknologjive të reja që kanë mundësi të përmirësimit të performancës brenda apo përgjatë fushës funksionale tek MPB-ja për shqyrtim dhe vlerësim, si dhe
- Sigurimin e informacioneve të zakonshme dhe inteligjente lidhur me fushën e njohurive speciale të agjencisë së tyre.

Kur kërkohet dhe me aprovimin e ministrit të FSK-së, Ministria e FSK-së ofron mbështetjen e FSK-së për autoritetet civile gjatë incidenteve vendore. Në përputhje me rrethanat MFSK konsiderohet agjenci mbështetëse për të gjitha FME-ve.

Aneksi : Funkzioni Mbështetës Emergjent 3 – Punët Publike dhe Inxhinierike

Koordinatori i FME-së:

Ministria e FSK-së

Agjencia Parësore:

Ministria e FSK-së
Agjencia e Menaxhimit Emergjent e
Ministrit të Punëve të Brendshme

Agjencitë Mbështetëse:

Ministria e Tregëtisë dhe Industrisë
Ministria e FSK-së
Ministria e Energjisë dhe Minierave
Ministria e Shëndetësisë
Ministria e Punëve të Brendshme
Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
Ministria e Transportit
Ministria e Administratës Publike
Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit
Hapësinor
Kryqi i Kuq i Kosovës

Parathënie

Qëllimi

Funksioni Mbështetës Emergjent 3 – Punët Publike dhe Inxhinierike ndihmon Ministrinë e Punëve të Brendshme (MPB), duke i koordinuar dhe organizuar kapacitetet dhe resurset e Qeverisë për ta lehtësuar shpërndarjen e shërbimeve, asistencës teknike, ekspertizës inxhinierike, menaxhimin e ndërtimeve dhe mbështetjen tjetër për parandalim, përgatitje, reagim dhe rimëkëmbje nga një incident me karakter kombëtar.

Fushëveprimi

FME 3 është formuar për të siguruar mbështetje lidhur me punët publike dhe të inxhinierisë për nevojat e ndryshme të menaxhimit të incidenteve, duke përfshirë veprimet e gatishmërisë, parandalimit, reagimit, rimëkëmbjes dhe lehtësimit. Aktivitetet brenda këtij funksioni përfshijnë realizimin e vlerësimeve para dhe pas incidentit të punëve publike dhe infrastrukturës, zbatimin e mbështetjes së kontraktuar emergjente për shërbimet e shpëtimit të jetës dhe mbijetesës, sigurimin e asistencës teknike përfshirë ekspertizën inxhinierike, menaxhimin e ndërtimeve dhe kontraktimin e shërbimeve të qëndrueshme, sigurimin e riparimit emergjent të infrastrukturës së dëmtuar dhe objekteve kritike dhe implementimin dhe manaxhimin e programeve të rimëkëmbjes.

Politikat

Regjionale dhe lokale

- Qeveritë lokale dhe degët regjionale të qeverisë qendrore janë përgjegjëse për punët dhe infrastrukturën e tyre publike dhe kanë përgjegjësinë parësore për parandalimin, gatishmërinë, reagimin dhe rimëkëmbjen nga incidenti.
- Qeveritë lokale dhe degët regjionale të qeverisë qendrore janë të integruar plotësisht dhe pajtueshëm në FME 3.
- Kur të aktivizohen për të reaguar ndaj një incidenti, agjencitë parësore për FME 3 zhvillojnë prioritetet e punës në bashkëpunim me qeveritë lokale dhe degët regjionale të qeverisë qendrore dhe në koordinim me Zyrтарin Koordinues Qendror apo Koordinatorin e Resurseve Qendrore.
- Pushteti lokal është përgjegjëse për sigurimin e mbështetjes së nevojshme të FME 3 që lidhet me pastrimin e hapësirave.

Sektori privat

- Sektori privat është përgjegjës për përgatitjen e gjerë të infrastrukturës së vendit dhe merr pjesë në planifikimin e veprimeve në incident të FME 3 dhe aktivitetet tjera të planifikimit sipas nevojës.
- Sektori privat është partner dhe prinë në restaurimin e shpejtë të shërbimeve të lidhura me infrastrukturën.
- Entitetet përkatëse të sektorit privat janë të integruara në procesin e planifikimit dhe vendimmarrjes sipas nevojës.

Qeveria

- FME 3 siguron mbështetje qendrore të punëve publike dhe inxhinierike kur një incident apo incident i mundshëm mbingarkon kapacitetet regjionale dhe lokale, ose kur ministrinë dhe agjencinë brenda qeverisë qendrore kërkojnë asistencë.
- FME 3 ndihmon dhe koordinon mbështetjen nga ministrinë dhe agjencinë qendrore që sigurojnë punë publike dhe asistencë në mbështetje të infrastrukturës nën autoritetin e tyre vetjak.
- Institucionet qendrore janë përgjegjëse për harmonizim e veprimeve të tyre me ligjet që rregullojnë çështjet e ruajtjes së mjedisit dhe atyre kulturore historike.

Koncepti i veprimit

I përgjithshëm

- Njësia e Xhenios e Forcës së Sigurisë së Kosovës është agjencioni parësor për sigurimin e asistencës teknike, inxhinierisë dhe resurseve të menaxhimit të ndërtimeve dhe mbështetje gjatë aktiviteteve të reagimit.
- AME është agjencion parësor për sigurimin e resurseve rimëkëmbëse të FME 3, përfshirë programin e ndihmës publike.
- Për përcaktimin e nevojave të mundshme për mbështetje dhe për përcjelljen e gjendjes së aktiviteteve të reagimit dhe rimëkëmbjes mbahet koordinim i ngushtë me zyrtarët regjional dhe lokal.
- Prioritetet përcaktohen bashkërisht midis zyrtarëve qendror, regjional dhe lokal. Mbështetja qendrore FME 3 është e integruar në përpjekjen e përgjithshme qendrore, regjionale, lokale, OJQ-ve dhe sektorit privat.
- Përfaqësuesit e agjencive mbështetëse bashkëvendosen me personelin fushor të FME 3 për koordinimin e mbështetjes së agjencive të tyre sipas nevojës.

Organizimi

Mbështetja FME 3 e nivelit të Zyrave Qendrore

- **Grupi Ndërinstitucional i Menaxhimit të Incidentit (GNMI):** FME 3 për të gjitha fazat e menaxhimit emergjent mund të ofroj ekspert “në thirrje” për mbështetjen e aktiviteteve të GNMI-së. Për një incident në të cilin FME 3 ka përgjegjësinë për drejtimin apo menaxhimin e aspekteve kryesore të reagimit, agjencia parësore e FME 3 mund të jetë pjesë e Grupit Themelor të GNMI-së.
- **Qendra Operative e Ministrisë së Punëve të Brendshme (QOMP):** FME 3 përcakton përfaqësuesit të cilët mund të dislokohen në QOMP, nëse kërkohet.
- **Qendra Operative e Agjencisë së Menaxhimit Emergjent (QOAME):** FME 3 përcakton përfaqësuesit të cilët mund të dislokohen në QOAME, nëse kërkohet. Në vijim

të shpalljes së gjendjes emergjente AME mund të dislokoj staf të Ndihmës Publike për iniciimin e aktiviteteve në mbështetje të operacioneve të rimëkëmbjes.

- **Qendra Operative e FSK-së (QOFSK):** QOFSK koordinon aktivizimin dhe dislokimin e ekipeve dhe resurseve të Njesisë së Xhenios të Forcës së Sigurisë së Kosovës.

Mbështetja FME 3 e nivelit regjional

- **Qendra Operative Emergjente Regjionale (QOER):** Kur aktivizohet nga AME-ja, përfaqësuesit e FME 3 dislokohen në QOER. Lideri i Ekipit të FME 3 në QOER koordinon detyrat, veprimet dhe mbështetjen tjetër derisa të ngritet Qendra e Bashkuar Fushore (QBF) dhe përgjegjësitë për zbatimin e misionit të kenë kaluar tek Lideri i Ekipit FME 3 në QBF. FME 3 siguron raporte dhe informacione të lidhura me incidentin për FME 5 – Menaxhimi Emergjent. Kur aktivizohen nga AME, përfaqësuesit e FME 3 dislokohen gjithashtu edhe si pjesëtar të Elementit Avancues të Ekipit të Reagimit Emergjent (ERE-A) apo si Ekip Qendror i Reagimit Emergjent. Kur aktivizohen, personeli i Ndihmës Publike të AME-së dislokohet për ta bërë iniciimin e mbështetjes regjionale.

Mbështetja FME 3 e nivelit fushor

- **Qendra e Bashkuar Fushore (QBF):** Kur aktivizohet nga AME, personeli i FME 3 dislokohet në QBF. FME 3 është përgjegjës për përgatitjen e deklaratave të punës, sigurimin e llogarive të kostove dhe afatet e përmbushjes së misioneve të caktuara, përcjelljen e zbatimit të misioneve, përcaktimin e nevojave për resurse, vendosjen e prioriteteve, shpërndarjen e informacioneve dhe sigurimin e informimit publik dhe mbështetjes së komunikimit me jashtë (në koordinim me FME 15 – Marrëdhinet me Jashtë). Kur aktivizohet, personeli i Ndihmës Publike i AME-së dislokohet për të inicuar mbështetjen e nivelit regjional.
- **Grupi Koordinues i QBF-së:** Për rastet e vërshimeve apo incidenteve tjera ku NjXH ka autoritetin dhe/apo përgjegjësinë dhe juridiksion për drejtimin apo menaxhimin e aspekteve kryesore të reagimit NjXH mund të kërkohet të dërgoj Zyrtar të Lartë Qendror për të marr pjesë në Grupin Koordinues të QBF-së.
- **Post Komanda e Incidentit (PKI):** Nëse kërkohet nga Komanda e Bashkuar dhe nga situata FME 3 siguron personel për koordinimin dhe integrimin e punëve publike dhe mbështetjes inxhinierike në PKI.

Veprimet

Zyrtar Qendror: Me aktivizimin e FME 3:

- **QOFSK:**
 - Njofton ministrin e FSK-së dhe Qendrën e Situatave të MFSK-së (QSMFSK) për aktivizimin dhe
 - Ofron raporte të situatës për QSMFSK-në dhe komandat përkatëse të FSK-së.
- Stafi i caktuar i MFSK-së koordinon me ministrin e FSK-së dhe MPB-në për të siguruar prezantim adekuat në GNMI dhe QOMP. QOFSK zgjerohet dhe ngushtohet sipas

nevojës së plotësimi të nevojave të incidentit. Lideri i Ekipit FME 3 të NjXHFSK përcaktohet dhe dërgohet në QOAME.

- QOFSK koordinon aktivizimin e ekipeve dhe resurseve qendrore të NjXHFSK-së sipas nevojës.
- Përcaktohet dhe dislokohet në QOAME, Lideri i Ekipit FME 3 i NjXHFSK-së.
- QOFSK koordinon aktivizimin dhe dislokimin e ekipeve dhe resurseve qendrore të NjXHFSK-së sipas nevojës.

Niveli regjional dhe fushor

- Me aktivizimin e FME 3, QOFSK njofton Komandantin e Njesisë. Komandanti i Njesisë koordinon me Shtabin e NjXHFSK-së për personelin përkatës mbështetës të FME 3.
- QOFSK përcakton dhe dislokon një Lider Ekipi në QOAME dhe/apo QBF (sipas nevojës) për koordinimin e zbatimit të misionit FME 3.

Veprimet e FME 3 në incident

Aktivitetet brenda funksionit FME 3 përfshijnë me sa vijon:

- Koordinimi dhe mbështetja e vlerësimit të rrezikut dhe dobësive të infrastrukturës.
- Pjesëmarrja në aktivitetet e para-incidentit, siç janë parapozicionimi i ekipeve të vlerësimit dhe kontraktorëve dhe dislokimi i elementeve mbështetëse pararoj.
- Pjesëmarrja në vlerësimet e pas-incidentit të punëve publike dhe infrastrukturës për të ndihmuar në përcaktimin e nevojave kritike dhe ngarkesave të mundshme në punë.
- Implementimi i masave strukturore dhe jostrukturore, përfshirë vendosjen e masave mbrojtëse për zvogëlimin e efekteve të ndryshme apo mbrojtjen e plotë të resurseve para një incidenti.
- Zbatimin e mbështetjes emergjente kontraktuese për shërbime të ruajtjes dhe mbajtjes së jetës, duke përfshirë sigurimin e ujit, energjisë emergjente dhe komoditetet dhe shërbimet tjera emergjente.
- Sigurimi i ndihmës në monitorimin dhe stabilizimin e strukturave të dëmtuara dhe rrënimin e strukturave të caktuara si rrezik i pashmangshëm për shëndetin dhe sigurinë publike. Gjithashtu, sigurimi i ekspertizës speciale për mbështetjen e inspektimit të mjediseve të kujdesit masiv dhe operacioneve të kërkimit dhe shpëtimit urban.
- Sigurimin e riparimit emergjent të infrastrukturës dhe objekteve kritike publike të dëmtuara (energji të përkohëshme, ujë, sisteme sanitare, etj.). Kur është e nevojshme, aktivitetet për restaurimin e infrastrukturës (si: largimi i rrënojave, strehimi i përkohshëm, etj.) koordinohen ngusht me FME 11 –Resurset bujqësore dhe natyrore. Sipas nevojës, FME 3 kërkon nga FME 11 të siguroj mbështetje teknike për të ndihmuar në përpjekjet FME 3 për marrjen e autorizimeve të nevojshme (kulturore dhe mjedisore) për aktivitetet e restaurimit të infrastrukturës.

- Manaxhimin, monitorimin dhe sigurimin e këshillave teknike në pastrim, largim dhe hüdhe të rrënojave të kontaminuara dhe pa kontaminuara nga pronat publike dhe në hapjen dhe rihapjen e rrugëve në zonat e goditura.
- Implementimin dhe menaxhimin e programeve të rimëkëmbjes emergjente të AME/MPB me dhe midis zyrtarëve qendror dhe regjional, duke i përfshirë përpjekjet për riparimin, zëvendësimin apo rivendosjen e përhershme të infrastruktures dhe objekteve publike të dëmtuara apo shkatërruara. Aktivitetet e rimëkëmbjes koordinohen me FME 14 – Rimëkëmbja Afatgjate e Komunitetit.

Përgjegjësitë

- **Koordinatori i FME-së:** NjXHFSK-së është caktuar si koordinatori i FME 3. Në cilësinë e koordinatorit koordinon takimet, planet, ushtrimet, trajnimet dhe aktivitetet tjera me AME-në, sektorin privat dhe agjencitë e mbështetjes së FME 3.
- **Agjencia Parësore për Reagim:** NjXHFSK si agjenci parësore për reagim ofron drejtim dhe koordinim të aktiviteteve dhe resurseve të FME 3 të lidhura me reagimin.
- **Agjencia Parësore për Rimëkëmbje:** AME si agjenci parësore e rimëkëmbjes cakton një zyrtar për ndihma publike të FME 3 për koordinimin dhe menaxhimin e programeve ndërinstytucionale të rimëkëmbjes emergjente.

Agjencitë Mbështetëse

Agjencia	Funksioni
Ministria e Tregtisë dhe Industrisë	Siguron mbështetje të drejtpërdrejt teknike dhe këshilla në prokurimin e shërbimeve konsultative të jashtme për vlerësimin e sigurisë strukturore dhe nga zjarri të ndërtesave dhe linjave jetësore (shërbimet publike). Instituti i Metrologjisë është pikë e kontaktit.
Ministria e Energjisë dhe Minierave	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Grumbullon, vlerëson dhe shkëmben informacionet lidhur me dëmet në sistemin energjetik dhe vlerësimet mbi efektin e ndërprerjeve të sistemit energjetik brenda zonës së goditur. ▪ Siguron informacione lidhur me procesin e restaurimit energjetik siç janë remontet e planifikuara dhe informacionet tjera të kësaj natyre. ▪ Instituti Sizmik i Kosovës është pike shtesë e kontaktit
Ministria e Shëndetësisë	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Instituti i Kombëtar i Shëndetësisë (IKSH) siguron personel inxhinierik dhe shëndetit mjedisor për të ndihmuar në vlerësimin e gjendjes së ujërave të zeza dhe objekteve të përpunimit të tyre. ▪ Siguron këshilla lidhur me problemet shëndetësore të shoqëruara me materiet e rrezikshme. ▪ Ndhmon në përcaktimin e përshtatshmërisë së konsumimit të ujit të pijshëm nga burimi i parë.

	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Mundëson aktivitetet e menaxhimit të rrënojave të kontaminuara duke koodinuar dhe/apo siguruar resurse, vlerësime, të dhëna, asistencë teknike, monitorim dhe mbështetje tjetër të nevojshme.
Ministria e Punëve të Brendshme	<p>Spektori për Analizimin e Informacioneve dhe Mbrojtjen e Infrastrukturës i QOMPB-së</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Mbështet misionet e FME 3 të mbrojtjes së infrastrukturës, duke ofruar vlerësime të rrezikut dhe dobësive të infrastrukturës në reagim ndaj informacioneve të besueshme inteligjente. ▪ Punon me ndërlidhësinë e infrastrukturës lidhur me çështjet që kanë të bëjnë me rimëkëmbjen dhe restaurimin e sektorit të infrastrukturës përcjellëse kritike, të mbështetur nga ky FME, përfshirë alokimin dhe caktimin e prioriteteve të resurse.
Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Ofron këshilla, sigurie, asistencë sociale dhe mbështetje të politikave për largimin e rrënojave, demolimin e ndërtesave dhe aktivitetet tjera të FME 3.

Agjencia	Funksioni
Ministria e Transportit dhe Postë-Telekomunikacionit	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Siguron ekspertizë teknike dhe ndihmë për riparimin dhe restaurimin e infrastrukturës së transportit (si: autorrugët, urat, tunelet, sistemet e tranzitit dhe hekurudhat) dhe siguron këshilla dhe ndihmë në transportin e materialeve të kontaminuara. ▪ Siguron personel dhe ndihmë teknike për të ndihmuar në vlerësimin e dëmeve, inspektimet e strukturave, pastrimin e rrënojave dhe restaurimin e infrastrukturës transportuese të vendit. ▪ Administron fondet e veçanta që mund të përdoren për riparimin apo rindërtimin e shërbimeve të autorrugëve si dhe programet e granteve për sistemet e tranzitit dhe hekurudhat që mund të përdoren për riparimin apo rehabilitimin e infrastrukturës së dëmtuar.
Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Zhvillon aktivitete të mbrojtjes së mjedisit për ujrat sipërfaqësor dhe nëntokësor. ▪ Në lidhje të ngushtë me MSH ndihmon në përcaktimin e përshtatshmërisë së konsumimit të ujit nga burimet lokale (burimi i parë) dhe në identifikimin e materieve të rrezikshme që kanë

	<p>potencial të ndikimit në burimet e furnizimit me ujë. Ndhmon në përcaktimin e nevojave për ujë dhe trajtimin e ujërave të zeza. Mbështet teknikët sanitar në vlerësimin e ujërave të zeza dhe objektet e përpunimit të tyre.</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Ndhmon në vendosjen për vendet e hudhjes së mbeturinave për aktivitetet e pastrimit të rrënojave. ▪ Përcakton lokacionet dhe siguron udhëzime për siguri për zonat e goditura nga materiet e rrezikshme. Siguron mbrojtjen dhe pastrimin e këtyre zonave. ▪ Ndhmon në hetime dhe analiza inteligjente për incidentet me materie të rrezikshme që përfshijnë kontaminimin e sistemeve të ujit ë pijës dhe atyre të zeza. ▪ Mundëson aktivitetet e menaxhimit të rrënojave të kontaminuara nga rrezatimi duke koordinuar dhe/apo duke ofruar resurse, vlerësime, të dhëna, ekspertizë, asistencë teknike, monitorim dhe mbështetje tjetër të nevojshme. (past to...MMPH)
--	--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------

Agjencia	Funksioni
Ministria e Administratës Publike	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Siguron personel dhe kontraktor për të ndihmuar në vlerësimin e dëmeve, inspektimin e strukturave, monitorimin e pastrimit të rrënojave dhe restaurimin e shërbimeve në përgjithësi. ▪ Siguron ndihmë teknike në menaxhimin e kontratave, prokurim, inspektim të ndërtimeve dhe vlerësime mjedisore dhe arkeologjike.
Kryqi i Kuq i Kosovës	Punon me NjXHFSK/MFSK; AME/MPB; Entitetet tjera qeveritare qendrore, regjionale dhe lokale dhe OJQ-të tjera për të siguruar integrimin e nevojave për ujë dhe proceseve të shpërndarjes në operacionet e kujdesit masiv.

Funksioni Mbështetës Emergjent 5 – Aneksi i Menaxhimit Emergjent

Koordinatori i FME-së:

Ministria e Punëve të
Brendshme/Agjencia e Menaxhimit
Emergjent

Agjencia Parësore:

Ministria e Punëve të
Brendshme/Agjencia e Menaxhimit
Emergjent

Agjencitë Mbështetëse:

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe
Zhvillimit Rural
Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
Ministria e FSK-së
Ministria e Arsimit, Shkencës dhe
Teknologjisë
Ministria e Energjisë dhe Minierave
Ministria e Shëndetësisë
Ministria e Punëve të Brendshme
Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit
Hapësinor
Ministria e Drejtësisë
Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
Ministria e Punëve të Jashtme
Ministria e Transportit dhe Postë-
Telekomunikacionit
Ministria e Administratës Publike
Ministria e Financave dhe Ekonomisë
Shërbimi Postal i Kosovës
Agjencioni i Ushqimit dhe Veterinarisë
Kryqi i Kuq i Kosovës

Parathënie

Qëllimi

Funksioni Mbështetës 5 – Menaxhimi Emergjent është përgjegjës për mbështetjen e të gjitha aktiviteteve të qeverisë për menaxhimin e incidenteve vendore. FME 5 siguron bërthamën e funksioneve menaxhuese dhe administrative në mbështetje të operacioneve të Qendrës Operative të AME-së (QOAME), Qendrave Operative Emergjente Regjionale (QOER) dhe Qendrës së Bashkuar Fushore (QBF).

Shtrirja

FME 5 shërben si funksion mbështetës për të gjitha ministrinë dhe agjencitë qendrore përgjatë tërë spektrit të menaxhimit të incidenteve nga parandalimi deri tek reagimi dhe rimëkëmbja. Në fazën e parandalimit para-incidentit FME 5 ndihmon rrjedhën e informimit me qëllim të vendosjes së aseteve në gjendje alarmi apo me qëllim të pozicionimit paraprak të aseteve për reagim të shpejt. Gjatë fazës së reagimit pas-incidentit, FME 5 transferohet dhe bëhet përgjegjës për funksionet e mbështetjes dhe planifikimit. Aktivitetet e FME 5 përfshijnë ato funksione që janë kritike për lehtësimin e planifikimit dhe koordinimit shumë-insutictional për operacionet që përfshijnë Incidentet e mundshme dhe aktuale të karakterit kombëtar. Kjo përfshinë paralajmërimin dhe

alarmimin, dislokimin dhe plotësimin e ekipeve të reagimit emergjent, planifikimin e veprimeve për incidentin, koordinimin e operacioneve, logjistikën, drejtimin dhe kontrollin, menaxhimin e informacioneve, përpunimin e kërkesave për asistencë qendrore, përfitimin dhe menaxhimin e resurseve (përfshirë alokimin dhe përcjelljen), sigurinë dhe shëndetin e punëtorëve, menaxhimin e shërbimeve, menaxhimin financiar dhe mbështetjen tjetër sipas nevojës të Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Politikat

- FME 5 është përgjegjës për vendosjen e infrastrukturës mbështetëse qendrore në regjionin apo komunën e goditur në parashikimin e kërkesave për asistencë qendrore të parandalimit, reagimit dhe rimëkëmbjes.
- Kërkesat e kryetarëve të komunave për asistencë qendrore tek kryeministri koordinohen përmes Agjencisë së Menaxhimit Emergjent të MPB-së.
- Alokimi i resurseve dhe ngarkimi me detyra koordinohet përmes FME 5 duke përdorur procesin e AME-së të caktimit të misioneve dhe procedurat tjera të përvijuara në Aneksin e Mbështetjes së Menaxhimit Financiar të Planit të Reagimit Kombëtar (PRK).
- Stafi i FME 5 identifikon dhe zgjidh çështjet e alokimit të resurseve të përcaktuara në QBF, QOER dhe QOAME. Ato çështje që nuk mund të zgjidhen në nivelin e QOAME referohen tek Grupi Ndërinstitucional i Menaxhimit të Incidentit (GNMI).
- Stafi i FME 5 siguron lidhje informimi midis QOAME dhe Qendrën Operative të Ministrisë së Punëve të Brendshme (QOMP). FME 5 shërben si kanal i centralizuar për raportet qendrore të situatës për QOMP nga FME-të e ndryshme.
- Ministrinë dhe agjencitë marrin pjesë në procesin e planifikimit të veprimeve për incidentin të koordinuar nga FME 5.
- FME 5 siguron përfaqësues për plotësimin e pozitave kyçe në Ekipet e Reagimit Emergjent (elementet avancuese dhe qendrore) në mbështetje të Grupit Koordinues të QBF-së.
- Stafi i FME 5 cakton mjediset, mjetet dhe pajisjet e nevojshme fushore për mbështetjen e aktiviteteve qendrore të lidhura me menaxhimin e Incidenteve të Karakterit Kombëtar. Këto mjedise përfshijnë, por nuk janë të kufizuara për QBF-në, Qendrën e Bashkuar Informative (QBI), qendrat e mobilizimit, pikat e grumbullimit dhe Qendrat e Rimëkëmbjes nga Fatkeqësia.
- Stafi i FME 5 mbështet implementimin e marrëveshjeve për ndihmë reciproke për të siguruar reagim të lehtë të resurseve në zonat dhe juridiksionet e goditura.
- FME 5 mban në thirrje një forcë pune të trajnuar dhe aftësuar të punëtorëve rezervë për të siguruar kapacitet urgjent/plotësues për kryerjen e funksioneve esenciale të menaxhimit emergjent me paralajmërim të shkurt dhe për kohëzgjatje të ndryshme.
- QOAME është përgjegjëse për njoftimin e ministrive dhe agjencive qendrore sikurse edhe organizatat regjionale dhe lokale të menaxhimit emergjent, për kërcënimet e

mundshme, për të mundësuar ngritjen e gjendjes operative reaguese apo për parapozicionimin e aseteve.

Koncepti i veprimit

I përgjithshëm

- FME 5 siguron staf të trajnuar dhe me përvojë për plotësimin e pozitave menaxhuese në sektorët e komandës, operacioneve, planifikimit, logjistikës, financave/administratës të QOAME, QOER, dhe QBF, nëse aktivizohet apo ngritet.
- QOAME e stafuar nga FME 5 dhe FME-të tjera kur është e aktivizuar, monitoron incidentet e mundshme apo në zhvillim dhe mbështet përpjekjet e operacioneve regjionale dhe fushore.
- FME 5 mbështet aktivizimin dhe dislokimin e ekipit të MPB-së për mbështetjen e reagimit ndaj incidenteve qendrore.
- QOER e stafuar nga FME 5 dhe FME-të tjera sipas nevojës, koordinon operacionet dhe raportimet e situatave tek QOAME derisa QBF të bëhet operative.
- Operacionet e FME 5 kalojnë nga QOER në QBF, kur QBF është e ngritur. Kur QBF fillon uljen e operacioneve, operacionet e FME 5 kalojnë prap në QOER.

Struktura organizative: FME 5 është i organizuar në përputhshmëri me Sistemin e Integruar të Menaxhimit të Emergjencave (SIME). Struktura e FME 5 mbështet funksionet e stafit të përgjithshëm të përshkruara në SIME në secilën qendër koordinuese ndërinstucionale (si, QOAME, QOER, QBF). Këto funksione përfshijnë:

- **Mbështetjen e komandës:** FME 5 mbështet funksionin e komandimit duke siguruar staf të lartë, kapacitete të planifikimit të veprimeve për incidentin, funksione mbështetëse të informimit, administratës, logjistikës dhe financave.
- **Operacionet:** AME siguron staf për pozitat e shefit të sektorit të operacioneve dhe drejtorit të degës së operacioneve për t'i koordinuar degët e burimeve njerëzore, mbështetjes së infrastrukturës, shërbimeve emergjente të lehtësimit dhe të rimëkëmbjes së komunitetit (gjithashtu edhe FME-të tjera sigurojnë staf për këto fusha); përpunon kërkesat për asistencë dhe inicion dhe menaxhon caktimin e misioneve dhe/apo marrëveshjeve me pagesë.
- **Planifikimi:** FME 5 siguron pozitat e shefit të sektorit të planifikimit dhe drejtorit të degës së planifikimit. FME 5 kujdeset për grumbullimin, vlerësimin, shpërndarjen dhe përdorimin e informacioneve lidhur me veprimet për parandalimin dhe reagimin ndaj incidentit dhe gjendjen e resurseve. Sektori i Planifikimit është përgjegjës për procesin e planifikimit të veprimeve për incidentet qendrore. Kjo përfshinë përgatitjen dhe dokumentimin e prioriteteve të incidentit; vendosjen e periudhës dhe dinamikës operative dhe zhvillimin e planeve kontingjente, afatgjata, të demobilizimit dhe planeve tjera (sipas nevojës) të lidhura me incidentin përkatës. Sektori i planifikimit gjithashtu koordinon me Sektorin e Shkencës dhe Teknologjisë dhe agjencitë me kapacitete të veçanta teknike për të kërkuar mbështetje për inteligjencë gjeohapësinore, për modelim dhe parashikim.

- **Logjistika:** FME 5 siguron stafin për shefin e Sektorit të Logjistikës për të menaxhuar kontrollin dhe llogaridhënjen për rezervat dhe pajisjet qendrore, porositje të resurseve, shpërndarje të pajisjeve, furnizimeve dhe shërbimeve, përcjelljen e resurseve, koordinim transporti dhe shërbime të sistemeve të teknologjisë informative dhe shërbime tjera administrative. Sektori i Logjistikës koordinon ngushtë me FME 7 – Mbështetja e Resurseve. Shefi i Sektorit të Logjistikës gjithashtu koordinon me zyrën e menaxhimit të aseteve të MPB-së (sipas nevojës) për identifikimin dhe dislokimin e aseteve të MPB-së.
- **Financa/Administrata:** FME 5 siguron stafin për Shefin e Sektorit të Financave/Administratës për monitorimin e kërkesave financiare dhe kostove të incidentit. Sektori i Financave/Administratës është përgjegjës për shërbimet e punëtorëve, përfshirë sigurinë për personel, hapësira dhe asete. Sektori i Financave/Administratës implementon Aneksin e Menaxhimit Financiar.

Veprimet

Zyrat qendrore të MPB-së

- Kur ekziston kërcënim i besueshëm MPB-ja mund t'i ndërmerr disa veprime, përfshirë aktivizimin e GNMI-së, dislokimin e Zyrtarit të Autorizuar Qeveritar (IDM) dhe stafit mbështetës në zonën e kërcënuar dhe parapozicionimin e aseteve strategjike. QOMPB monitoron situatën dhe njofton QOAME dhe komponentet tjera të qendrave operative të MPB-së sipas nevojës.
- Elementi i IDM-së, kur dislokohet para-incidentit, raporton tek QOMPB-së dhe GNMI. Këto raporte situatë të IDM-së nga QOMPB shtyhen tek QOAME për njohje të situatës dhe për përcaktimin e nevojës për aktivizimin e FME 5 dhe FME-ve tjera.

Niveli i Zyrës Qendrore të AME-së

- Kur ndodh një incident apo ka mundësi të ndodh, AME-ja aktivizon FME 5, duke shtuar numrin e personelit dhe dinamikën e operacioneve në QOAME dhe QOER, sipas nevojës. Veprimet përfshijnë, alarmimin, njoftimin dhe raportimin e situatës në koordinim me elementet e QOMPB-së. Kur të jetë i aktivizuar FME 5 në QOAME, ai është operativ 24 orë.
- FME 5 mban komunikim konstant me qendrën operative emergjente të lokacionit të goditur dhe organizon kohë pas kohe videokonferenca me të gjitha palët e nevojshme për të koordinuar operacionet e përbashkëta lokale, regjionale dhe qendrore.
- FME 5 siguron raporte të situatës dhe informacione tjera sipas nevojës në QOAME (komponent funksionale e QOMPB-së) në përputhshmëri me protokollat procedurat standarde operative të QOMPB-së.
- AME i aktivizon FME-të e nevojshme për tu marr me kërcënimin apo incidentin e dhënë, lëshon detyrat për aktivizim fillestar të misioneve të caktuara dhe vendos protokollat e raportimit dhe komunikimit me agjencitë e aktivizuara dhe Zyrtarin Koordinues Qeveritar.
- AME cakton dhe dislokon ekipe speciale nën kontrollin operativ të zyrave qendrore.

- Staf i FME 5 zhvillon/harton planin fillestar të veprimit në incident duke përvijuar prioritetet e operacioneve qendrore dhe koordinon me FME-të tjera për implementimin e tij.
- Staf i FME 5 përpilon orarin për stafim dhe operim të QOAME-së nga aktivizimi deri tek mbyllja.

Niveli regjional dhe fushor

- Kur ndodh apo ka mundësi të ndodh një incident, regjionet përkatëse të AME-së aktivizohen dhe ngritin dinamikën operative të FME 5. Kjo përfshinë, alarmimin, njoftimin dhe raportimin e situatës tek komponentet regjionale dhe fushore. Kjo gjithashtu përfshinë stafimin dhe operimin e QOER-së mbi bazë 24 orëshe.
- Staf i FME 5 bënë kontaktin fillestar me komunën e goditur dhe shikon kapacitetet dhe mangësitë si mënyrë për përcaktimin e nevojave fillestare për mbështetje qendrore.
- Staf i FME 5 përpilon dhe shpërndan urdhrat përkatës operativ tek FME-të përkatëse, shpërndan aktivizimin fillestar të misioneve të caktuara apo marrëveshjeve me pagesë dhe vendos protokollat raportuese dhe të komunikimit me agjencitë e aktivizuara.
- Regjionet e AME-së aktivizojnë dhe dislokojnë Ekipin Reagues Emergjent – Elementin Avancues dhe Ekipin e Vlerësimit të Nevojave të Shpejta, përfshirë përfaqësuesit e FME-ve sipas nevojës.
- Staf i FME 5 harton planin fillestar të veprimeve në incident dhe koordinon me FME-të tjera implementimin e tij.
- AME e plotëson me personel dhe operon me QOER bashkë me përfaqësuesit e FME-ve tjera.
- FME 5 inician veprimet për identifikimin, stafimin dhe operimin e QBF-së.
- Regjionet e AME-së vendosin komunikim me komunat e goditura për të koordinuar kërkesat fillestare për asistencë qendrore, përfshirë koordinimin e resurseve të reagimit fillestar.

Aktivitetet e planifikimit dhe menaxhimit të incidentit

- FME 5 ndihmon mbajtjen e njohjes së situatës së kërcënimit apo incidentit në koordinim me QOMPB-në nga angazhimi i parë qendror deri tek mbyllja. Ai koordinon dhe përfaqëson interesat qendrore në partneritetin operativ qeveri-komunë dhe siguron që aplikacionet regjionale, lokale dhe individuale marrin asistencë me kohë, të barabartë dhe gjithëpërfshirëse.
- Me progresin e operacioneve nga faza para-incidentit nëpërmjet reagimit në rimëkëmbje FME 5 vazhdon të siguroj funksione të planifikimit afatshkurtë dhe afatgjatë në koordinim me FME-të tjera të angazhuara në operacion dhe me ato që operojnë nën autoritetin statusor të agjencisë. Ashtu siç merr më shumë përgjegjësi komuna për operacionet e rimëkëmbjes, FME 5 koordinon mbylljen e asistencës qendrore me përgjegjësi dhe me radhë. Çdo seksion i Ekipit të Reagimit Emergjent (ERE) në QBF vazhdon të zbatoj

përgjegjësi derisa të suspendohet operacioni dhe prezenca qendrore nuk është më e nevojshme.

Përgjegjësitë

Agjencia Parësore: AME si agjenci parësore:

- Aktivizon asetet dhe kapacitetet emergjente qendrore për parandalim dhe reagim ndaj Incidenteve të Karakterit Kombëtar dhe koordinon me agjencitë dhe organizatat ekzekutive regjionale dhe lokale të menaxhimit emergjent.
- Koordinon aktivitetet qendrore të planifikimit, përfshirë planifikimin imediat, afatshkurtë dhe afatgjatë. Prioritetet e implementimit të planifikimit dhe operacioneve të reagimit të Qeverisë zhvillohen, përcillen dhe implementohen nëpërmjet FME 5.
- Koordinon plotësimin e përgjithshëm me personel të aktiviteteve qendrore të menaxhimit emergjent në nivelet e QOAME, QOER dhe QBF.

Agjencitë Mbështetëse

- Përgjegjësitë dhe kapacitetet e agjencive mbështetëse janë të përvijuara në Planin Themelor dhe Anekset e FME-ve të PRK-së.
- Agjencitë mbështetëse sigurojnë personel për ERE/QBF, QOER apo QOAME, sipas nevojës, për asistimin e operacioneve të FME-ve dhe për të siguruar raporte për FME 5. Të gjitha agjencitë sipas nevojës caktojnë ndërlidhësa apo pika kontakti për të ofruar ekspertizë teknike dhe profesionale, të dhëna, këshilla dhe mbështetje për operacionet të cilat ndodhen brenda domenit të secilës agjenci. Kapacitetet mbështetëse të organizatave tjera mund të përdoren sipas nevojës dhe gatishmërisë.
- Të gjitha komponentet/departamentet e MPB-së ofrojnë mbështetje sipas nevojës.

Funksioni Mbështetës 6 – Aneksi i kujdesit masiv, strehimit dhe shërbimeve humane

Koordinatori i FME:

Ministria e Punëve të Brendshme/
Agjencia e Menaxhimit Emergjent

Agjencitë Primare:

Ministria e Punëve të Brendshme/
Agjencia e Menaxhimit Emergjent
Kryqi i Kuq i Kosovës

Agjencia Mbështetëse:

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe
Zhvillimit Rural
Ministria e FSK-së
Ministria e Shëndetësisë
Ministria e Punëve të Brendshme
Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit
Hapësinor
Ministria e Drejtësisë
Ministria e Punës dhe Mirëqenies
Sociale
Ministria e Transportit dhe Postë-
Telekomunikacionit
Ministria e Administratës Publike
Agjencioni i Ushqimit dhe Veterinarisë
Shërbimi Postal i Kosovës
Organizatat Vullnetare

Parathënie

Qëllimi

Funksioni Mbështetës Emergjent 6 – Shërbimet e kujdesit masiv, strehimit dhe shërbimet humane mbështet përpyjekjet e organizatave qeveritare dhe joqeveritare regjionale dhe lokale për adresimin e nevojave të shërbimeve të kujdesit masiv jo mjekësor, strehimit dhe shërbimeve humane të individëve dhe/apo familjeve të goditura nga incidentet e karakterit kombëtar.

Shtrirja

- FME 6 përkrahë shpërndarjen e shërbimeve dhe implementimin e programeve për t'i ndihmuar individët, pronarët dhe familjet e tyre të goditur nga incidentet e mundshme apo aktuale të karakterit kombëtar. Kjo përfshinë asistencën ekonomike dhe shërbimet tjera për individët e goditur nga incidenti.
- FME 6 përfshinë tri funksione parësore: kujdesin masiv, strehimin dhe shërbimet humane.
- Kujdesi masiv përfshinë strehimin e viktimave, organizimin e operacioneve të ushqyerjes, sigurimin e ndihmës së parë emergjente, grumbullimin dhe ofrimin e informacioneve lidhur me viktimat për anëtarët e familjes.

- Strehimi përfshinë furnizimin me ndihma për nevoja afatshkurta dhe afatgjata të viktimave.
- Shërbimet humane përfshijnë sigurimin e përpjekjeve të viktimave për rimëkëmbje, siç janë konsultat, përcaktimin e mbështetjeve për personat me nevoja të veçanta, përsheptimin e proceseve të kërkesave të reja për benefite qendrore, ndihmën në kompensimin e viktimave të krimit për aktet e terrorizmit dhe përsheptimin e shërbimit të postës në zonat e goditura.

Politikat

Politikat dhe koncepti i veprimit/operimit të FME 6 i adresohen ministrive dhe agjencive qendrore dhe Kryqit të Kuq të Kosovës për aktivitetet e lidhura me incidentet e mundshme apo aktuale të karakterit kombëtar. Parimet themelore përfshijnë me sa vijon:

- Mbështetja e FME 6 mund të ndryshoj varësisht nga vlerësimi i efektit goditës të incidentit, madhësisë dhe llojit të ngjarjes dhe periudhës së përpjekjeve të reagimit dhe rimëkëmbjes.
- Mbështetjen e aktiviteteve të kujdesit masiv dhe sigurimit të shërbimeve pa marrë parasysh gjendjen ekonomike apo racore, religjioze, politike, etnike apo përkatësie tjetër.
- Mbështetjen e aktiviteteve të FME 6 dhe sigurimin e shërbimeve në përputhje me ligjet, normat dhe rregulloret ekzistuese.
- Caktimin e personelit për mbështetjen e funksioneve të FME 6 në përputhje me normat dhe rregulloret e agjencive të tyre përkatëse burimore.
- Koordinimin sipas nevojës me FME 1, 3, 5 dhe 14 të asistencës së rimëkëmbjes dhe lehtësimit.
- Zvogëlimin e dyfishimit të përpjekjeve dhe benefiteve deri në masën e mundshme. Kjo nënkupton drejtimin e asistencës sipas nevojës dhe përcaktimin e masave të rimëkëmbjes dhe lehtësimit për mbështetjen e përpjekjeve planifikuese regjionale dhe lokale.

Koncepti i veprimit

I përgjithshëm

- Aktivitetet fillestare të reagimit përqendrohen në plotësimin e nevojave urgjente të viktimave për kujdes masiv.
- Përpjekjet e rimëkëmbjes iniciohen njëkohësisht me aktivitetet e reagimit.
- Funksionet e FME 6 janë të ndara në tri fusha kryesore. Aktivitetet parimore për secilin funksion janë të përshkruara në seksionet vijuese.

Kujdesi masiv

Funksioni i kujdesit masiv i FME 6 përfshinë aktivitetet e përgjithshme të koordinimit, strehimit, ushqimit dhe aktivitetet tjera për mbështetjen e nevojave emergjente të viktimave siç përshkruhet në vijim:

- **Koordinimi:** Përfshinë koordinimin e asistencës qendrore në mbështetje të shërbimeve të kujdesit masiv jo mjekësor dhe grumbullimit të informacioneve lidhur me operacionet e strehimit dhe ushqimit në zonat e goditura.
- **Strehimi:** Strehimi emergjent përfshinë shfrytëzimin e vendeve të paracaktuara për strehim në strukturat ekzistuese, krijimin e hapësirave të përkohshme apo ndërtimin e përkohshëm të strehimoreve dhe shfrytëzimin e hapësirave të ngjashme jashtë zonës së incidentit, nëse evakuimi është i domosdoshëm.
- **Ushqimi:** Ushqimi për viktimat sigurohet përmes kombinimit të mjediseve fikse, njësive mobile të ushqimit dhe pikave për shpërndarjen e ushqimit. Operacionet e ushqyerjes janë të bazuara në standarde të forta ushqyese duke përfshirë plotësimin e nevojave të viktimave me nevoja të veçanta ditore deri në masën e mundshme.
- **Ndihma e parë emergjente:** Ndihma e parë emergjente që konsiston nga ndihma e parë elementare dhe përkatëse për shërbime dhe personel mjekësor, sigurohet në hapësirat e kujdesit masiv dhe në vendet e caktuara.
- **Informimi:** Informimi konsiston nga sigurimi i informacione që kanë të bëjnë me personat e mbetur brenda zonës së goditur për anëtarët e familjeve jashtë zonës së goditur. Kjo gjithashtu ndihmon edhe në ribashkimin e anëtarëve të familjeve brenda zonës së goditur.

Strehimi

Funksioni strehues i FME 6 adreson nevojat e viktimave në zonën e goditur dhe përmbushet përmes implementimit të programeve dhe shërbimeve të përcaktuara për:

- Sigurimin e asistencës për nevojat strehuese afatshkurta dhe afatgjata të viktimave.
- Identifikimin e faktorëve të ndryshëm të cilët do të mund të ndikonin në nevojat strehuese të lidhura me incidentin dhe ndihmesën në hartimin e planit të veprimit për sigurimin e asistencës strehuese në mënyrën më efektive, më të shpejt dhe efikase të mundshme të momentit.
- Identifikimin e zgjidhjeve për strehim afatshkurt dhe afatgjat për viktimat, sipas nevojës. Asistenca strehuese e siguruar për viktimat mund të përfshijë asistencë në qera, strehim të përkohshëm, hua për riparimin dhe/apo zëvendësimin e banesave, etj.

Shërbimet humane

Komponenti i shërbimeve humane i FME 6 implementon programet dhe ofron shërbime për të ndihmuar viktimat. Kjo përfshinë:

- Koordinimin dhe vlerësimin e situatës dhe implementimin e planit përkatës bazuar në resurset në dispozicion për t'i ndihmuar të gjitha viktimat.
- Mbështetjen e shërbimeve të ndryshme që ndikojnë në individ dhe pronar shtëpishë, përfshirë sistemin e koordinuar për adresimin e përpjekjeve të viktimave të lidhura me rimëkëmbje nga incidenti përmes shërbimeve të konsultave dhe shërbimeve tjera mbështetëse.
- Koordinimin dhe identifikimin e individëve me nevoja të veçanta brenda zonës së goditur, përfshirë njerëzit e moshuar, me të meta dhe njerëzit që komunikojnë me gjuhë tjetër përveq shqipes (përfshirë gjuhën e simboleve).
- Mbështetjen e asistencës së menjëhershme afatshkurte për individët, pronarët dhe grupet që merren me shqetësimet, streset dhe traumat e lidhura me fatkeqësitë, aktet e terrorizmit dhe/apo incidentet e dhunës kriminale masive.
- Mbështetjen e përpjekjeve qendrore, regjionale dhe lokale për sigurimin e asistencës dhe kompensimin e viktimave të krimit në incidentet që rezultojnë nga terrorizmi apo aktet e dhunës masive kriminale, sipas nevojës.
- Sigurimin që nevojat për shërbime të ujit dhe komoditeteve tjera emergjente shpërndahen tek entitetet e duhura.
- Sigurimin e mbështetjes për përsheptimin e shpërndarjes së postës në zonat e goditura.

Organizimi

Struktura Reaguese e Nivelit të Zyrës Qendrore

- Në vijim të aktivizimit të FME 6, agjencitë parësore mblidhen për vlerësimin e situatës dhe reagimit në të njëjtën kohë.
- Agjencitë parësore dhe mbështetëse janë në dispozicion mbi bazën “sipas nevojës” për kohëzgjatjen e periudhës së reagimit emergjent.
- FME 6 mund të siguroj përfaqësues për QOAME apo GNMI, sipas nevojës.

Struktura Reaguese e Nivelit Regjional

- Reagimi i nivelit regjional përfshin sigurimin e përfaqësuesve për Elementin Avancues të Ekipit të Reagimit Emergjent, seksionin e FME 6 në QOER, QBF dhe Qendrat e Rimëkëmbjes nga Fatkeqësitë (QRF).
- Aktivitetet në regjion normalisht fillojnë me aktivizim nga Koordinatori Regjional i AME-së. Me zhvillimin e situatës dhe përcaktimin se është e nevojshme asistencë qendrore, fillon edhe dislokimi tek vendet e reagimit.
- Ndërlidhja me FME-të tjera dhe/apo funksionet e lidhura përcaktohen dhe dislokohen nga agjencitë apo ministritë e tyre përkatëse, sipas nevojës.

- Ndërlidhësit nga agjencitë mbështetëse qendrore ndihmojnë seksionin e FME 6 në QOER dhe QBF sipas nevojës.

Veprimet: Fillestare

Niveli i Zyrës Qendrore

- Vlerëson situatën, vërteton kërkesat për resurse dhe parashikon nevojat për reagim.
- Siguron asistencë teknike për FME 6 të nivelit regjional dhe QOAME.
- Koordinon kërkesat e FME 6 për resurse me ministritë dhe agjencitë qendrore dhe QOAME.
- Vërteton kërkesat për resurse nga FME 6 e nivelit regjional.

Niveli Regjional

- Siguron asistencë teknike për mbështetjen e prioriteteve të incidentit.
- Vendos komunikim me strukturën reaguese të FME 6.
- Vlerëson situatën dhe përcakton përshtatshmërinë e aktiviteteve të reagimit dhe rimëkëmbjes.
- Siguron asistencë teknike për strukturat komunale të caktuara për kujdes masiv.
- Menaxhon procesin e kërkesave për asistencë qendrore.
- Siguron raporte për strukturën reaguese kombëtare të FME 6 dhe QBF-së.
- Parashikon kërkesat e ardhshme.

Veprimet: Në zhvillim

- Siguron udhëzime për identifikimin e resurseve të mundshme të strehimit.
- Punon me autoritetet qendrore, regjionale dhe lokale në hartimin e planit të rimëkëmbjes, sipas nevojës.
- Siguron mbështetje për konsulentë krizash, asistencë të të pa-angazhuarëve në fatkeqësi dhe shërbime juridike të fatkeqësisë.
- Asiston koordinimin dhe implementimin e programeve të ndihmave në fatkeqësi, sipas nevojës.

Përgjegjësitë

Koordinatori i FME-së: AME

- Aktivizon agjencitë e nevojshme mbështetëse.
- Koordinon aktivitetet logjistike dhe fiskale, me përgjegjësitë koordinuese të veçanta të FME-ve, për të siguruar mbështetje informuese dhe koordinative për agjencitë parësore dhe mbështetëse, sipas nevojës.
- Planifikon dhe mbështet takimet e rregullta me agjencitë parësore dhe mbështetëse lidhur me aktivitetet e parandalimit, gatishmërisë, reagimit dhe rimëkëmbjes.
- Siguron që agjencitë parësore dhe mbështetëse të jenë të informuara dhe përfshira në të gjitha takimet e lidhura me aktivitetet e FME 6.

Agjencitë parësore: AME dhe Kryqi i Kuq i Kosovës

- Siguron leadership në koordinimin dhe integrimin e tërësisë së përpjekjeve qendrore të lidhura me kujdesin masiv, strehimin dhe shërbimet humane.
- Për qëllime të planit të reagimit kombëtar, Kryqi i Kuq i Kosovës funksionon si organizatë parësore e FME 6 në koordinimin e shfrytëzimit të resurseve qendrore të kujdesit masiv në kontekst të incidenteve të karakterit kombëtar. Për qëllime të FME 6, çdo referim në ministritë dhe agjencitë qendrore me respekt për përgjegjësitë dhe aktivitetet e reagimit ndaj një Incidenti me Karakter Kombëtar përfshinë Kryqin e Kuq të Kosovës.

AME: Si agjenci parësore për aktivitetet e rimëkëmbjes në vijim të fatkeqësisë apo emergjencës Divizioni i Koordinimit të Operacioneve të Rimëkëmbjes i AME-së siguron staf të FME 6 në mjediset e caktuara, sipas nevojës.

- Ndhmon dhe koordinon shpërndarjen e informacioneve për njoftimin e të afërmëve.
- Ndhmon në vendosjen a prioriteteve dhe koordinimin e operacioneve të kujdesit masiv me aktivitetet e rimëkëmbjes bazuar në informacionet e incidentit dhe disponueshmërisë së resurseve për tu angazhuar sipas nevojës.
- Siguron resurset si: shtretërit, bataniet, ushqimet e gatshme, resurset tjera fillestare reaguese dhe mbështetjen logjistike përfshirë komunikimin, sipas nevojës.
- Ndhmon në furnizimin me artikuj dhe shërbime mjekësore.

Kryqi i Kuq i Kosovës: KKK si agjenci primare për kujdes masiv nën FME 6 koordinon asistencën qendrore të kujdesit masiv në mbështetje të përpjekjeve regjionale dhe lokale të kujdesit masiv.

Tranzicioni: Me plotësimin e aktiviteteve primare të reagimit, prioritetet e menaxhmentit të incidentit kalojnë në rimëkëmbje. FME 6 siguron procedura për të siguruar që:

- Tranzicioni të përcaktohet reciprokisht nga agjencitë parësore.
- Stafi i KKK-së mbetet aktiv gjatë fazës fillestare të aktiviteteve të rimëkëmbjes për tu siguruar që të gjitha çështjet e reagimit emergjent janë adresuar dhe për të mbështetur tranzicionin e çështjeve dhe përgjegjësitë të lidhura.

- Derisa elementi i kujdesit masiv i FME 6 demobilizohet, AME vazhdon t'i koordinoj elementet e strehimit dhe shërbimeve humane.

Agjencitë mbështetëse

Të gjitha agjencitë mbështetëse të FME 6 duhet të sigurojnë që agjencitë primare janë të njohura me funksionet dhe aktivitetet e të gjitha entiteteve pjesëmarrëse.

Agjencia	Funksioni
Ministria e Tregëtisë dhe Industrisë	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Ofron rezervat e artikujve ushqimor, përfshirë rezervat e artikujve ushqimor në pronësi qendrore për plotësimin e nevojave në zonën e incidentit. ▪ Siguron statistika lidhur me sasinë dhe vendndodhjen e ushqimit. ▪ Siguron asistencë tjetër të artikujve ushqimor në pajtueshmëri me FME 11 – Resurset Bujqësore dhe Natyrore.
Ministria e FSK-së Njësia e Xhenios e FSK-së	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Plotëson nevojat e kujdesit masiv për ujë në koordinim me elementet e kujdesit masiv të FME 6. ▪ Siguron asistencë duke inspektuar hapësirat e strehimoreve të kujdesit masiv për të siguruar përputhshmëri të shërbimeve për strehimin e sigurt të viktimave. ▪ Siguron asistencë në ndërtimin e hapësirave të përkohshme të strehimit në zonat e goditura, sipas nevojës. <p>Siguron mbështetje të përkohshme të strehimit, siç janë strukturat e përkohshme dhe riparimi i përsheptuar i shtëpive të dëmtuara, sipas nevojës.</p>
Ministria e Shëndetësisë	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Siguron punëtor të MSH për plotësimin e personelit të caktuar për strehimore. ▪ Siguron shërbime të kujdesit mjekësor dhe shëndetit mental për popullatën e goditur qoftë brenda apo jashtë strehimoreve. ▪ Siguron informacione për të lënduarit. ▪ Siguron asistencë teknike për operacionet e strehimit të lidhura me ushqimin, drejtimin, furnizimin me ujë dhe hudhje të mbeturinave.

	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Asiston në pajisjen me furnizime dhe shërbime mjekësore.
Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Siguron informacione mbi njësitë e disponueshme të strehimit banesor, në pronësi apo në shfrytëzim të MMPH-së, brenda apo afër zonës së incidentit për përdorim si strehimore të përkohshme dhe strehim të përkohshëm. ▪ Siguron staf të MMPH-së në dispozicion për të asistuar kur nevojitet në operacionet e kujdesit masiv dhe strehimit.

Agjencia	Funksioni
Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale	Siguron asistencë sociale dhe përkujdesje për mirëqenien dhe çështjet e sigurisë së punëtorëve
Ministria e Transportit dhe Post-Telekomunikacionit	Siguron koordinimin e resurseve të transportit, informacione për autorrugët dhe resurset tjera të lidhura me mbështetjen e aktiviteteve të transportit
Ministria e Administratës Publike	Siguron mbështetje administrative logjistike për nevojat e kujdesit masiv sipas nevojës.
Agjencia e ushqimit dhe veterinarisë	Ofrom kontroll të cilësisë së ushqimit.
Shërbimi Postal i Kosovës	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Pajis viktimat me formular për ndryshim të adresave për njoftimin e shërbimit të shpërndarjes së postës për adresat e reja dhe ndihmon në shpërndarjen, grumbullimin dhe dërgimin e atyre formularëve. ▪ Siguron dosje elektronike për informacionet e dërguara nga viktimat për ndryshimin e adresave
Organizatrat Vullnetare	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Ndihmojnë dhe inkurajojnë bashkëpunimin, komunikimin dhe koordinimin dhe ndërtojnë marrëdhënie midis anëtarëve derisa planifikojnë në grup dhe përgatiten për emergjenca dhe incidente fatkeqe. ▪ Ndihmojnë shkëmbimin e informacioneve gjatë dhe pas incidentit. ▪ Sigurojnë informacione përkatëse me ashpërsinë e fatkeqësisë, nevojat e përcaktuara dhe veprimet e “ndihmësve” përgjatë procesit të reagimit, ndihmës dhe rimëkëmbjes. ▪ Sigurojnë udhëzime në shkëmbimin e informacioneve për klientët, menaxhim të kujdesit shpirtëror dhe emocional të vullnetarëve dhe të mirave të dhuruara sipas nevojës.

Anekset për Incidente

Faqja e anekseve për incidente

Parathënie

Incidenti katastrofik

Incidenti me vajra dhe materie të rrezikshme

Incidenti biologjik

Incidenti kibernetik

Incidenti bujqësor

Incidenti nuklear/radiologjik

Incidenti terrorist

PARATHËNIE

Qëllimi

Ky paragraf ofron një përshkrim të anekseve të aplikueshme për situatat të cilat kërkojnë implementimin të veçantë dhe të specializuar të Planit të Reagimit Kombëtar (PRK) për incidentin e caktuar.

Historiku

Anekset për incidente adresojnë situatat e rastësishme apo të rrezikshme që kërkojnë aplikim të specializuar të PRK-së. Anekset e këtij paragrafi në vijim adresojnë situatat në vijim:

- Incidentin katastrofik
- Incidentin me vajra dhe materie të rrezikshme

Anekset për incident janë të organizuar sipas rendit alfabetik. Politikat dhe procedurat në aneksin për incidentin katastrofik janë gjithëpërfshirëse dhe të aplikueshme për të gjitha rreziqet. Gjithashtu, edhe mekanizmat në aneksin për incidentin terrorist aplikohen kur terrorizmi shoqëron cilindo incident.

PËRMBAJTJA E ANEKSEVE PËR INCIDENT

Anekset përshkruajnë politikat, situatat, konceptin e veprimeve dhe përgjegjësitë përkatëse për llojin e incidentit në fjalë.

Politikat: Secili aneks shpjegon autorizimet unike përkatëse për incidentin, veprimet speciale apo deklaratat që mund të rezultojnë dhe çdo politikë të veçantë që mund të aplikohet.

Situata: Secili aneks përshkruan gjendjen e incidentit si dhe supozimet për planifikim dhe përvijon qasjen e cila do të përdoret nëse supozimet kryesore nuk qëndrojnë (për shembull, si do të operojnë autoritetet nëse e humbin komunikimin me vendimmarrësit gjegjësisht me eproret).

Koncepti i veprimeve: Secili aneks përshkruan konceptin e veprimeve të përshtatshme për incidentin, integrimin e veprimeve me elementet e PRK-së, aspektet e veçanta të qasjes organizative, proceset e njoftimit dhe aktivizimit dhe veprimet e specializuara të lidhura për incidentin.

Gjithashtu, secili aneks detajizon strukturat koordinuese dhe pozitat e autoriteteve të cilat janë unike për llojin e incidentit, ekipet e specializuara të reagimit apo resurset unike të nevojshme dhe konsideratat tjera të veçanta/speciale.

Përgjegjësitë: Secili aneks përcakton agjencitë koordinuese dhe bashkëpunuese të përfshira në një reagim të veçantë në incident, në disa raste këto përgjegjësi përmbushen nga dy e më tepër institucione bashkërisht.

Natyra gjithëpërfshirëse e funksioneve e përshkruar në këto anekse përfshin ose mbështetjen ose bashkëpunimin e të gjitha institucioneve të përfshira në përpjekjet e menaxhimit të incidentit. Në disa raste, veprimet e detajizuara në aneks përfshijnë edhe komponentet e ndryshme të Ministrisë së Punëve të Brendshme (MPB) dhe të ministrive dhe agjencive tjera për të siguruar integrim të

lehtë të kalimit midis aktiviteteve të gatishmërisë, parandalimit, reagimit, rimëkëmbjes dhe zbutjes së rreziqeve.

Përgjegjësitë e agjencisë koordinuese dhe agjencive bashkëpunuese janë të përcaktuara në vijim.

Agjencia Koordinuese

Agjencitë koordinuese të përshkruara në anekset e PRK-së mbështesin misionin e MPB-së në menaxhimin e incidenteve duke ofruar leadership, ekspertizë dhe autoritete për implementimin e aspekteve kritike dhe specifike të reagimit. Agjencitë qendrore të caktuara si agjenci koordinuese janë përgjegjëse (në bashkëpunim të ngushtë me MPB-në) për implementimin e proceseve të përvijuara në anekset në vijim. Në disa nga anekset për incidente siç janë ai kibër, nuklear/radiologjik dhe i vajrave dhe materieve të rrezikshme, renditin agjenci të shumta koordinuese. Në këto anekse përgjegjësitë e agjencisë koordinuese mund të ndahen apo delegohen bazuar në natyrën apo vendndodhjen e incidentit.

Agjencia koordinuese është përgjegjëse për:

- Organizimin e shpërndarjes së koordinuar të funksioneve dhe procedurave të përcaktuara në aneks;
- Sigurimin e stafit për funksionet operative në mjediset fikse dhe fushore;
- Njoftimin dhe ndarjen e detyrave për agjencitë bashkëpunuese;
- Menaxhimin e detyrave me agjencitë bashkëpunuese;
- Të punuarit me organizatat përkatëse të sektorit privat për shfrytëzimin maksimal të resurseve të disponueshme;
- Mbështetjen dhe informimin e FME-ve dhe elementeve tjera organizative lidhur me aktivitetet e aneksit;
- Planifikimin për mbështetjen afatshkurte dhe afatgjate të operacioneve të menaxhimit të incidentit dhe operacioneve të rimëkëmbjes dhe
- Mirëmbajtje të personelit të trajnuar për të ofruar mbështetjen përkatëse.

Agjencitë bashkëpunuese

Agjencia koordinuese do t'i njoftoj agjencitë bashkëpunuese atëherë kur nevojitet asistencë e tyre. Agjencitë bashkëpunuese janë përgjegjëse për:

- Zhvillimin e operacioneve, kur kërkohen nga MPB-ja apo agjencia koordinuese, me përdorimin e autoritetit, ekspertëve, kapaciteteve dhe resurseve të tyre vetjake;
- Pjesëmarrje në planifikimin për menaxhimin e incidentit dhe operacionet e rimëkëmbjes dhe hartimin e planeve mbështetëse operative, procedurave standarde operative, listave kontrolluese etj.;
- Furnizimin me personel, pajisje dhe resurse tjera mbështetëse të disponueshme sipas kërkesës së MPB-së apo koordinatorit të Aneksit për Incident;
- Pjesëmarrje në trajnime dhe ushtrime të destinuara për përmirësimin e vazhdueshëm të kapaciteteve të parandalimit, reagimit si dhe rimëkëmbjes; dhe
- Propozimin e teknologjive dhe procedurave të reja për përmirësimin e performancës.
- Kur kërkohet dhe miratohet nga Ministri i Ministrisë së Forcës së Sigurisë së Kosovës (MFSK), MFSK ofron mbështetjen të FSK-së për autoritetet civile gjatë incidenteve vendore. Në përputhje me rrethanat, MFSK konsiderohet agjenci bashkëpunuese për shumicën e Anekseve për Incidente.

Aneksi për Incidentin Katastrofik

Agjencia Koordinuese: Ministria e Punëve të Brendshme	Agjencitë Bashkëpunuese: Të gjitha ministrinë dhe agjencitë qendrore (dhe organizatat tjera) të ngarkuara me përgjegjësi parësore apo mbështetëse të Funkcionit Mbështetës Emergjent (FME)
-----------------------------------------------------------------	------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------

Hyrje

Qëllimi

- Aneksi për Incidentin Katastrofik i PRK-së vendos kontekstin dhe strategjinë e përgjithshme për implementimin dhe koordinimin e një reagimi të shpejtë dhe proaktiv kombëtar ndaj një incidenti katastrofik.
- Një Aneks Plotësues më i Detajizuar (APD) dhe më specifik në aspektin operativ i cili është i destinuar “VETËM PËR PËRDORIM ZYRTAR” do të miratohet dhe publikohet i pavarur nga Plani Themelor dhe Aneksat e PRK-së.

Shtrirja

- Incidenti katastrofik sipas PRK-së, është një incident natyror apo i shkaktuar nga faktori njeri (përfshirë terrorizmin) i cili rezulton në nivele të jashtëzakonshme të lëndimeve në masë, dëmeve apo çrregullime të mëdha të popullatës, infrastrukturës, mjedisit, ekonomisë, moralit kombëtar apo funksioneve qeveritare. Incidenti katastrofik mund të rezultoj në efektë të gjatë kombëtar për një periudh kohore të zgjatur, pothuajse menjëherë tejkalon resurset në dispozicion të autoriteteve të niveleve regjionale dhe lokale dhe të sektorit privat të zonës së goditur dhe pengon dukshëm operacionet qeverisëse dhe shërbimet emergjente në masën e cila mund ta rrezikoj edhe sigurinë kombëtare. Të gjitha incidentet katastrofike janë të Karakterit Kombëtar. Këta faktor diktojnë urgjencën për planifikim të koordinuar kombëtar për sigurimin e shpejtë të asistencës qendrore.
- Duke e ditur se resurset qendrore/kombëtar janë të nevojshme për plotësimin e përpjekjeve reaguese regjionale dhe lokale, aneksi për incidente katastrofike vernds prokollet për parapërcaktimin dhe dislokimin e shpejtë të resurseve kyçe esenciale (si: ekipet mjekësore, njësitë e kërkim shpëtimit urban, strehimoret lëvizëse, pajisjet e mjekësore, etj.) që parashihen të jenë të nevojshme me urgjencë për shpëtimin e jetëve dhe frenimin e incidenteve.
- Në përputhje me rrethanat, pas përcaktimit të incidentit si katastrofik nga Ministri i MPB-së, resurset qendrore të organizuara në “pako” specifike për incidente dislokohen në përputhje me aneksin për incident katastrofik të PRK-së në koordinim me zonën e goditur dhe strukturën e komandës në incident.

Politikat

- Strategjia e aneksit për incident katastrofik është në pajtim me protokollat e PRK-së dhe Sistemit të Integruar të Menaxhimit të Emergjencave (SIME).
- Vetëm ministri i MPB-së ose i autorizuar prej tij mund të inicioj implementimin e aneksit.
- Gjatë mobilizimit dhe dislokimit të gjitha resurset qendrore të dislokuara, mbesin nën kontrollin e ministrisë apo agjencisë përkatëse.
- Resurset qendrore që arrijnë në qendër mobilizuese apo zonë të grumbullimit mbesin aty derisa të kërkohen nga autoritetet e komandës së incidentit për tu integruar në përpjekjet e reagimit ndaj incidentit.
- Ndodhia apo kërcënimi i incidenteve të shumëllojshme katastrofike mund ta zvogëlojë dukshëm madhësinë, shpejtësinë dhe intensitetin e reagimit qendror. Nëse mendohet e domosdoshme dhe e matur qeveria qendrore mund ta zvogëlojë prezencën dhe alokimin e resurseve kur ngjarjet e shumta konkurojnë për të njëjtat resurse, apo mund t'i mbajë disa resurse në rezervë për raste të incidenteve tjera shtesë.

Situata

Rrethanat e incidentit: Për adresimin e gamës së nevojave urgjente të incidentit mund të zgjerohen apo përforcohen procedurat e zakonshme të FME-ve të caktuara. Të gjitha FME-të duhet t'i eksplorojnë ekonomitë për maksimalizimin e përdorimit dhe efikasitetit të resurseve të pamjaftueshme. Në rastin e incidentit katastrofik parashikohet që qeveria qendrore apo entitetet tjera kombëtare ofrojnë asistencë të përsheptuar në një apo më shumë fusha në vijim:

- **Kujdes masiv, strehim dhe shërbime humane (FME 6):** Mundësia për të siguruar strehim të përkohshëm, ushqim, ndihmë të parë emergjente, veshëmbathje dhe ndihmë tjetër esenciale jetësore për njerëzit mund të jetë e komplikuar nga burimet kontaminuese të objekteve.
- **Kërkim shpëtimi urban (FME 9):** Resurset dhe personeli për zbatimin e aktiviteteve operative (si: gjetja, nxjerrja dhe sigurimi i ndihmës mjekësore në vendndodhje për viktimat e ngujuara në strukturat e rrënuara) janë të kufizuara.
- **Dekontaminimi (FME-të 8 dhe 10):** Incidentet që përfshijnë armët e shkatërrimit në masë (ASHM) mund të kërkojnë dekontaminimin e të plagosurve, evakuuarëve, kafshëve, pajisjeve, ndërtesave, infrastrukturës kritike dhe mjediseve tjera. Duke pas parasysh mundësin e numrit të madh të të plagosurve dhe të evakuuarëve, nevojat pasuese të dekontaminimit shumë shpejtë mund t'i tejkalojnë kapacitetet regjionale dhe lokale.
- **Shëndeti publik dhe ndihma mjekësore (FME 8):** Ekziston nevojë domethënëse për shëndet publik dhe ndihmë mjekësore, përfshirë shërbimet e shëndetit mendor. Ndihma mjekësore është e nevojshme jo vetëm në objektet mjekësore, por në pikat e evakuimit të të plagosurve, në pikat dhe strehimoret e të evakuuarëve dhe të refugjatëve dhe në lokacionet tjera për mbështetjen e operacioneve fushore. Për më tepër çdo nevojë kontaminuese rrit nevojën për asistencë teknike.

- **Pajisjet dhe furnizimet mjekësore (FME 8):** ekziston nevoja për sasi të mjaftueshme të preparateve farmaceutike për qëllime parandaluese dhe terapeutike, si dhe personel të kualifikuar mjekësor. Sigurimi i vaksinave për parandalim të sëmundjeve të caktuara ngjitëse që mund të paraqiten gjatë katastrofave.
- **Menaxhimi dhe transportimi i të plagosurve dhe të vdekurve (FME 8):** resurset qendrore mund të kërkohen për zbatimin e menaxhimit të transportit dhe kujdesit për viktimat e sëmura, plagosura apo ekspozuara, nëse numri i tyre është jashtëzakonisht i madh. Për më tepër, numri i pafund i të plagosurve ka gjasa t'i mbingarkoj kapacitetet në dispozicion të shërbimeve mjekësore regjionale dhe lokale.
- **Informimi publik (FME 15):** Kur kanalet regjionale dhe lokale të komunikimit publik mbingarkohen gjatë incidentit katastrofik, qeveria qendrore duhet menjëherë të siguroj resurse për të ndihmuar në shpërndarjen e informacioneve, udhëzimeve dhe mesazheve të besueshme të sakta dhe koherente në zonat e goditura.

Parashikimet e planifikuara

- Incidenti katastrofik rezulton në numër të madh (me gjasë dhjeta mija) të të plagosurve dhe numër të madh të personave të zhvendosur.
- Ministri i MPB-së e përcakton ngjarjen Incident të Karakterit Kombëtar dhe urdhëron implementimin e Aneksit për Incident Katastrofik të PRK-së.
- Incidenti katastrofik me të plagosur/evakuuar në masë dikton menjëherë shpalljen e gjendjes emergjente, menjëher apo ndryshe.
- Natyra dhe shtrirja e incidentit katastrofik mund të përfshijë sulmet kimike, biologjike, radiologjike, nukleare apo sulmet me mjete eksplozive të sofistikuar, sëmundjet epidemike dhe rreziqet natyrore dhe të shkaktuara nga faktori njeri.
- Në të njëjtën kohë apo një pas një mund të ndodhin incidente të shumta apo të shumëfishta. Disa incidente si ato të armëve biologjike të shkatërrimit në masë mund të përhapen në hapësira të mëdha gjeografike dhe vështirësojnë përcaktimin e vendit të incidentit.
- Incidenti katastrofik mund të ndodh me pak apo fare paralajmërim. Disa incidente si shpërthimi i shpejtë i sëmundjeve mund të shtrihen bukur mirë përpara se të jenë zbuluar.
- Incidenti mund të shkaktoj çrregullime domethënëse të infrastrukturës kritike të zonës, siç janë energjia, transporti, telekomunikimi dhe shëndeti publik.
- Kapacitetet dhe resurset reaguese të juridiksionit lokal (duke përfshirë ndihmën reciproke të juridiksioneve fqinje lokale dhe regjionale) mund të jenë të pamjaftueshme dhe të mbingarkuara shumë shpejtë. Personeli emergjent lokal i cili zakonisht reagon ndaj incidenteve mund të jetë midis të goditurve dhe detyrimisht në pamundësi të detyrave.
- Pasqyra e përbashkët operative e hollësishme dhe e besueshme mund të mos jetë e arritshme për 24 deri 48 orë (apo edhe më tepër) pas incidentit. Për pasojë, aktivitetet e

reagimit duhet të fillojnë në munges të të dhënave të hollësishme për situatën e plotë dhe në munges të vlerësimit të nevojave kritike.

- Ndhurma qendrore duhet të ofrohet me kohë për t'i shpëtuar jetët, parandalimin e vuajtjeve njerëzore dhe zbutjen e dëmeve të ashpra. Kjo mund të kërkohet mobilizimin dhe dislokimin e aseteve para se të kërkohen përmes protokolleve të zakonshme të PRK-së.
- Mund të ndodhin evakuime të shkallës së gjerë, të organizuara apo vetorganizuara. Fillimisht njerëzit janë më të prirur të kërkojnë strehim nga sulmet që përfshijnë elemente kimike, biologjike, radiologjike apo nukleare se sa për ngjarjet natyrore. Implikimet e incidentit të lidhura për shëndetin përkeqësojnë orvatjet për implementimin e strategjisë së koordinuar për menaxhimin e evakuimit.
- Numër i madh i njerëzve mund të mbesin përkohësisht apo përgjithëmon pa shtëpi dhe mund të kërkojnë strehim të përkohshëm për kohë të gjatë.
- Incidenti katastrofik mund të prodhojë efekt mjedisor (si kontaminim të përhershëm kimik, biologjik apo radiologjik) i cili sfidon ashpër mundësinë dhe kapacitetin e qeverive dhe komuniteteve për tu rimëkëmbur me kohë.
- Incidenti katastrofik ka dimensione dhe karakteristika unike që kërkojnë që planet dhe strategjitë reaguese të jenë mjaftë fleksibile për adresimin e nevojave dhe kërkesave në rritje me efikasitet të plotë.
- Incidenti katastrofik mund të ketë dimensione domethënëse ndërkombëtare. Kjo përfshinë efektet e mundshme në shëndetin dhe mirëqenien e popullatës së komunitetit kufitar, tregëtin ndërkufitare, qarkullim, koordinim të zbatimit të ligjit dhe në fusha tjera.
- Nëse incidenti është rezultat i terrorizmit, sipas të gjitha gjasave niveli i alarmit do të rritet në nivel regjional dhe në atë kombëtar. Ngritja e nivelit të alarmit bartë në vete shtimin e masave të sigurisë të cilat mund të ndikojnë në disponueshmërinë e resurseve të caktuara reaguese.

Koncepti i veprimit

Reagimi i nivelit lokal dhe regjional: Operacionet dhe përgjegjësitë e nivelit lokal dhe regjional janë të mbuluaara në PRK dhe APD. Ky aneks adreson reagimin proaktiv qendror për tu ndërmarr në pritje të një incidenti katastrofik apo në vijim të tij, me qëllim të sigurimit të shpejtë të resurseve kritike për t'i ndihmuar dhe plotësuar përpjekjet reaguese të nivelit lokal dhe regjional.

Reagimi qendror

- Në pajtim me dispozitat e PRK-së për reagim qendror proaktiv ndaj incidenteve katastrofike Aneksi për Incidente Katastrofike i PRK-së vë në përdorim një qasje të përsheptuar ndaj përfitimit të resurseve qendrore për shpëtimin e jetëve të njerëzve dhe frenimin e incidentit.
- Parimet udhëzuese për reagim qendror proaktiv ndaj incidenteve katastrofike përfshijnë me sa vijon:

- Misioni parësor është shpëtimi i jetëve, mbrojtja e të mirave materiale dhe infrastrukturës kritike, frenimi i ngjarjes dhe mbrojtja e sigurisë kombëtare;
 - Procedurat standarde të përvijuara në PRK lidhur me kërkesat për asistencë mund të përshpejtohen apo në rrethana të jashtëzakonshme, të suspendohen përkohësisht në pragun e hershëm të një incidenti të gamës katastrofike, gjithëmonë sipas ligjeve ekzistuese;
 - Resurset qendrore reaguese të paracaktuara mobilizohen dhe dislokohen si dhe nëse nevojitet, fillojnë operacionet emergjente për nisjen e aktiviteteve të shpëtimit të jetës dhe
 - Bëhet njoftimi dhe koordinimi i plotë me regjionet, mirëpo procesi i koordinimit nuk duhet ta vonojë apo pengoj mobilizimin dhe dislokimin e shpejtë të resurseve kritike qendrore.
- Pas pranimit se ekzistojnë kushtet e incidentit katastrofik (si përfshirja e të plagosurve apo të evakuuarëve në masë), Ministri i MPB-së menjëherë e përcakton ngjarjen si Incident të Karakterit Kombëtar dhe fillon (para shpalljes së gjendjes emergjente) implementimin e Aneksit të PRK-së për incidentet katastrofike. Me tu njoftuar nga Qendra Operative e Ministrisë së Punëve të Brendshme (QOMP) që Aneksi i PRK-së për Incidente Katastrofike është implementuar, ministrinë dhe agjencitë qendrore:
 - Ndërmarrin veprime të menjëhershme për aktivizimin, mobilizimin dhe dislokimin e resurseve specifike për incidentin në pajtueshmëri me APD-PRK;
 - Ndërmarrin veprime të menjëhershme për mbrojtjen e jetëve, të mirave materiale dhe infrastrukturës kritike nën juridiksionin e tyre si dhe ofrojnë ndihmë në zonën e goditur;
 - Menjëherë fillojnë aktivitetet specifike për rrezikun të vendosura sipas Aneskeve përkatëse për Incidente, përfshirë Aneksin për Incident Katastrofik dhe
 - Menjëherë fillojnë aktivitetet funksionale dhe përgjegjësitë të caktuara në Aneksin e FME-ve të PRK-së.
 - Veprimet e Aneksit për Incidente Katastrofike të cilat i ndërmerr qeveria qendrore në reagim ndaj incidentit katastrofik përfshinë:
 - Të gjitha ministrinë, agjencitë qendrore dhe Kryqi i Kuq i Kosovës i fillojnë veprimet për mobilizimin dhe dislokimin e resurseve sipas planit në Aneksi i Planit të detajizuar-PRK;
 - Të gjitha ministrinë, agjencitë dhe organizatat (si Kryqi i Kuq i Kosovës) të ngarkuara me përgjegjësi parësore apo mbështetëse të FME-ve menjëherë fillojnë zbatimin e këtyre përgjegjësiave, sipas nevojës apo kur urdhërohen;
 - Resurset dhe kapacitetet specifike për incidentin (si: ekipet mjekësore, ekipet e kërkimit dhe shpëtimit, pajisjet, stehimoret lëvizëse, medikamentet preventive dhe terapeutike, etj.) aktivizohen dhe përgatiten për dislokim në qendrën e mobilizimit apo pikën e grumbullimit afër vendit të incidentit;

- Objektet qendrore në nivelin regjional (si: spitalet) aktivizohen dhe përgatiten për t'i pranuar dhe trajtuar të plagosurit nga zona e incidentit. Objektet qendrore regjionale udhëzohen t'i riorganizojnë prioritetet e shërbimit (në disa raste t'i zvogëlojnë apo pezullojnë shërbimet e caktuara të rregullta) derisa të kryhen aktivitetet e shpëtimit të jetëve;
- Aktivizohen marrveshjet shtesë për mbështetje me sektorin privat dhe
- Duke pas parasysh kërkesat e larta për mbështetje qendrore sikurse edhe implikimet e mundshme të sigurisë kombëtare të incidenteve katastrofike, ministrive dhe agjencive qendrore mund tu kërkohet që t'i ri-drejtojnë përpjekjet e tyre të përditshme kahë mbështetja e përpjekjeve të reagimit.

Përgjegjësitë

Ky paragraf përmbledh përgjegjësit e ministrive dhe agjencive qendrore sipas Aneksit të PRK-së për Incidente Katastrofike. Për listën e plotë të përgjegjësive të ministrive dhe agjencive qendrore sipas AIK të PRK-së referojuni APD të PRK-së, i cili është i përcaktuar VETËM PËR PËRDORIM ZYRTAR dhe mbahet si dokument i veçantë. Për përgjegjësitë shtesë të ministrive dhe agjencive qendrore referojuni anekseve veç e veç të FME-ve dhe anekseve specifike për rreziqe në PRK.

Agjencia Koordinuese: Ministria e Punëve të Brendshme (MPB)

- Vendos se incidenti katastrofik ka ndodh dhe implementon AIK të PRK-së.
- Njofton ministrinë dhe agjencinë qendrore për implementimin e AIK të PRK-së dhe APD të PRK-së.
- Me implementimin e AIK-PRK:
 - Aktivizon dhe dislokton (ose përgatit për dislokim) ekipet e menaxhuara nga MPB-ja, pajisjet dhe resurset tjera në pajtim me APD-PRK;
 - Përcakton, përgatit dhe operacionalizon objektet/shërbimet kritike për mbështetjen e lëvizjes dhe pranimin e resurseve të dislokuara qendrore; Aktivizon shërbimet/objektet dhe kapacitetet e nivelit kombëtar në pajtim me APD-PRK dhe protokollat standarde të PRK-së;
 - Vendos dhe mban komunikim me autoritetet e komandës së incidentit për të siguruar pasqyrë operative të saktë dhe të përbashkët lidhur me kërkesat e resurseve kritike. Ashtu siç përcaktohen kërkesat specifike të resurseve, këshillon Ministrinë e Transportit dhe Telekomunikacionit për t'i ri-organizuar dhe përshtat prioritetet në raport me rrafshin e rrjedhjes së resurseve në APD-PRK dhe
 - Bënë çdo orvatje për vendosjen e kontaktit me zonën (at) e goditur për ta koordinuar angazhimin e resurseve qendrore në mbështetje të zonës përkatëse.

Agjencitë Bashkëpunuese

- Kur njoftohen nga QOMPB-së që Ministri i MPB-së ka implemtuar AIK-PRK, ministrinë dhe agjencitë qendrore (dhe Kryqi i Kuq i Kosovës):
 - Aktivizojnë dhe dislokojnë (ose përgatiten t'i dislokojnë) ekipet, pajisjet dhe resurset tjera të tyre në pajtim me APD-PRK;
 - Fillojnë zbatimin e përgjegjësi të FME sipas nevojës;
 - Fillojnë vlerësimin e pasojave të mundshme të incidentit dhe nevojat e parapara të resurseve dhe
 - Fillojnë hartimin e strategjive afatshkurta dhe afatgjata të reagimit dhe rimëkëmbjes.
- APD-PRK ofron listën e veprimeve specifike të cilat inicohen me aktivizimin e AIK-PRK. Ministrive, agjencive qendrore dhe organizatave tjera në vijim u janë caktuar përgjegjësi specifike si agjenci bashkëpunuese:
 - Ministrisë së Bujqësisë;
 - Ministrisë së FSK-së;
 - Ministrisë së Energjisë;
 - Ministrisë së Shëndetësisë;
 - Ministrisë së Punëve të Brendshme;
 - Ministrisë së Transportit;
 - Ministria e Mjedist dhe Planifikimit Hapësinor;
 - Kryqit të Kuq të Kosovës.
- Ministrinë dhe agjencitë e ngarkuara me përgjegjësi parësore për një apo më shumë fusha funksionale sipas shtojcave të APD-PRK janë të përcaktuara në vijim.
 - **Kujdesi masiv:** Kryqi i Kuq i Kosovës
 - **Kërkimi dhe shpëtimi:** Ministria e Forcës së Sigurisë, (dhe MPB)
 - **Dekontaminimi:** Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Forcës dhe Sigurisë.
 - **Shëndeti publik dhe ndihma mjekësore:** Ministria e Shëndetësisë.
 - **Furnizimet dhe pajisjet mjekësore:** Ministria e Shëndetësisë.
 - **Lëvizja e pacientëve:** Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e FSK-së.
 - **Vdekjet masive:** Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Punëve të Brendshme dhe Ministria e Forcës së Sigurisë.
 - **Strehimi:** Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.
 - **Komunikimi për incident dhe publik:** Ministria e Punëve të Brendshme.

- **Transporti:** Ministria e Transportit.
- **Ndihma e sektorit privat:** Ministria e Punëve të Brendshme.
- **Logjistika:** Ministria e Punëve të Brendshme.

Aneksi për incidentet me vajra dhe materie të rrezikshme

Agjencitë Koordinuese:

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit
Hapësinor;
Ministria e Punëve të Brendshme;

Agjencitë Bashkëpunuese:

Ministria e Bujqësisë
Ministria e Ekonomisë
Ministria e FSK-së
Ministria e Energjisë
Ministria e Shëndetësisë
Ministria e Punëve të Brendshme
Ministria e Drejtësisë
Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
Ministria e Punëve të Jashtme
Ministria e Transportit
Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
Ministria e Administratës Publike
Komisioni Rregullativ Nuklear

Hyrje

Qëllimi

Ky aneks përshkruan rolet, përgjegjësitë dhe mekanizmat koordinues për menaxhimin e incidenteve të ndotjes me vajra dhe materie të caktuara të rrezikshme të cilët përcaktohen si incidente të karakterit kombëtar. Ky aneks adreson ato incidente të vajrave dhe materieve të rrezikshme të Karakterit Kombëtar të cilat menaxhohen me implementimin konkurrent të Planit të reagimit Kombëtar dhe Planit Kontigjent Kombëtar por nuk janë aktivizim i FME 10 – Reagimi ndaj vajrave dhe materieve të rrezikshme. Procedurat për incidentet me vajra dhe materie të rrezikshme të karakterit kombëtar për të cilat FME 10 është i aktivizuar adresohen në aneksin FME 10.

Shtrirja

- PKK ofron struktur organizative dhe procedura për reagimin qendror ndaj rrjedhjeve të vajit dhe materieve të rrezikshme në Kosovë aksidentalisht apo me qëllim. PKK adreson parandalimin, planifikimin, reagimin dhe rimëkëmbjen nga incidenti.

Materiet e rrezikshme të adresuara sipas PKK-së përfshijnë substancat e caktuara të konsideruara armë të shkatërrimit në masë (si: agensat kimik, agensat biologjik dhe materiet radiologjike/nukleare).

- PKK vendos strukturat në nivelin qendror, regjional dhe lokal të cilat përdoren për të reaguar ndaj mijëra incidenteve në vit të cilët nuk arrijnë të ngriten në nivelin e një incidenti të karakterit kombëtar. Kur një incident i karakterit kombëtar ndodh, këto struktura të PKK-së mbesin në fuqi për të ofruar ekspertizë specifike për rreziqe dhe mbështetje. Ky aneks përshkruan mënyrën se si punojnë strukturat e PKK-së me strukturat koordinuese të PRK-së, gjatë incidenteve të karakterit kombëtar.

Politikat

- Është e pritshme që shumica e incidenteve të karakterit kombëtar që përfshijnë vajrat dhe materiet e rrezikshme menaxhohen përmes aktivizimit të FME 10, por është e mundur që incidentet e karakterit kombëtar që përfshijnë vajra dhe materie të rrezikshme mund të ndodhin dhe për të cilët nuk aktivizohet FME 10.
- Disa reagime ndaj vajrave dhe materieve të rrezikshme mund të inicohen vetëm sipas PKK-së apo sipas këtij aneksi si një incident i karakterit kombëtar, pastaj bëhet kalimi në FME 10 pas shpalljes sipas ligjit (ose/pasi FME 10 është aktivizuar përmesë mekanizmit të mbështetjes Brenda qeveritare të PRK-së). Koordinatorët qendror në vendngjarje (KQVN) kanë autoritet të pavarur sipas PKK-së për të reaguar ndaj incidenteve me vajra dhe materie të rrezikshme dhe mund të aktivizojnë aktivitete fillestare të reagimit para se Ministria e Punëve të Brendshme (MPB) të vendos nëse incidenti është i karakterit kombëtar para se të shpallet gjendja e jashtëzakonshme.
- Strukturat e PKK-së dhe mekanizmat reagues mbesin në fuqi gjatë incidenteve të karakterit kombëtar që përfshijnë një rrjedhje aktuale apo të mundshme të vajrave dhe materieve të rrezikshme dhe koordinojnë me mekanizmat e PRK-së sipas përshkrimit në këtë aneks.
- Sipas PKK-së, KVN zhvillon aktivitete reaguese nga niveli i Post Komandës së Incidentit (PKI). Sipas nevojës mund të ngritet Komanda e bashkuar me pjesëmarrjen e autoriteteve qendrore, regjionale dhe lokale. Autoritetet regjionale dhe lokale parimisht janë reaguesit fillestar ndaj një incidenti me vajra dhe materie të rrezikshme.
- PKK ofron faktin që Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapesinor (MMPH) mund ta klasifikoj një shkarkim vajrash si Rrjedhje me Karakter Kombëtar (REKK). Për REKK MMPH mund ta emëroj një “zyrtar të lartë të Ministrisë” i cili e ndihmon KVN-në, (apo merr përsipër disa funksione të KVN-së) respektivisht (komunikimin me palët e goditura dhe publikun, koordinimin e resurseve në nivelin kombëtar). MMPH mban autoritetin për klasifikimin e shkarkimit si REKK. MPB mban autoritetin për klasifikimin e një incidenti si Incident i Karakterit Kombëtar. REKK mund të jetë dhe të mos jetë Incident i Karakterit Kombëtar, varësisht nga përcaktimi i MPB-së.
- Dispozitat e PKK-së janë të përmbledhura në këtë aneks për qëllime të qartësisë. Referencat në këtë aneks për tek dispozitat e PKK-së nuk kanë për synim ndryshimin e kërkesave apo interpretimeve në PKK.
- Asgjë në PRK nuk i ndryshon apo pengon mundësitë dhe autoritetet e zyrtarëve të caktuar qendror për t'i kryer detyrat e tyre sipas PKK-së apo për të koordinuar drejtpërsëdrejti me agjencinë e tyre në zbatimin e këtyre detyrave.
- Një incident i Karakterit Kombëtar që përfshinë vajrat apo materiet e rrezikshme e i cili është rezultat i aktit kriminal apo rezulton në aktin kriminal por që nuk është akt terroristë, hetohet nga Inspektorët për Mbrojtjen e Mjedisit të MMPH-së në koordinim me KVN-në dhe Zyrtarin e Autorizuar Qendror (IDM). Në këtë rast, Zyrtari Special i MMPH-së shërben si zyrtar kryesor qendror i zbatimit të ligjit në Grupin Koordinues të Qendrës së Bashkuar Fushore (QBF).

Koncepti i veprimit

Ekipi i Reagimit Qendror i PKK-së (ERQ): Sipas PKK-së ERQ koordinon programin për gatishmëri, planifikim dhe reagim ndaj incidenteve me vajra dhe materie të rrezikshme në nivelin lokal, regjional dhe qendror; ndihmon kërkimet për përmirësimin e aktivitetet e reagimit dhe ofron asistencë për reagimet ndaj incidenteve specifike sipas nevojës. ERQ është i përbërë prej të gjitha agjencive qendrore me përgjegjësi dhe kapacitete në gatishmëri, planifikim dhe reagim ndaj incidenteve me vajra dhe materie të rrezikshme. Në baza ditore MMPH është udhëheqëse e ERQ-së dhe përfaqësuesi i AME shërben si zëvendës.

Gjatë një incidenti, drejtimi i ERQ-së kalon tek agjencia e cila siguron KVN-në të vendit të ngjarjes për të:

- Monitoruar dhe vlerësuar raportet nga KVN dhe për të rekomanduar veprimet e nevojshme, nëpërmjet e Ekipit Reagues Regjional (ERR), për ta adresuar rrjedhjen;
- Kërkuar nga niveli qendror, regjional dhe lokal apo sektori privat që të ofrojnë resurse dhe
- Koordinuar furnizimin me pajisje, personel apo këshilla teknike për juridiksionin e goditur.

Ekipe e Reagimit Reagjional PKK: PKK gjithashtu themelon 5 ERR për të koordinuar gatishmërinë, planifikimin dhe reagimin në nivel regjional dhe kërkon Komitetet regjionale të përbërë nga reaguesit lokal, regjional, qendror dhe të sektorit privat për ta koordinuar gatishmërinë dhe planifikimin në nivel lokal.

Në baza ditore ERR-në e bashkëkryesojnë MMPH dhe MPB. Kur aktivizohet në mbështetje të një incidenti drejtimi i ERR-së kalon tek agjencioni i cili e siguron KVN-në për atë incident. Gjatë incidentit ERR-të koordinojnë me ERQ-në dhe ofrojnë mbështetje për KVN-në. ERR-të:

- Monitorojnë dhe vlerësojnë raportet nga KVN dhe bëjnë rekomandime për adresimin e rrjedhjes;
- Kërkojnë nga niveli qendror, regjional dhe lokal dhe sektori privat të ofrojnë resurse;
- Ndihmojnë në përgatitjen e informacioneve për publikun dhe për komunikim me ERQ-në dhe
- Bëjnë rekomandime (nëse nevojitet) tek udhëheqësi i agjencisë e cila e siguron KVN për të caktuar KVN të ndryshëm të nivelit qendror.

Koordinatorët e PKK-së në vendngjarje: PKK përvijon përgjegjësitë e KVN-ve qendror të paracaktuar për ta përcaktuar nevojën për reagim qendror, për t'i drejtuar përpjekjet reaguese dhe për t'i koordinuar të gjitha përpjekjet tjera në vendin e ngjarjes së shkarkimit apo rrjedhjes në pajtim me delegimin ekzistues të autoritetit. KVN-të kryejnë detyrat e tyre nga PKI. Për shkarkimet e vajrave (varësisht nga lokacioni) agjencia që e siguron KVN-në është ose MMPH ose MPB. Për emergjencat me substanca të rrezikshme agjencia që e siguron KVN-në mund të jetë MMPH, MPB, Ministria e Energjisë apo Ministria e FSK-së, varësisht nga burimi dhe vendndodhja e rrjedhjes. Agjencitë tjera qendrore sigurojnë KVN për aksionet e largimit të substancave të rrezikshme që nuk janë emergjenca.

Veprimet reaguese

Njoftimi dhe vlerësimi: Sipas PKK-së, Departamenti i Mjedisit pranon njoftimet për rrjedhjet e vajrave dhe materieve të rrezikshme. Departamenti i Mjedisit menjëherë e përcjell raportin tek KVN përkatës qendror i paracaktuar, regjioni përkatës dhe entitetet përkatëse qendrore. KVN qendror vlerëson incidentin për përcaktimin e nevojës për reagim qendror. Departamenti i Mjedisit gjithashtu ofron raporte për incidente për Qendrën Operative të Ministrisë së Punëve të Brendshme (QOMP) dhe MPB vlerëson incidentin për të përcaktuar nëse është Incident i Karakterit Kombëtar. Nëse KVN përcakton që një incident është i madhësisë apo kompleksitetit apo përfshinë interesa kombëtare që mund të kërkojnë shpalljen e tij si Incident të Karakterit Kombëtar, KVN raporton situatën dhe rekomandimet nëpërmjet menaxhmentit të tij regjional tek menaxheri i programit të reagimit emergjent të nivelit qendror, i cili e njofton QOMP dhe ofron rekomandime për MPB-në. (ky njoftim nuk e pengon reagimin e KVN-së në vendngjarje.)

Koordinimi i reagimit: Me shpalljen e një incidenti që përfshinë vajra dhe materie të rrezikshme Incident të Karakterit Kombëtar (për të cilin FME 10 nuk është i aktivizuar) nga MPB-ja, strukturat e PKK-së koordinojnë me komponentët e PRK-së si në vijim:

Koordinimi i Nivelit të Zyrave Qendrore Grupi Ndërinstitucional për Menaxhimin e Incidentit (GNMI): ERQ vazhdon të funksionoj sipas PKK-së, por aktivitetet e tija i koordinon me GNMI-në kur aktivizohet nga MPB-ja. Kryesuesi i ERQ-së punon me MPB-në gjatë incidentit për vendosjen e mekanizmave të nevojshëm për koordinimin GNMI-ERQ. ERQ gjithashtu mund të dërgoj ndërlidhës në GNMI për ta mbështet ndërveprimin GNMI-ERQ, për t'i sinkronizuar përpjekjet dhe për t'i shmang aktivitetet e dyfishta apo konfliktuoze. Në këtë rast, ndërlidhësi i ERQ-së dhe Kryesuesi i ERQ-së punojnë së bashku për ta koordinuar ndërveprimin GNMI-ERQ. Për një incident që përfshinë vajra apo materie të rrezikshme agjencitë kyçe të ERQ-së të përfshira në incident gjithashtu ka gjasa të kenë përfaqësuesit e agjencisë në GNMI.

Sipas PKK-së, çështjet ndërinstitucionale që nuk mund të zgjidhen nga KVN në nivelin e PKI-së kryesisht së pari dërgohen për zgjidhje tek përfaqësuesit e agjencive përkatëse në ERR. Nëse nuk zgjidhen në nivelin regjional ato ngriten në nivelin ERQ. Sipas nevojës, përfaqësuesit e ERQ-së mund ta ngritin çështjen për zgjidhje tek niveli më i lartë i përfaqësuesve të agjencive. Për incidentet PKK për të cilët MPB-ja aktivizon GNMI-në, Kryesuesi i ERQ-së dhe/apo ndërlidhësi i ERQ-së bënë aranzhimet për koordinimin e çështjeve të nivelit të zyrës qendrore me GNMI-në. ERQ mund të ftohet që të ofroj ekspertizë specifike në lëmin e reagimit ndaj vajrave dhe materieve të rrezikshme për GNMI-në.

Qendra Operative e Ministrisë së Punëve të Brendshme: MMPH apo MPB varësisht nga ajo se cila agjenci është përgjegjëse për incident, përdor qendrën operative emergjente (QOE) të zyrës qendrore për koordinimin dhe menaxhimin e mbështetjes së nivelit qendror. ERQ gjithashtu e përdor QOE të sagjencisë parësore për koordinimin e aktiviteteve të tij. Derisa raportet për incidente kryesisht rrjedhin nga QBF-ja (kur të jetë ngritur) tek QOMP-së, QOE e MMPH-së gjithashtu e mban QOMP-së të informuar lidhur me përpjekjet e menaxhimit të incidentit. MMPH, MPB dhe agjencitë tjera të ERQ-së gjithashtu ofrojnë përfaqësues në QOMP për ta mbështetur koordinimin e informimit lidhur me aktivitetet e PKK-së.

Qendra Operative e Agjencisë së Menaxhimit Emergjent (QOAME): Për shkak se ky aneks adreson incidentet me vajra dhe materie të rrezikshme të karakterit kombëtar të cilët nuk kërkojnë mbështetjen e strukturës FME, nuk ka të ngjarë që MPB-ja do të përdor QOAME për incidentet e

tilla. Sipas këtij aneksi, resurset qendrore pritet të aktivizohen kryesisht nëpërmjet mekanizmave të PKK-së siç janë ERR-të dhe ERQ.

Siç u tha më herët, sipas këtij aneksi është e mundur që MMPH mund të kërkoj asistencë shtesë qendrore nga MPB-ja nëpërmjet mekanizmave të PRK-së të mbështetjes brenda qeveritare. Në këto raste, (nëse mbështetja nga agjencitë tjera është domethënëse) MPB-ja mund ta përdor QOAME-në. Pastaj sipas nevojës MMPH si dhe agjencitë e aktivizuara nëpërmjet mekanizmave mbështetjës Brenda qeveritare ofrojnë përfaqësues për QOAME për të ofruar informacione dhe për t'i koordinuar aktivitetet në nivelin qendror.

Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës (IHMK): IHMK është institut përgjegjës për parashikim, koordinim dhe shpërndarje të informatave lidhur me pasojat për rrjedhjet për materiet e rrezikëshme në ajër, ujë dhe tokë.

Koordinimi i Nivelit Regjional

Qendra Operative Emergjente Regjionale (QOER): Nëse MPB aktivizon QOER, MMPH dhe agjencitë tjera sipas nevojës ofrojnë përfaqësues për të ndihmuar në koordinimin e përpjekjeve mbështetëse regjionale. QBF (kur themelohet) është pika qendrore për koordinim shumë institucional dhe QOER luan rol mbështetës.

Koordinimi i Nivelit Fushor


I Deleguari i Ministrit (IDM): Kur IDM është i caktuar për një incident me vajra dhe materie të rrezikshme, agjencia e cila ofron KVN-në qendror cakton një ZLQ për të punuar në koordinim me IDM-in në QBF (ose lokacion alternativ nëse QBF nuk është e themeluar). KVN vazhdon t'i zhvilloj aktivitetet e tij/saj në PKI. KVN, ZLQ dhe përfaqësuesit e agjencive reaguese ofrojnë bashkëpunimin e tyre, resurset dhe mbështetjen e nevojshëm dhe të plot, sipas nevojës dhe në pajtim me autorizimet në fuqi. ZLQ koordinon me IDM në aktivitetet si sigurimi i informacioneve të incidentit për IDM-in sipas nevojës, koordinimin e strategjisë së informimit publik me IDM-in dhe me Marrëdhëniet Publike të MPB-së dhe redaktimin e informacioneve për publikun nëpërmjet IDM. Në disa raste mund të jetë e nevojshme që KVN-të të komunikojnë me mediat/publik për veprimet taktike dhe çështjet që prekin shëndetin dhe sigurinë publike, sidomos gjatë fazës së hershme të reagimit emergjent. Qendra e Bashkuar Informative (kur të jetë e ngritur) koordinon komunikimin midis agjencive dhe midis PKI-së dhe QBF-së.

Qendra e Bashkuar Fushore: Gjatë incidenteve të karakterit kombëtar mund të ngritet QBF si qendër koordinuese ndërinstitucionale për të siguruar mbështetje për PKI-në në vendin e ngjarjes. Për incidentet me vajra dhe materie të rrezikshme të karakterit kombëtar të cilët nuk përfshijnë shpalljen e gjendjes emergjente apo shpalljen e incidentit terrorist QBF nuk është e domosdoshme. Vendimi për ngritjen e QBF-së merret nga MPB mbi bazën e rastit dhe shkakut. Nëse është ngritur një Komandë regjionale QBF mund të bashkëvendoset me te. Nëse nuk është e nevojshme as njëra as tjetra IDM-i dhe stafi i tij mund të bashkëvendoset me PKI-në.

Kur QBF është ngritur, Grupi Koordinues i QBF-së përfshinë IDM-in; ZLQ të agjencisë e cila e ofron KVN-në qendror; zyrtarët regjional dhe lokal dhe (kur është e nevojshme) edhe përfaqësuesin e pronarit apo operatorit përgjegjës për rrjedhjen. Nëse janë të aktivizuar FME-të për të ofruar mbështetje Brenda qeveritare, Koordinatori i Resurseve Qendrore (KRQ) gjithashtu do të jetë pjesë e Grupit Koordinues të QBF-së. Kur kërkohet ngritja e QBF-së së plot për një incident sipas këtij aneksi, Figure X ilustron skemën organizative të QBF-së.

Gjatë një incidenti të karakterit kombëtar ERR-të koordinojnë me ERQ-në dhe ofrojnë mbështetje për KVN-në. ZLQ koordinon aktivitetet e ERR-ve me QBF sipas nevojës dhe ERR-të mbështesin QBF-në sipas kërkesës.

Fig. 1. Organizimi i QBF-së për incidentet me vajra dhe materie të rrezikshme të karakterit kombëtar



(Degët dhe njësitë ngriten sipas nevojës)

Koordinimi në vendngjarje

Sipas PKK-së KVN qendror përcakton nevojën për reagim qendror dhe ka autoritetin e drejtimit dhe koordinimit të përpjekjeve reaguese në pajtim me delegimin ekzistues të autoritetit. KVN përgjithësisht i bashkohet një PKI-je të ngritur nga autoritetet lokale apo cakton një PKI në afërsi në pajtim me autoritetet e nivelit lokal dhe zhvillon aktivitetet nga ajo PKI sipas konceptit Komandë e Bashkuar. Angazhimet e KVN-së koordinohen me mekanizmat tjerë reagues qendror, regional, lokal dhe privat nëpërmjet mekanizmave të Sistemit të Komandës së Incidentit. KVN përmbushë përgjegjësitë e tija/saj të përvijuara në PKK dhe i koordinon aktivitetet me Grupin Koordinues të QBF-së. Parimisht KVN komunikon me ZLQ në QBF dhe ZLQ koordinon me IDM dhe ZKQ/KRQ. Komanda e Bashkuar në PKI komunikon me Grupin Koordinues të QBF-së. ERQ ekzistues me vendimmarrje të deleguar dhe autoritetet e kontraktuara mbesin në fuqi dhe KVN dhe përfaqësuesit e agjencive të PKK-së vazhdojnë të raportojnë përmes zingjirit komandues të vendosur nga agjencitë e tyre përkatëse. Për incidente që ndodhin në shumë vende mund të ngritet Komanda Reagjionale, e cila do të ishte Komandë e Bashkuar Regjionale për reagime shumë-juridiksionale. Nëse ngritet, agjencionet qendrore në

Komandën Regjionale aktivitetet e tyre i koordinojnë me Grupin Koordinues të QBF-së. Parimisht, personeli qendror i Komandës regjionale komunikon me ZLQ të caktuar në QBF dhe ZLQ koordinon me IDM dhe ZKQ/KRQ. Komanda e Bashkuar Regjionale koordinon me Grupin Koordinues të QBF-së.

Veprimet në vijimësi: Në plotësim të veprimeve fillestare reaguese të zbulimit, njoftimit dhe vlerësimit preliminar, veprimet reaguese në vijim përfshijnë: izolimin, dekontaminimin, pastrimin, hudhjen, dokumentimin dhe mbulimin e shpenzimeve.

Përgjegjësitë

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Ministria e Punëve të Brendshme/AME dhe Ministria e Transportit dhe Post Telekomunikacionit

Përgjegjësitë sipas PKK-së përfshijnë:

- Secila agjenci ofron kryesuesin për ERQ për aktivizimin e ERQ-së për incidentet brenda juridiksionit të saj. MMPH ofron kryesues të ERQ-së dhe AME nën-kryesuesin në baza ditore.
- Secila agjenci ofron kryesuesin për ERR për aktivizimin e ERQ-së për incidentet brenda juridiksionit të saj. Secila agjenci ofron bashkëkryesues të ERR-së në baza ditore.
- Secila agjenci ofron KVN-të për drejtimin e përpjekjeve reaguese dhe për koordinimin e të gjitha përpjekjeve tjera në vendngjarje të shkarkimit apo rrjedhjes për incidentet brenda juridiksionit të tyre.

Agjencitë bashkëpunuese: Agjencitë qendrore do t'i vëjnë në dispozicion ato shërbime/objekte dhe resurse të cilat mund të jenë të dobishme në situata reagimi, në pajtim me autoritetet dhe kapacitetet e agjencisë. Gjatë planifikimit për gatishmëri apo gjatë një reagimi aktual, mund të thirren agjenci të ndryshme për të ofruar asistencë në fushat e tyre respektive.

Zyrtari Autorizuar Qendror: Agjencia që e ofron KVN-në qendror gjithashtu e ofron edhe ZLQ-në për të koordinuar me IDM dhe për të marr pjesë në Grupin Koordinues të QBF-së.